William Shakespeare

HAMLETI

Princ i Danimarkës

Përkthyer nga

Kristo Jorgji Kacori

në vitin 1930

Editor
Azam Dauti
Redaktoi:
Thoma Kristo Kacori

William Shakespeare

HAMLETI

(Princ i Danimarkës)

Përkthyer nga anglishtja në shqip
KRISTO JORGJI KACORI
(Teksti është përkthyer në vitin 1930)

Shkupi
Shkup, 2OO7

Përkthimi i dramës HAMLETI nga Shekspiri, të cilën e bëri Kristo Jorgji Kacori (Babai i Thoma Kacorit), pak kohë pas përkthimit të Hamletit në shqip, nga bashkëkohaniku i tij Fan Noli, e ka rëndësinë e vet artistike, sepse bëhet fjalë për një përkthim krejtësisht origjinal dhe i pandryshueshëm nga ana jonë si botues (përkthimi u realizua në vitin 1930).

Pra, ky përkthim si krijimtari artistike individuale e Kristo Jorgji Kacorit, mbi të gjitha e ruan autenticitetin gjuhësor të gjuhës shqipe të asaj kohe. Natyrisht, që redaktori i përkthimit Thoma Kacori, ka bërë edhe ndërhyrje të vogla në tekstin e përkthyer, por atë e ka bërë shkaku i pragmatizmit komunikues me lexuesin e sotëm, në aspektin kuptimor e assesi në ndryshimin e përkthimit.

Gjatë leximit të kësaj drame mund të hasen dallime jo edhe aq minore nga përkthimi i Nolit, si në kuptim, përmbajtje, e në disa raste edhe në të shqiptuarit e personazheve. Ne si botues, mendojmë që për të ruajtur frymën e përkthyesit, kemi bërë mirë që nuk kemi ndërhyrë në shumë raste të tekstit, përpos atyre që lexuesi krejtësisht mund të dezorientohet.

Editori

PERSONAZHET:

Klaudi *– Mbreti i Danimarkës*
Hamleti – *I biri i mbretit të vdekur*
dhe i nipi i mbretit të tanishëm
Fantazma *– e mbretit të vdekur, e Hamletit plak*
Polloni *– Kryekëshilltar i mbretit*
Horati *– Mik i Hamletit*
Laerti *– Djali i Pollonit*
Voltimandi *– Obortar*
Korneli *– Obortar*
Rosenkranci *– Obortar*
Guidelsterni *– Obortar*
Osriku *– Obortar*
Një fisnik *– Obortar*
Një prift
Marceli *– Oficer*
Bernardi *– Oficer*
Franciskua *– ushtar*
Rejnaldi *– shërbëtor i Pollonit*
Aktorë
Dy varrmihës komikë
Fortinbrasi – *princ i Norvegjisë*
Një kapiten norvegjes
Ambasadorë anglezë
Gertruda *– Mbretëresha e Danimarkës,*
më parë e shoqja e mbretit Hamlet
dhe e ëma e Hamletit
Ofelia *– E bija e Pollonit*
Imzotër, zonja,
oficerë, ushtarë,
marinarë, lajmëtarë
dhe shoqëronjës të tjerë

Skenë në Danimarkë

AKTI I PARË

Skena e parë

Elsinor. Një tribunë përpara bedenave të kështjellës.

Franciskua
– *(Roje)* Hyrë! *(Bernardua vjen ta ndrrojë).*
Bernardi– Kush është aty?
Franciskua
– Jo, m'u përgjigj ti! Qëndro dhe më jep të njohur!
Bernardi– Rroftë mbreti!
Franciskua – Ti Bernardi?
Bernardi– Dora vetë.
Franciskua – Ti vjen pikërisht në orën tënde.
Bernardi
– Tani posa ra dymbëdhjetë. Shko fli Francisko!
Franciskua – Faleminderit shumë për ndrrimin,
se është një e ftohtë e hidhur, që të hyn në palcët.
Bernardi– A kishe roje të qetë?
Franciskua – As një mi s'lëvizi!
Bernardi– Pra, natën e mirë. Dhe po të takosh Horatin dhe Marcelin, shokët e mi të rojes, e thuaj të nxitojnë.
Franciskua – Më duket se po vinë. Qëndroni! Kush është aty? *(Hyjnë Horati dhe Marceli)*
Horati – Miq të këtij vëndi!
Marceli – Dhe shtetas besnikë të mbretit.
Franciskua – Natën e mirë të gjithëve.
Marceli – Natën e mirë ushtar i ndershëm.
Kush të ndrroi?
Franciskua – Bernardua zuri vëndin tim.
Natën e mirë. *(Del)*

Marceli – Ej, Bernardi!
Bernardi – Folë – Çfar? Është Horati aty?
Horati – Një pjesë e tij.
Bernardi
– Mirëserdhe, Horat. Mirëseardhe, Marcel i mirë.
Marceli – Ç'kemi? A u duk ajo gjëja përsëri sonte?
Bernardi – S'kam parë asgjë.
Marceli – Horati thotë, se ajo ashtu na është dukur dhe nuk beson në asnjë mënyrë në pamjen e tmerrshme, që ne kemi parë dy herë; prandaj iu luta të vijë roje bashkë me ne sonte, që në ardhtë përsëri hija, ta shikojë me syt e tij dhe t'i flasë.
Horati – Eh, eh, nuk do të duket!
Bernardi – Po, rrini pak dhe lerna të të çajmë veshët dhe një herë, të cilët as që duan ta dëgjojnë historinë tonë, që ne e kemi parë dy netë me radhë.
Horati – Pra, rrimë, dhe le të dëgjojmë Bernardin të na thotë.
Bernardi – Nga të gjitha netët, natën e kaluar, kur i njëjti ai yll, që është në perëndim të polit, kishte bërë rrethin e tij të ndriçonte atë pjesë të qiellit ku tani digjet, Marceli dhe unë, kambana atëherë po binte një... *(Hyn Fantazma e armatosur)*
Marceli – Qetësi! Pusho! Shiko, jo po vjen prapë!
Bernardi
– Me të njëjtën figurë si të mbretit të vdekur.
Marceli – Ti je i ditur, foli Horat!
Bernardi
– Nuk të duket si mbreti? Shikoje mirë, Horat.
Horati
– Pikërisht si ai. Dridhen nga frika dhe habija!
Bernardi – Pret t'i flasim[1].
Marceli – Pyete, Horat!

Horati – Cili je ti, që shkel këtë kohë të natës, bashkë me atë pamje të bukur dhe luftarake, me të cilën madhëria e mbretit të vdekur dikur kalonte? Të detyroj në emër të qiellit, folë!
Marceli – U fye!
Bernardi – Vështro, po ikën tutje kryelartë!
Horati – Qëndro! Folë, folë! Të detyroj! Folë!
(Fantazma del)
Marceli – Shkoi dhe nuk do të përgjigjet.
Bernardi – Ç'do të thuash tani, Horat? Ti dridhesh dhe je i zbeti; s'është kjo diçka më tepër se fantazi? Ç'mendon t'i për këtë?
Horati – Për perëndi këtë nuk do ta besoja, po të mos e kisha parë dhe vërtetuar me syt e mi.
Marceli – S'është si mbreti?h
Horati – Sikundër t'i i ngjet vetes sate. Dhe t'atillë shqytë kishte ngjeshur, kur ay lëftoi ambiciozin norvegjez; ashtu u vrënjt një herë, kur në një mbledhje, i inatosur përplasi pollonezët nga saeja në akull.[2] Është për t'u çuditur!
Marceli – Kështu dy herë më parë dhe pikërisht në këtë orë të heshtur, me hap ushtarak kaloi përpara rojes sonë.
Horati – Dhe unë vetë nuk di se si ta shpjegoj, por në ëndjen e pafundme të mendimit tim, kjo paralajmëron diçka të keqe për shtetin tonë.
Marceli
– Mirë, tani ju lutem, uluni, e më thoni ay që di,
pse tërë këto roje rigoroze dhe kaq vigjilente,
për natë mundojnë të gjithë qytetarët
dhe pse për ditë derdhin brunc e bëjnë topa
dhe venë në tregje të huaj të blejnë vegla luftarake;
pse t'atilla angari për anieberësit,
që puna e tyre e rëndë, me dhunë e caktuar,

s'e ndan të djelën nga java;
pse këto pregatitje të ethëshme,
që me nxitim dhe djersë e bëjnë natën shok të ditës;
Kush mund të m'i shpjegojë këto mua?
Horati – Këtë mund ta bëj unë;
të paktën siç flitet posht e lartë.
Mbretit tonë të fundit,
përfytyrimi i të cilit posa na dolli përpara,
sikundër ju e dini, që Fortinbransi i Norvegjisë,
i nxitur nga një ambicje tepër krenare,
e thërriti në dyluftim, në të cilin trimi ynë Hamleti
– se si të tillë e tërë bota e njihte
– e vrau Fortinbransin, i cili me një marrëveshje
të njohur prej ligjit, dhe ligjit të armëve,
do të humbte me jetën e tij dhe të gjitha ato vënde, të cilat ay zotëronte, të fitonjësi, kundra kujt, mbreti ynë kishte vënë një pjesë të barabartë,
që do ta trashëgonte Fortinbransi,
po të kishte fituar; dhe sipas marrëveshjes
dhe zbatimit të neneve të nënshkruar,
vëndet e tia i ranë Hamletit.
Tani zoti i ri Fortinbrans, me vrull të papërmbajtur,
tërë zjarr dhe guxim, ka mbledhur andej këtej
nëpër kufijt e Norvegjisë turma katilësh
të vendosur për bukë dhe para
dhe gati t'i futen çdo ndërmarrjeje që kërkon kurajo;
se s'është gjë tjetër,
ashtu siç u kuptua mirë prej shtetit tonë,
veçse që të marrë prapë nga ne me anë të forcës
dhe me kushte të imponuara,
ato vënde që thamë më lartë,
të cilat i jati i tij i humbi: dhe kjo është, pandej,
qëllimi kryesor i pregatitjeve tona,
burimi i rojeve dhe shkaku i parë i kësaj ngutjeje

të madhe dhe trazire të vendit tonë.
Bernardi – Mund të mos jetë tjetër,
po megjithëkëtë do të ketë ndonjë arësye
që kjo figurë shenjë – keqe të vijë e armatosur përmes rojes sonë, ashtu si mbreti,
i cili ishte dhe është shkaku i këtyre luftërave.
Horati – Molëza[3] vjen të trubullojë syn' e mëndjes.
Në kulmin më të lartë të madhështisë së Romës, pak më parë se të binte i plotëfuqishmi Qezari,
varret mbenë pa qeraxhinj
dhe të vdekurit me savan në kurm,
kuisnin dhe llomotisnin nëpër rrugët e Romës,
sikur luftëtarë të zjarrtë luftonin me retë,
dhe yje me bishtra prej zjarri
dhe vesë prej gjaku errësonin diellin,
dhe ylli i notit,[4] mbi ndikimin e të cilit
perandoria e Neptunit bazohet,
si për ditën e gjykimit të fundit
ishte nxirë me eklips;
pikërisht tani shënja të njëjta të tmerrshme,
si paralajmëtarë që zbulonë gjithmonë fatet
dhe parathonë të këqiat që do të vijnë,
qielli dhe dheu së bashku tregojnë
dhe paralajmërojnë vëndin tonë
dhe bashkatdhetarët. *(Hyn përsëri Fantazma)*
Por, qetësi, vështro! Ja, ku vjen prapë!
Do t'i dal përpara sikur hi të më bëjë. Hie, qëndro!
Nëse nxjerr tingull dhe ke përdorje zëri, folmë!
Në është ndonjë gjë e mirë për të bërë,
që mund të të japë prehje dhe mua hir, folmë!
Nëqoftëse t'i e di fatin e atdheut tënd,
dhe duke e ditur që më parë
të këqiat mund t'i mënjanojmë, o, folë!
Ose në ke fshehur në jetën tënde

thesarë të grabitur në gjirin e dheut,
për të cilët thonë, se ju shpirtrat e vdekur
shpesh silleni vërdallë, *(Këndon këndezi)*
folmë! Qëndro dhe folë! Qëndroje, Marcel!
Marceli – Ta godis me shtizën!
Horati – Bjeri po të mos qëndrojë!
Bernardi – Ja ku është?
Horati – Ja ku është!
Marceli – Shkoi! *(Fantazma del)*
Ne nuk u suallëm mirë, he deshëm të detyrojmë,
një qënie aq madhështore, me që është si era e paprekshme dhe kërcënimet tona janë tallje të kota.
Bernardi
– Ay pothuajse do të fliste kur këndoi këndezi.
Horati – Dhe atëherë kërceu si ndonjë qënie fajtore nga një thërritje e tmerrshme.
Kam dëgjuar, se këndezi është burija e mëngjezit,
ay me tingujt e lartë dhe klithmën e gurmazit
zgjon perëndin e ditës.
Dhe paralajmëron hijen e arratisur
që sillet vërdallë në det apo në zjarr,
në dhe apo në erë të kthehet në shtrofkën e tij.
Vërtetimin e këtyre fjalëve
na i aprovoi kjo qënia e tanishme.
Marceli – U zhduk me këngën e këndezit.
Ca tonë se gjithnjë kur vjen stina,
në të cilën lindja e shpëtimtarit tonë kremtohet,
zogu i mëngjesit këndon gjatë tërë natës;
ahere, thonë, se as ndonjë shpirt
s'guxon të sillet jashtë,
netët janë të mbara dhe yjtë s'dëmtojnë,
zana s'tërheq, as shtriga s'ka fuqi magji të bëjë,
aqë e shenjtë dhe aqë e hirshme është koha.

Horati - Ashtu kam dëgjuar dhe unë, e pak i besoj, o vështro, mëngjezi me mantel të kuq veshur, ecën atje tej në lindje mbi vesën e malit të lartë. Pra, le t'i japim fund rojes sonë, dhe unë jam i mendimit ato që pamë sonte Hamletit të ri t'ia kumtojmë, se, për jetën time, ky shpirt memec për ne, ati do t'i flasë. A jini dakord atij t'ia njoftojmë, siç e do dashuria jonë, dhe siç i ka hije detyrës sonë?
Marceli – Ju lutem këtë ta bëjmë, dhe unë e di, se në ç'vend mund ta gjejmë këtë mëngjes dhe me voli t'i flasim. *(Dalin)*

Skena e dytë

Elsinor. Një dhomë në kështjellë.
Fanfara trumpetesh.
Hyjnë Klaudi , Gertruda, Hamleti, Polloni, Laerti,
Voltimandi, Korneli, kryezotër dhe shoqëronjës.

Klaudi – Ndonëse vdekja e Hamletit,
vëllait tonë të shtrenjtë,
është taze në kujtesën tonë
dhe do të na kishte hie zemrat t'i kemi në zi
dhe tërë mbretëria jonë
të jetë me fytyrë të rrudhur nga pikëllimi,
prapëseprapë urtia deri këtu lëftoi me natyrën,
që ne ta kuptojmë atë me hidhërim të urtë,
së bashku duke kujtuar dhe veten tonë.
Prandaj, ajo që pak më parë ish motra jonë,
Tani mbretëresha jonë
dhe perandoreshë e këtij shteti luftarak
sikur ishte, të themi, me hare të prishur,
me njërin sy në gaz dhe tjetrin në të qarë,
me gaz në varrim dhe me vaj në martesë,
baras me njëri tjetrin gëzimi dhe hidhërimi,
e muarmë grua, por as që i kemi hedhur poshtë
këshillat tuaja të mira, të cilat lirisht na dhatë
për këtë çështjen tonë.
Për të gjitha faleminderit.
Tani ju bëj të njohur: Fortinbrasi i ri,
ose ka kujtesë të shkurtër për forcën tonë,
ose mendon se me vdekjen
e vëllait tonë të dashur,
shteti ynë është përçarë dhe çorganizuar,
në aleancë me ëndërrat e leverdisë së tij,
nuk ndruhet të na bezdisjë me lajmërime

dhe të na thotë t'i dorëzojmë ato vënde,
që i jati i tij i humbi me gjithë pasojat e ligjit,
dhe i fitoi fort trimi vëllai ynë.
Kaqë për të; tani për veten tonë,
edhe për këtë mbledhjen,
çështja qëndron kështu;
i kemi shkruar këtu mbretit të Norvegjisë,
xhaxhait të Fortinbrasit të ri,
i cili është pak i pafuqishëm dhe që në shtrat
dergjet dhe as që i di qëllimet e të nipit të tij
– t'i shtypjë lëvizjet e tij menjëherë,
kurse taksat, mbledhja e ushtarëve
dhe tërë pajisjet bëhen nga nënshtetasit e tij,
dhe tani u dërgojmë ju të mirë Kornel
dhe ty Voltimand,
t'i shpini këto përshëndetje norvegjezit plak.
Juve s'ju japim më shumë fuqi personale
të bisedoni me mbretin më tepër se ç'u lejojnë
këto nyja që letrat përmbajnë.
Udhën e mbarë dhe shpejtësia juaj
le të urdhërojë detyrën tuaj.
Korneli – dhe...
Voltimandi – Në atë dhe në të gjitha
Ne do të dëftejmë detyrën tonë.
Klaudi – Për atë s'dyshojmë fare.
Megjithë zemër udhën e mbarë.
(Dalin Korneli dhe Volitmandi)
Dhe tani, ti Laert, ç'janë të rejat tënde?
Ti na kërkove një favor, ç'është ay, Laert?
Po t'i flasësh me arësye Danezit
nuk do të humb zënë;
çdo gjë që të kërkosh, Laert
ajo nuk do të jetë dhënë nga unë.
As kërkesa jote.

Koka s'është më ngushtë lidhur me zemrën,
dora më mirë vegël te goja,
sesa froni i Danimarkës me tët'atë.
Çfarë dëshëron, Laert?
Laerti– Shumë i ndershëm, kryezot,
lejen tuaj dhe favorin të kthehem në Francë;
nga ku ndonëse me dashje ardha në Danimarkë,
të dëftej detyrën time në kurorëzimin tuaj,
prapëseprapë tani do të rrëfehem
– detyrën plotësuar, mendimet e mia
dhe dëshirat anojnë prapë ndaj Francës
dhe ju përulem për lejen tuaj dhe ndjesë.
Klaudi – A ke leje nga yt atë? Ç'thua, ti Pollon?
Polloni– Ay e shtrydhi lejen time të zorshme
me lutje të parreshtura dhe më në fund,
vulosa mbi dëshirën e tij, pëlqimin tim të ngurtë;
ju lutem jepini leje të shkojë.
Klaudi – Zgjidh orën e nisjes, Laert,
koha le të jetë jotja, dhe hiret e tu të mira
shpenxoi pas dëshirës sate.
Po tani, ti kushëriri[5] im dhe biri im. –
Hamleti *(mënjanë*)
– Pak më tepër se fis dhe më pak se djalë.
Klaudi – Ç'është kjo që retë edhe varen mbi ty?
Hamleti– Aspak, imzot, unë jam fare në diell.
Gertruda – Hamlet i mirë, hidhi tej ngrysjet tënde
dhe leri sytë ta vështrojnë si mik mbretin.
dhe mos, gjithnjë me shikimin ulur poshtë,
kërko atin tënd bujar në pluhur,
ti e di që ky është ligj i përgjithshëm,
çdo gjë që rron do të vdesë,
dhe kalon nëpërmjet natyrës në amëshim.
Hamleti– Po, zonjë, është i përgjithshëm.
Gertruda – Në qoftë se është kështu

pse duket kjo aq e veçantë tek ty?
Hamleti– Duket, zonjë?
Jo, kjo është. Unë s'e di që duket.
S'është vetëm palltua ime e zisë, mëm' e mirë,
as rrobat e zakonshme të zeza të zisë,
as frym' e psherëtimës me dhunë nxjerrë,
jo, as rrëketë lot që derdhin sytë,
as përshtypja e hidhëruar e fytyrës,
së bashku me tërë pamjet,
teket dhe dukjet e hidhërimit,
që me të vërtet mund të më dëftejnë mua,
këto vërtet duken,
se ato janë vepra që një mund t'i lozë,
po unë kam brënda në vetvete
atë që kalon dëftimin,
këto janë vetëm takëmet dhe rrobat e hidhërimit.
Klaudi –
Kjo është mirë dhe për t'u lavdëruar, Hamlet,
që t'i bësh këto nderime zie t'yt eti;
po ti dhet ta dish, yt atë humbi t'anë,
dhe i jati i tij, humbi të tijnë,
dhe ay që rron duhet doemos
si detyrime djali të mbajë zi ca kohë;
por po të vazhdojë zinë e tij
me këmbëngluje guxon të shprehjë
përmbuzje kryenece, ajo s'është zi burri;
Ajo dëften vullnet të pabindur karshi qiellit,
një zemër të pambrojtur, mëndje të paduruar,
kuptim të thjeshtë dhe të padisiplinuar,
kur ne e dimë që medoemos do të bëhet,
dhe është aqë e rëndomtë,
sa gjërat më të zakonshme që ndjehen,
ahere pse ne në kundërshtimin tonë idhnak
të prekemi në zemër?

Medet! Kjo është mëkatë kundër zotit,
mëkatë kundër të vdekurit,
mëkatë kundër natyrës,
të arsyetosh është absurd,
po të jetë tema e tyre gjithnjë
vdekja e etërve, për të cilët kanë qarë,
që nga meit i parë, gjer te ay që vdiq sot,
kjo duhet të jetë kështu.
Të lutemi hidhe tutje
këtë pikëllim të kotë dhe mendohu për ne
si baba, dhe le ta dinë bota,
se ti je më i afërmi i fronit tonë,
dhe jo me më pak dashuri bujare
se atë të cilën ati më i dhëmshur ndjen
për të birin e tij, unë të dhuroj ty.
Për mendimin tënd
që të vesh në shkollë në Uiterberg,
është kundër dëshirës sonë,
dhe të lutemi, bindu dhe rri këtu në brohoritje
dhe në ngushëllimin e syve tonë,
kryeobortari ynë, kushëri dhe biri ynë.

Gertruda –
Mos e lerë tët'ëmë të humbjë kot fjalët e saja,
Hamlet, të lutem rri me ne, mos shko në Uiterbergl

Hamleti – Do të bëj ç'mos të të bindem, zonjë.

Klaudi –
Po, kjo është përgjigje e dashur dhe e bukur,
ji si vetë ne në Danimarkë. Eja, zonjë;
Kjo bindje fisnike dhe pa dhunë e Hamletit,
ma gëzon zëmrëm time; dhe për shëndetin e tij
mbreti tërë ditën sot do të pijë,
po, topi madh reve do t'u thotë,
dhe dollit e tij çiejt do të bëjnë të buçasin
bubullima nga dheu do riushtojnë;

Ejani të shkojmë.
(Bien fanfare. Dalin të gjithë përveç Hamletit)
Hamleti – O, sikur ky mish,
shumë shumë i ngurtë, të tretej,
të shkrihej, të avullohej dhe të bëhej vesë!
Ose i përjetoshmi të mos kishte vënë
kanun e tij kundër vetvrasjes! O zot! O zot!
Sa të mërzitura, të hupta,
të pashijshme dhe të padobishme
më duken tërë zakonet e kësaj bote!
Turp! Turp! Ky është një kopsht i patarur
që rrit të plehrojë: gjëra të egra, të ashpra
e mbytin të tërë. Që të arrijë në këtë!
Posa dy muaj që ka vdekur!
Jo, jo se aqë shumë, jo as dy;
një mbret aqë i shkëlqyer, ishte ay përpara këtij,
si Hiperioni përpara Satirit;
aqë e donte mëmën time,
sa ay s'duronte as erën e qiellit
t'ia prekte fytyrën e saj shumë ashpër.
Qiell dhe dhe!Duhet ta kujtoj?
Pse, ajo varej mbi atë,
Sikur shtimi i oreksit të saj i rritej
nga ato që ajo ushqehej.
Dhe prapëseprapë, Brenda një muaji!
Më mirë të mos mendohem mbi këtë – dobësi,
emëri yt është grua. Një muaj të vogël!
Ose më parë se këpucët u vjetëruan,
Me të cilat ajo ndoqi trupin e të mjerit atit tim,
si Nidba, tërë lotë; - pse ajo, bile ajo, - o perëndi! Dhe
një bishë, që i mungon fuqia e arësyes,
do të kishte mbajtur zi më shumë,
- u martua me tim ungj, të vëllanë e tim eti,
po jo më tepër se im atë,

se sa unë i ngjasë Herkulit.
Brenda një muaji; më parë akoma
se kripa e lotëve të saj të padrejtë,
ishte tharë nga të kuqtë e syve të saj të vrarë,
u martua. – O, shpejtësi e poshtër shumë,
që të futej me të atillë shkathtësi
në çarçafët e incestit, ajo s'është,
as mund të ketë fund të mirë;
- por plas, o zemër,
se duhet ta mbaj gjuhën time!
(Hyjnë Horati , Marceli dhe Barnardua)
Horati – Tungjatjeta, imzot!
Hamleti– Gëzohem që je mirë;
Horati – nëqoftëse kujtesa ime nuk më gënjen.
Horati – I njëjti, imzot!
Dhe gjithnjë shërbëtori juaj i urtë.
Hamleti – Zotëri, miku im i mirë;
dua të shkëmbej këtë emër me ty;
(I japin dorën njëri tjetrit)
Dhe ç'të shtyri të ikësh nga Uitenbergu, Horat?
Marcel? *(I jep dorën)*
Marceli – Imzoti im i mirë!
Hamleti– Jam shumë i kënaqur që të shikoj!
(I thotë Bernardis)
Mirëmbrëma, zotëri. *(Bernardija i ul kryet)*
Po, çfarë, për besë, të shtyri të ikësh nga
Uitenbergu?
Horati – Tokë përtacësie, i mirë Imzot.
Hamleti–
Nuk dua dëgjoj as armikun tënd të flaës kështu,
as ti nuk do t'i bësh veshit tim atë dhunë,
që ta shtysh të besojë
të thënat e tua kundër vetes tënde;
unë e di që ti nuk je përtac,po pse erdhe në Elsinor?

Ne do të të mësojmë të pish keq, para se të ikësh.
Horati – Imzot, ardha të marr pjesë në varrimin e tyt'eti.
Hamleti– Të lutem, mos më tall, bashkëstudent; mendoj se erdhe të shikosh dasmën e sim'mëje.
Horati – Me të vërtet, imzot, ajo u bë një çikë me nxitim.
Hamleti– Për kursim, për kursim, Horat!
Mishrat e pjekura të varrimit,
të ftohta mbushën tryezat e dasmës.
Dëshëroja të kasha takuar armikun tim më të shtrënjtë në parajsë, se të shihja atë ditë, Horat!
Tim'atë – më duket shoh tim'atë.
Horati – Ku, imzot?
Hamleti– Në syrin e mëndjes sime, Horat.
Horati – E pashë një herë; ay ishte mbret i mirë.
Hamleti– Ay ishte burrë në çdo gjë.
Kurrë nuk do të shoh një tjetër si ay.
Horati – Imzot, mendoj, e pashë atë dje mbrëma.
Hamleti– E pe? Cilin?
Horati – Imzot, mbretin, tët'atë.
Hamleti– Mbretin, tim atë?
Horati – Qetëso habitjen tënde për pakë.
Dhe dëgjo me vëmendje, gjersa të të tregoj,
Me dëshminë e këtyre zotërinjve, këtë çudi.
Hamleti– Për dashurinë e perëndisë, thuama.
Horati – Dy netë me radhë këta zotërinj,
Marceli dhe Bernardua, siç po bënin roje,
në hapësirën e shkretë dhe heshtjen e mesnatës,
përballë: një figurë si yt'atë, e armatosur tamam
që nga koka gjer në këmbët, u duk përpara tyre,
dhe me hapa luftarake,
shkoi nga dale dhe madhërisht pranë tyre;
tri herë kaloi në errësirë dhe sytë e tyre

u shtangën nga frika.
Aqë afër sa skeptri i tij; ndërsa ata u mbytën
në djersë të ftohta, dhe nga frika
mbenë memecë dhe atij s'i folë.
Këta këta, me tmerr të fshehtë mua ma thanë;
dhe unë me ta natën e tretë bëra roje;
dhe ja, ashtu siç më kishin thënë,
që të dyja, kohën dhe pamjen e gjësë,
çdo fjalë u vërtetua, hija erdhi. Unë e njoha tët'atë;
këto duar nuk shëmbëllejnë më shumë.
Hamleti– Po ku ngjau kjo?
Horati – Imzot, mbi tribunë, ku ruanim.
Hamleti– Ju, nuk i foltë?
Horati – Imzot, i fola unë, po ay nuk m'u përgjigj;
megjithkëtë një herë m'u duk sikur
e ngriti kokën e tij dhe e drejtoi veten të lëvizë,
me shëmbëllim sikur do fliste;
por posa zogu i mëngjesit këndoi më fortë
dhe në tingëllimën u rrudh me nxitim
dhe u zhduk nga sytë tonë.
Hamleti– Kjo është çudi e madhe.
Horati – Për kokën time, i ndershmi imzot,
është e vërtetë;
dhe ne menduam të kryejmë detyrën tonë
e të ta bëjme të ditur.
Hamleti– Vërtet, vërtet, zotërinj,
po kjo me ç'qetëson.
Do të bëni roje sonte?
Marceli dhe Bernardi– Po, Imzot.
Hamleti– I armatosue, thoni?
Marceli dhe Bernardi– I armatosur, Imzot.
Hamleti– Nga kryet gjer në gishtrinjt e këmbës.
Marceli dhe Bernardi
– Imzot, nga koka gjer te këmbët.

Hamleti– Ahere ju s'e patë fytyrën e tij?
Horati – O, po imzot, e kishte përkrenaren ngritur.
Hamleti– Dhe, si dukej, i vrënjtur?
Horati – Më shumë i hidhëruar, se sa i zëmëruar.
Hamleti– Të verdhë, apo të kuqe?
Horati – Jo, shumë të verdhë.
Hamleti– Dhe nguli sytë mbi ju?
Horati – Për një kohë të gjatë dhe palëvizur.
Hamleti– Doja të isha atje.
Horati – Do të kishe mbetur i habitur.
Hamleti– Ndofta, ndofta! Ndënji shumë?
Horati – Sa të numërosh njëqint mengadale.
Marceli dhe Bernardi– Më shumë, më shumë.
Horati – Jo më shumë, kur e pashë unë.
Hamleti– E kish mjekrën të thinjur? Apo jo?
Horati – E kish ashtu siç e kasha parë të gjallë,
të zezë të argjentuar.
Hamleti– Do ruaj son
Ndofta do vijë përsëri.
Horati – Ju garantoj që do të vijë.
Hamleti– Nëqoftëse hija do të çfaqet
me fytyrën e atit tim bujar,
do t'i flas atij, sikur vetë ferri të gjëmojë
dhe të më urdhërojë të pushoj!
U lutem juve të gjithëve,
në e kini mbajtur të fshehtë këtë pamje,
mbaheni në heshtjen tuaj akoma,
dhe çfarëdo tjetër që mund të ngjasë sonte
jepini kuptimin tuaj, po ju gjuhë;
do t'jua shpërblej besnikërinë tuaj;
pra, tani, ditën e mirë;
do të vij në tribunën tuaj,
midis njëmbëdhjetës dhe dymbëdhjetës.
Të gjithë – Detyra jonë është t'ju shërbejmë.

Hamleti – Jo, më falni dashurinë tuaj, ashtu si unë u jap timen; Ditën e mirë.
(Ulin kryet dhe dalin të gjithë përveç Hamletit)

Shpirti i tim'ati me armë!
Diçka nuk është e mirë,
dyshoj për ndonjë lojë djallëzore;
donja të kishte ardhur nata!
Gjer ahere shpirti im rri i qetë;
veprat e këqia
do të dalin përmbi dhe,
sikur tërë dheu t'i fshejë
nga sytë e njerëzve. *(Del)*

Skena e tretë

Një dhomë në shtëpinë e Pollonit.
Hyjnë Laerti dhe Ofelia.

Laerti– Plaçkat m'i vendosën në anie. Lamtumirë.
Por, motër, sikundër erërat janë të dobishme
dhe lundrimin ndihmojnë, mos fli,
po shkruam që të mësoj të rejat tënde.
Ofelia – Dyshon ti për këtë?
Laerti– Sa për Hamletin dhe dokrrat e dashurisë së
tij, zëri ato si tekë dhe trill të gjakut,
një manushaqe në pranverën e hershme të jetës,
e lashtë, por jo e përhershme, e ëmbël,
po s'rron shumë, aroma dhe dëfrimi i një çasti;
dhe jo më tepër.
Ofelia – Asgjë më tepër se kaqë?
Laerti– Mos mendo më për të;
se rritja e njeriut nuk zhvillohet vetëm
me muskuj dhe gji; por me rritjen e trupit
shtohen bashkë me të njëkohësisht
dhe detyrimet e mëndjes dhe të shpirtit.
Ndofta ay të dashuron tani;
dhe tani as turpi, as hiletë nuk ia ndotin
virtytin e vullnetit të tij; po t'i duhet të kesh frikë,
po të matësh madhërinë e tij,
vullnet i tij s'është e tij, se ay vetë është
shtetas i lindjes së tij: ay s'mund të veprojë
si bëjnë njerëzit e thjeshtë
– të zgjedhë për veten e tij, se nga zgjedhja e tij varet
sigurimi dhe mirëqenia e tërë shtetit të tij,
dhe prandaj zgjedhja e tij duhet të pëlqehet
prej mendimit dhe miratimit të atij trupi,
i të cilit ay është koka.

Nëqoftëse ay të thotë se të dashuron,
ti do veprosh me urtësi
po të besosh deri aqë,
se ay në shkallën dhe klasën
e tij të veçantë,
që mban në shtet,
a mund t'i kthejë fjalët në realitet;
se ato s'kanë aqë rëndësi,
sa të gjitha zërat e Danimarkës së bashku.
Ahere pesho se ç'humbje nderi yt do pësojë,
Nëqëoftëse aqë shumë ua vë veshin këngëve të tij,
Ose humb zemrën tënde,
ose t'i çelësh thesarin tënd të thjeshtë
epsheve të tij të papërmbajtura.
Ruaju, Ofeli, ruaju motra ime e shtrenjtë,
mos i jep hov dashurisë tënde,
dhe rri larg nga shtira
dhe rreziku i dëshirës.
Vajza dhe më modeste
është mjaft e pakursyer
po t'ia zbulojë bukurit' e saj hënës;
virtuti vetë s'shpëton dot
nga goditjet e shpifjes;
shpesh vemja ha foshnjat e pranverës
shumë më parë se të çelin burbuqet e tyre,
dhe në mëngjes në vesën e lëngët të rinisë
ndikimet ngjitëse
janë shumë të rrezikshme.
Kih kujdes ahere;
sigurimi më i mirë në frikë bazohet;
i riu revoltohet kundër vetes tij,
nëqoftëse s'ka tjetër pranë që të ngacmohet.
Ofelia – Do të ruaj kujtimin e këtij mësimi të mirë,
si rojtësin e zemrës sime. Po vëllai im i dashur,

mos vepro siç bën ndonjë prift i pahirshëm,
që dëften udhën e përpjetë dhe të gjëmbtë të qiellit,
ndërsa vetë si një i fryrë dhe i pakujdesur e pafre,
ndjek rrugën e qefeve dhe të argalisjeve
dhe për këshillat e tij s'kujdeset fare.
Laerti– O, mos u trëmb për mua. Ndëja shumë?
– Po ja tek vjen babai.

(Hyn Polloni)

Një bekim i dyfishtë është dy herë hir;
rasti na buzëqeshi për një lamtumirë të dytë.
Polloni – Akoma je këtu, Laert?
Në anie, në anie, turp!
Era po rri në krahun e velit tënd,
dhe po tëp resin. Eja të të jap uratën time!

(Laerti bie në gjunjë dhe Polloni i
vë dorën përmbi kokën e tij)

Dhe këto parime t'i ruash në kujtesën tënde,
të të udhëheqin karakterin tënd.
Mendimeve të tua mos u jep gjuhë,
dhe para se të veprosh mendohu mirë.
Ji familjar, po kurrë në mënyrë të tepruar,
kur të zësh miq dhe t'i kesh provuar
shtrëngoji në shpirtin tënd me rrathë prej çeliku;
por mos bëj pëllëmbën tënde kallo me gostira,
me çdo të rikllоqitur dhe pëndë panxjerrë – shok. – U
ruaj të mos hysh në sherr; por,
po të ngatërrohesh mbaj qëndrim
që kundërshtari yt të ruhet prej teje.
Jepi çdo njeriu veshin tënd, por pakëve zënë;
prano mendimin e çdo njeriu,
por mbaj për vete gjykimin tënd.
Të të kushtojnë rrobat sa kuleta jote mund t'i blerë,
por të mos bien në sy dhe të jenë pa shijë,
se rrobat shpesh tregojnë njerinë;

dhe në Francë ata që janë në shkallë të lartë
dhe në gjëndje, janë shumë elegantë
dhe dorëhapur në vesjen e tyre;
as huamarrës, as huadhënës të mos jesh,
se huadhënja shpesh humb veten e saj dhe mikun;
dhe huamarrja topit presën e kursimit.
Por këtë përmbi të gjitha
– në vetvete të jesh i vërtetë;
dhe kjo duhet të ndjekë si nata ditën,
t'i ahere s'mund të bëhesh i rremë për asnjeri.
Udhën e mbarë; dhe urata ime le të ndihmojë
që të arrihem këto këshilla tek ty.
Laerti – Me përulësi ju marr lejën time, Imzot.
Polloni– Koha të fton; shko, shërbëtorët tëp resin.
Laerti– *(Ngrihet)* Lamtumirë, Ofeli, dhe i mbaj mënd mirë ato që të thashë.
Ofelia – Ato janë kyçur në kujtesën time, dhe ti do tam bash hapsin e tyre.
Laerti– Lamtumirë. (*Përqafohen. Laerti del)*
Polloni– Ç'janë ato Ofeli, që të ka thënë?
Ofelia – Po ta pranosh, diçka që i përket imzot Hamletit.
Polloni– Për zotin, mirë qënka menduar;
më kanë thënë se tani vonë
t'i ke bërë me të shpesh takime të veçanta
dhe ke qenë nga ana jote shumë e lirë dhe
dorëhapur. Në se është kështu – siç më kanë thënë,
që në një farë mënyre të jem i kujdesshëm –
duhet të të them,
që ti s'e kupton veten tënde aqë qartë,
siç i ka hije bijës sime dhe nderit tënd.
Ç'ka midis jush? Thuam të vërtetën.
Ofelia – Ay më ka bërë, imzot, tani vonë shumë pohime për dashurinë e tij që ndjen për mua.

Polloni– Dashuri! Puh! Ti po më flet si ndonjë vajz' e mitur, e papjekur në të tilla çështje të rrezikshme. Dhe i beson ti, pohimet e dashuris' tij siç ti i quan?
Ofelia – Nuk e di, imzot si të mendoj.
Polloni– Do të të mësoj unë. Pandehe veten tënde foshnjë, që t'i kesh marrë këto pohime për pagesë të vërtetë, të cilat s'janë sterlina.
Çmoje veten tënde më shtrenjtë,
ose të ta them më çkoqur,
po të sillesh aqë e çkujdesur dhe e lirë,
do më bësh dhe mua gaz e botës.
Ofelia – Imzot, më ka folur me këmbëngulje për dashuri, në mënyrë të ndershme.
Polloni– Në mënyrë të ndershme, thua ti. Leri ato.
Ofelia – Dhe i ka përkrahur fjalët e tij, imzot, me të gjitha bet' e shënjta të qiellit.
Polloni– Po, grackë për të kapur shapkat.
E di, kur gjaku digjet, shpirti bëhet i pakursyer,
i huan gjuhës bëra; këto flakë, bijë, që japin
më shumë dritë, se të ngrohtë – shuhen në të dya
– edhe në premtimin e tyre, ndërsa që po bëhen
dhe s'duhet t'i marrë për zjarr. Tani e tutje
bëhe më të rrallë paraqitjen tënde virgjërore.
Takimet e tua le të kenë çmim më të lartë,
sesa të bëhen me porosi për t'u fjalosur.
Sa për imzot Hamletin, beso aqë tek ay,
se ay është i ri, dhe mund të bredhë me tërkuzë
më të gjatë, sesa mund të të jepet ty;
me pak fjalë, Ofeli, mos i beso bet' e tij,
se ato janë mashtronjëse, dhe s'kanë atë ngjyrë,
që rrobat e tyre dëftejnë,
po krejt ganece me dëshira të turpshme,
flasin si kodoshe të shënjtëruara,
që më mirë të të gënjejë.

Këtë ta them një herë e përgjithnjë,
me fjalë të qarta,
tani e tutje asnjë minutë të mos humbsh
për të çnderuar veten duke i çuar fjalë,
ose të flasësh me imzot Hamletin.
Shiko mirë, të urdhëroj! Eja në udhën tënde!
Ofelia – Do të bindem, Imzot.*(Dalin)*

Skena e katërt

Në bedenat e kështjellës.
Hyjnë Hamleti, Horati dhe Marceli .

Hamleti– Të pret era; është shumë ftohtë.
Horati – Të cimbidh dhe është e hidhur.
Hamleti– Sa është ora tani?
Horati – Duhet të jetë afër dymbëdhjetës.
Marceli – Jo, sahati ra.
Horati – Vërtet? Nuk e dëgjova; Ahere afron koha që
Fantazma e ka zakon të ecij.
(Bien fanfare trumpetash; dëgjohen dhe dy të shtëna topi brënda në kështjellë)
Ç'kuptim kanë këto, imzot?
Hamleti– Mbreti e gdhin sonte, bën aheng,
gostitet, pi dolli, tundet dhe kërcen valle;
dhe siç po derdh verën e Rinit në gurmaz,
daullja dhe trumpata ashtu pëllasin[6]
triumfin e të pirit të tij.
Horati – Është kjo zakon?
Hamleti– Po, për zotin është;
Por në mëndjen time, ndonëse jam vëndas
dhe me të lindur – ky është një zakon që nderohet
më tepër në shkeljen sesa në mbajtjen e tij.
Ky dëfrim dhe e pirë xurxull na poshtëron në lindje
dhe në perëndim, bën që të na përbuzin dhe të na
urrejnë kombet e tjerë;
ata na quajnë pijanecë dhe me shprehje derrash
na ndyjnë emrin tonë, dhe në të vërtetë ajo na ul
cilësit tona, gjallërinë dhe famën e lavdisë sonë,
ndonëse i kemi fituar me trimëri.
Kështu dëndur ngjet me njerëz të veçantë,
që kanë ndonjë cen të keq nga natyra,

si në lindjen e tyre, në të cilën, ata s'janë fajtorë,
me që natyra s'mund ta zgjedhë origjinën e tyre –
prej ndonjë tabijeti shumë të zhvilluar
shpesh shemben gardhet dhe kështjellat e arësyes,
ose prej ndonjë zakoni që ndrron shumë
formën e këndshme të sjelljeve; - që këta njerëz,
mbarin, them, vulën e një të mete,
qoftë nishan i natyrës, ose njolla e fatit, -
virtutet e tjera të tyre – qofshin të thjeshta sa hiri,
dhe aqë të shumta sa njeriu mund të mbarë,
në gjykimin e përgjithshëm do të marrin njollë
nga ajo e meta e veçantë.
Dërhemi i keq e zbret tërë lëndën bujare
në nivelin e vetes së tij të poshtër.

(Hyn Fantazma)

Horati – Vështro, imzot, po vjen!

Hamleti– Ëngjëj dhe shënjtër të perëndisë,
mbrenani! Qofsh t'i shpirt i bekuar, apo kukudh i
mallkuar, sjell t'i erë qielli, apo tym nga ferri,
qofshin qëllimet e tua të këqia, apo mirëbërëse,
ti vjen në të atillë trajtë të dushimtë,
që unë do të të pyes për të zbërthyer çështjen.
Do të të quaj Hamlet,
mbret, atë; lartmadhëri danez, përgjigjmu mua!
Mos më lerë të pëlcas në errësirë; po thuam
pse eshtrat e tua të kënduara dhe në varr mbuluar
kanë çarë savanet e tyre?
Pse varri,ku brënda të pamë të qetë varrosur,
ka hapur nofullat e tij të rëndë prej mermeri
të të hedhë lartë përsëri? Ç'kuptim ka kjo,
që ti kufomë e vdekur, përsëri tërë çelik,
riçfaqesh kështu në vezullimet e hënës,
duke shëmtuar natën; dhe neve njerëzve që bëhemi
si budallenj përpara fenomeneve mbinatyrale,

të na tronditësh tmerrësisht gjëndjen tonë mendore
me mendime përtej cakut të shpirtrave tona;
thuaj, pse? Për ç'arësye? Ç'duhet të bëjmë ne?
(Fantazma i bën shënjë me dorë Hamletit)
Horati – Të bën shënjë t'i vesh pas,
sikur do të të thotë diçka ty vetëm.
Marceli – Vështro se me ç'sjellje obortare
ta bën me dorë që të vesh në ndonjë vënd mënjanë;
po mos çap!
Horati – Jo, në asnjë mënyrë.
Hamleti– Nuk do të flaës; prandaj do t'i vete pas.
Horati – Mos, imzot!
Hamleti– Pse të mos vete?
Unë s'e çmoj veten time me vleftën e një kërfice;
dhe sa për shpirtin, ç'mund t'i bëjë atij,
me që është një gjë e pavdekshme, siç është ay vetë;
ma bën me dorë përsëri; do t'i bie pas.
Horati – Po sikur të të shpjerë drejt detit, imzot,
ose në majën e shkëmbit të tmerrshëm që shtrihet
nga rrëza mbi ujë, dhe atje të marrë ndonjë formë
tjetër të tmerrshme, dhe të të shtyjë të humbsh
forcën e arësyes tënde dhe të të bëjë të marrosesh?
Jo, mendohu, se atje vetë vëndi ndjell trille
dëshpërimi pa shkak në trutë e çdo njeriu
që vështron thellë në fund të detit
dhe e dëgjon të buçasë nën këmbët e tij.
Hamleti– Po ma bën me dorë akoma.
Shko përpara; do të të vij pas.
Marceli – Nuk të le të vesh, imzot!
Hamleti– Hiq duart!
Horati – Mbaj veten; nuk të le të vesh!
Hamleti– Fati im po më thërret,
dhe më bën dhe damarin më të vogël të trupit tim
aqë të fortë sa nervat e luanit të Nemesë.

(Fantazma i bën shënjë)
Akoma më thërret; lëshomëni, zotërinj;
(Shkëputet prej tyre)
për zotin do ta bëj lugat atë që do të më ndalojë;
ja ku u them hiquni mënjanë!
Shko përpara, do të vij pas!
(Dalin Fantazma dhe Hamleti)
Horati – Nga përfytyrimet po i shtohet dëshpërimi.
Marceli – Eja t'i biem pas; nuk bën t'i bindemi kështu.
Horati – T'i biem. Po ku vallë do t'i falë fundi?
Marceli – Ka diçka të kalbur në shtetin e Danimarkës.
Horati – Perëndia do ta zbulojë.
Marceli – Jo, të mos e lemë atë te perëndia, pot ë bëjmë diçka vetë. Eja ta ndjekim.
(I bien pas)

Skena e pestë

Një vënd më tutje, rrëzë bedenave.
Hyn Fantazma dhe Hamleti.

Hamleti– Ku do të më shpiesh? Folë! S'vij më tutje.
Fantazma – Dëgjo!
Hamleti– Dëgjoj.
Fantazma – Ora ime pothuajse ardhi,
kur unë në flakë prej squfuri dhe mundimesh
duhet të dorëzoj veten time.
Hamleti– Bobo, lugat i mjerë!
Fantazma – Mos u hidhro për mua, po dëgjo me
vëmendje ato që do të të zbuloj.
Hamleti– Folë; jam gati të dëgjoj.
Fantazma
– I tillë do të jesh dhe në hakmarrje kur t'i dëgjosh.
Hamleti– Çfarë?
Fantazma – Jam fryma e tyt'eti;
i dënuar për një kohë të caktuar të ecij natën,
dhe ditën i burgosur të tretem në zjarr,
gjersa krimet e urrejtura që bëra në ditët e jetës sime
të digjen e të pastrohen.
Dhe vetëm sikur të mos isha i ndaluar të them
të fshehtat e burgut tim, do mundja të tregoja
një histori, fjala më e lehtë e së cilës do të ndrydhte
shpirtin tënd; do të të ngrinte gjakun tënd të ri;
do të t'i bënte të dy syt' e tu, si yj të kërcenin
nga gropat e tyre,
krellat e tu të lidhura komb do të shpupuriseshin,
dhe çdo qime e kokës do të ngrihej më këmbë
si gjëmbat e iriqit kur egërsohet;
po këto të fshehta të përjetshme s'duhen zbuluar
në veshë prej mishi dhe gjaku.

Dëgjo, dëgjo, o dëgjo! Nëqoftëse e ke dashur atin tënd të shtrenjtë ndonjëherë!
Hamleti– O perëndi!
Fantazma – Merr hakun e vrasjes së urrejtur dhe çrenjëzore të tij.
Hamleti– Vrasje?
Fantazma – Vrasje e urrejtur, siç janë të gjitha vrasjet; po kjo është më e urrejtura, më e çuditshmja dhe më çnjerëzoreja.
Hamleti– Thuam sa më parë ta mësoj, që me krahë të shpejtë si mendimi, apo si mendimet e dashurisë, të fluturoj në hakmarrjen time.
Fantazma – E shikoj që je gati;
dhe më i mefshtë do të ishe se badra e majme,
që rritet e çkujdesur anës Lethit,[7] po të mos
tronditesh nga kjo. Tani, Hamlet, dëgjo: kanë dalën
fjalë, se gjoja, siç flija në kopshtin tim, më kafshoi
një gjarpër, ashtu me një proces të rremë për vdekjen
time të gjithë veshët e Danimarkës
u mashtruan keq; po, mëso, i ri bujar,
gjarpri që kafshoi jetën e tyt'eti
tani mban kurorën e tij.
Hamleti– O parandjenjë e shpirtit tim! Im ungj?
Fantazma – Po, ay incestar, ajo shtazë adultare,
me magjitë e zgjuarsisë tij, me dhurata tradhtare, o
zgjuarsi e poshtër dhe dhurata që kanë fuqi ashtu të
të gënjejnë;
fitoi në epshet e tij të turpshme vullnetin që dukej aq
i virtutshëm të mbretëreshës sime;
O Hamlet sa poshtë që ka rënë ajo! Nga unë,
që dashuria ime ishte e një dinjiteti të atillë,
Që ecte krah për krah dhe me betë që i kasha bërë
asaj kur u martuam; dhe të bjerë
në një të poshtër, dhuratat natyrore të të cilit,

ishin hiçgjë përpara të miave.
Po sikundër virtuti s'tundet kurrë,
Ndonëse nepsi i bën korte në mënyrë hyjnore,
ashtu epshi, ndonëse është lidhur me një ëngjëll të
ndriçmë, do të ngopjë veten e tij në një shtrat qiellor
dhe bie pre mbi plehra.
Po dale. Më duket ndjej erën e mëngjesit;
pra do flas shkurt. Siç flija në kopsht,
sipas zakonit tim, gjithnjë pas mesit ditës,
pa dyshim rreziku, yt ungj vjen fshehurazi,
me lëngun e mallkuar të madërgonës në një shishe,
dhe në portat e veshëve tim e derdhi
gërbulën e destiluar; efekti i së cilës
është aq hasmë i madh në gjakun e njeriut
saqë me nxitim si engjërdhia, udhëton
nëpër shtigjet dhe ulicat natyrore të trupit;
dhe me një gjallëri të papritur ajo pret
dhe piks, si pikat e tharta qumështin,
gjakun e thjeshtë e të shëndoshë;
ashtu e bëri timin; dhe në atë çast
m'u çfaq lepra në trupin tim,
si gërbulë, me një koriçkë të ndyrë e të urryer,
mbi tërë lëkurën time të butë.
Ashtu siç flija, prej dorës së vëllait, jetën, kurorën
dhe mbretëreshën përnjëheresh i humba;
u preva në lulëzim e sipër të mëkatave time,
i pakunguar, pa u ndjerë, e pa u rrëfyer;
pa bërë pendim, po u dërgova në gjykimin tim
me të gjitha gjynahet mbi kryet e mia;
O, tmerr! O, tmerr! O, çfarë tmerr!
Në ke ndjenja në veten tënde, mos e duro;
Mos e lëre shtratin mbretëror të Danimarkës
të bëhet minder për neps dhe incest të mallkuar.
Po si do që ta kryhesh këtë veprim,

mos e përlyej shpirtin, as mëndjen të mos e lesh
të bëjë gjëkafsh kundër sat'ëme.
Lere atë tek i larti dhe tek ajo, gjëmbat,
që banojnë në gjirin e saj, ta shpojnë dhe thumbosin.
Rri me shëndet menjëherë!
Bukureza dëften se mëngjezi po afrohet,
dhe fillon ta zbejë dritën e saj të venitur;
Rri me shëndet, rri me shëndet, rri me shëndet!
Dhe mbamë mënd!
(Fantazma zhduket; Hamleti bie i hutuar më gjunjë.)
Hamleti– O tërë ju turmat e qiellit! O dhe! Çfarë
tjetër? Të vë dhe ferrin? O, puh! Mbahu, mbahu,
zëmra, ime; dhe ju, gilcat time, mos u mplakni
përnjëherësh,po mbamëni të ngurtë më këmbë.
(*Ngrihet*) Të të kujtoj? Po, lugat i mjerë, ndërsa
kujtesa mban fron. Në këtë rruzullin e ngatërruar.
(*Vë gishtin në kokë.*) Të të kujtoj? Unë bile do të fshih
nga pllaka e kujtesës sime tërë shënimet e
vogëlsirave të paurta, tërë të thënat e librave, tërë
format, tërë përfytyrimet e kaluara,
që të rritë dhe vëzhgimi kapioi atje;
dhe urdhri yt vetëm filli do të rrojë
përbrenda librit dhe fletëve të trurit tim,
i papërzjerë me lëndë të poshtër; po, për perëndi!
O shumë e poshtër grua!
O keqbërës, keqbërës, me buzë të qeshur dhe i
mallkuar keqbërës!
Ku është fletorja ime? Këtë duhet ta shënoj *(shkruan)*
që një mund të buzëqeshë,
dhe buzëqesh, dhe prapë të jetë keqbërës;
të paktën jam i sigurtë
që kështu është në Danimarkë.
Pra, xhaxha, këtu të kam. Tani në parrullën time,
ajo është: Rri me shëndet, rri me shëndet! Kujtomë!

(Die në gjunjë dhe vë dorën përmbi myllin e shpatës dhe lutet.)

U betova!

(Hyjnë Horati dhe Marceli)

Horati – *(Duke kërkuar Hamletin)* Imzot, imzot!

Marceli – *(Duke kërkuar gjithashtu)* Imzot Hamlet!

Horati – Zoti ta ruaj!

Hamleti– Ashtu qoftë! *(Ngrihet)*

Horati – Ej, imzot!

Hamleti– E ore, e! Eja, zok, eja!

Marceli – Ç'është, bujari im, imzot?

Horati – Ç'të reja, imzot?

Hamleti– O, të çuditshme!

Horati – Mirë, imzot, na i thuaj.

Hamleti– Jo; ju do t'i tregoni.

Horati – Ju unë, imzot, për perëndi.

Marceli – As unë, Imzot.

Hamleti– Ç'thoni ahere, a e mendoni atë mëndje njeriu ndonjëherë? Por do ta mbani të fshehtë.

Horati dhe Marceli – Po, për perëndi, imzot!

Hamleti– S'gjëndet keqbërës në tërë Danimarkën, po, ay është një vagabond kopil. [8]

Horati – S'është e nevojshme, imzot të vijë lugati që nga varri të na e thotë këtë.

Hamleti– Po, me të vërtetë; ke të drejtë;
dhe kështu pakëmbyer më tepër fjalë
unë e gjej të përshtatshme të shtrëngojmë duart
dhe të ndahemi;
ju si pas punëve dhe dëshirave tuaja,
se çdo njeri ka punë dhe dëshira,
çfarëdo që janë, dhe unë i mjeri për pjesën time,
ja shikoni, do të vete të falem.

Horati – Këto janë fjalë të egra dhe të turbullta, Imzot.

Hamleti– Më vjen keq nga zëmra, që të fryejnë;
po, për besë, nga zemra.
Horati – Jo, imzot, nuk është fyerja.
Hamleti– Po, për shën Patrikun, është, Horat,
dhe bile fyerja e madhe.
Përsa i përket kësaj pamjes këtu,
- kaq do t'ju them, që ay është lugat i vërtetë;
dhe jo shejtan në formë të këndshme.
Për dëshirën tuaj që doni të mësoni
se ç'ka në mes tënë, përmbahemi sat ë mundni. Dhe
tani, miq të mirë, sikundër jini miq,
shkollarë dhe ushtarë, bëmëni një shërbim të vogël.
Horati – Ç'është, imzot? Jemi gati ta kryejmë.
Hamleti– Kurrë të mos dëfteni se ç'patë sonte.
Horati dhe Marceli – Imzot, nuk do të dëftejmë.
Hamleti– Jo, po betoheni!
Horati – Për besë, imzot, jo unë.
Marceli – As unë, imzot, për besë.
Hamleti– Mbi shpatën time.
Marceli – Ne posa u betuam, Imzot.
Hamleti– Jo me fjalë vetëm, po me vepra; mbi kryqin
e shpatës sime, zotohuni.
Fantazma– *(Nën të)* Betohuni!
Hamleti– Këtu dhe kudo! Ahere do të ndërrojmë
vëndin, ejani më këtej, zotërinj,
dhe vërini duart përsëri mbi shpatën time, -
betohuni mbi shpatën time,
kurrë të mos flisni për këto që dëgjuat.
Fantazma– *(Nën të)* Betohuni!
Hamleti– Mirë thua, iriq plak.
Por mund ti të punosh aqë shpejt në dhe?
(Betohen përsëri në heshtje)
Mirator i denjë! Le të lozim edhe një herë
nga vëndi, imzotët e mi të mirë.

Horati – Për ditën dhe natën, por kjo është
çuditërisht e huaj!
Hamleti– Dhe prandaj si një të huaji jepi mikpritje.
Janë më tepër gjëra në qiej dhe në dhe, Horat
se sa ëndërron filozofia jote.
Po, ejani; -
këtu si më parë, kurrë, ashtu u ndigtë mëshira e
zotit, sado i çuditur ose i veçantë do të sillem,
sipas rastit tani e tutje, do ta mendoj, përshtat,
të vë një dukje me marrosje të rremë,
dhe kur të më shihni të tillë, kurrë të mos
kryqëzoni krahët në shenjë urtie,
ose të tundni kështu kryet,
ose të shqiptoni ndonjë frazë të dyshimtë,
se gjoja, mirë, mirë, i dimë, ose në mundnim,
po të donim,ose po të dëshëronim të flisnim;
ose po të jetë një i lirë të flasë,
ose të tilla fjalë të errta, që lenë të kuptohen,
se ju dini diçka për mua; këto të mos i bëni,
ashtu hiri dhe mëshira në nevojën tuaj
më të keqe, u ndihmofshin. Betohuni!
Fantazma – *(Nën të)* Betohuni!
(Betohen për të tretën herë)
Hamleti– Prehje, prehje, shpirt i çqetësuar! Dhe tani,
zotërinj, ju fal gjithë dashurinë time, nderin dhe
veten time te ju:
dhe ç'mund të bëjë një njeri kaq i varfër si Hamleti,
që t'ju çfaqnjë dashurinë dhe miqësinë e tij,
po perëndia në dashtë, nuk do të mungojë.
Pra, le të vemi brënda bashkë.
Dhe ju lutem të mbani gishtrinjtë mbi buzët tuaja.
Koha ka dalë nga kyçet e saja; o dispjek i mallkuar,
që qënkam lindur këtë për të drejtuar!
Jo, ejani të vemi bashkë. *(Hyjnë në kështjellë).*

AKTI I DYTË

Skena e parë

Një dhomë në shtëpinë e Pollonit.
Hyjnë Polloni dhe Rejnaldi.

Polloni– Jepi këto të holla dhe këto letra, Rejnald.
Rejnaldi – Po, Imzot.
Polloni– Do të veprosh urtësisht, Rejnald i mirë,
para se ta takosh të pyesësh për sjelljen e tij.
Rejnaldi – Imzot, e kasha ndërmend vetë.
Polloni– Besa, fjalë me vënd, fjalë me vënd the.
Shiko, zotëri, sefte pyet ç'danezë janë në Paris,
dhe si, dhe cilët, ç'të ardhura, dhe ku bajnojnë,
ç'shoqëri dhe me ç'shpenzime; dhe si t'i gjesh,
tërthorazi dhe me dredhinë e pyetjes,
ata që njohin birin tim, u vete më afër
se sa kërkimet e tua të posaçme do ta cikin;
bëju, dua të them, sikur je një i njohur i largët me të,
në mënyrë që njeh të jatin e tij dhe miqt e tij, dhe atë
pak; më kupton, Rejnald?
Rejnaldi – Po, shumë mirë, Imzot.
Polloni– "Dhe vet atë pak"; po, ti mund të thuash:
"S'e njoh mirë"; po në qoftë se ay që them është
shumë i përmbajtur, i dhënë pas kësaj ose pas asaj;
ahere ngarkohe atë me çdo të rremë që të pëlqen,
besa jo me ndonjë aqë të poshtër,
që mund ta çnderojë; këtë e ki kujdes;
po, zotëri, me të tilla tërbime pafre
dhe rrëshqitje të zakonshme,
që janë shokë të dalluar dhe më të njohur
të rrinisë dhe lirisë.
Rejnaldi – Për shëmbëll kumar, Imzot.

Polloni– Po, ose pi, skermon, blasfemon, zihet,
kurvëron; ti mnd të vesh deri atje.
Rejnaldi – Imzot, kjo do ta çnderojë.
Polloni– Për besë, jo; se ti do t'i zbutësh me takt
ngarkesën, por të mos i vësh një tjetër më të çthurur
dhe zakon të papërmbajtur.
Ky s'është kuptimi im;
po t'i shprehësh gabimet e tij me aqë mjeshtëri,
që ato të duken si ngjyrat e lirisë,
shkrepëtima dhe shpërthimi i një mëndje të zjarrtë,
një egërsi në gjakun e pazbutur,
që të gjithë të rinjtë mund t'u nënshtrohen.
Rejnaldi – Po, i mirë Imzot.–
Polloni– Për ç'arësye do ta bësh këtë?
Rejnaldi – Po, imzot, atë dua të mësoj.
Polloni– Për besë, zotëri, ky është qëllimi im,
dhe besoj është një mashtrim i garantuar;
duke spërkatur këto njolla të lehta mbi tim bir,
sikur ay, të themi, në marrëdhëniet me botën, me
domosdo ka marrë ca ndotje të vogla,
vërë re, bashkëfolësi yt, atë që ti do të hetosh,
pa ta ketë parë ndonjëherë në fajet e përmendura
të rinë që ti e ngatërron për fajtor, ji i sigurtë
do të mbetet dakord me të ty në sa vijon:
"I mirë imzot, diçka të tillë, ose mik, ose fisnik,
sipas shprehjes ose titullit, të njeriut dhe të vëndit."
Rejnaldi – Shumë mirë, Imzot.
Polloni– Dhe shere, zotëri, ay do të bëjë këtë,
ay do të bëjë, - doja të të thosha?
Për besë diçka do të thosha; ku e lashë?
Rejnaldi – Te dakord, në sa vijon, te miku,
ose diçka të tillë dhe te fisniku.
Polloni– Te dakord, në sa vijon, po, për zotin;
ay do të pajtohet me ty në këtë mënyrë:

- e njoh fisnikun: e pashë dje, ose pardje, ose ahere,
me atë, ose me këtë, dhe ashtu si thua ti,
atje luante kumar, atje e gjenë të dehej,
atje zihej në tennis; ose rastësisht,
e pashë të futej në një shtëpi të atillë që paguajn,
domethënë në bordello, ose të tjera të tilla.
E sheh ti tani, me gamrrën tënde të rremë zë
peshkun me të vërtetë;
kështu bëjmë ne që jemi të urtë dhe largpamës,
me mjete dinake dhe veprime të tërthorta,
në mënyrë indirekte ne gjejmë të drejtën që duam të
dimë; ashtu, dhe ti pas mësimit dhe këshillit tim,
do t'i bësh birit tim. Më kuptove, apo s'më kuptove?
Rejnaldi – Të kuptova, Imzot.
Polloni– Perëndia të ndihmoftë; udhën e mbarë.
Rejnaldi – Po, i mirë, imzot!
Polloni– Vëzhgoja me syt e tu prirjet e tij.
Rejnaldi – Po, Imzot.
Polloni– Dhe lere atë t'i bjerë muzikës së tij.
Rejnaldi – Mirë, Imzot.
Polloni– Udhën e mbarë. *(Rejnaldi del)*
Hyn Ofelia
Ofelia – Çfarë! Ç'është shkaku?
O, imzot, imzot, sa jam trëmbur!
Polloni– Nga se në emër të perëndisë?
Ofelia – Imzot, siç po qepja në dhomën time,
imzot Hamleti, me setrën e tij të tërë të shkopsitur,
pa kapellë në krye, çorapët të lirë, pa toje dhe të rënë
si hallka gjer në kërcinjtë; i bardhë si këmisha;
gjunjët i përpiqeshin njëri me tjetrin.
Dhe me një shprehje aqë për të ardhur keq
në fytyrë, që sikur ishte liruar nga ferri
për të treguar llahtaritë, erdhi përpara meje.
Polloni– I marrë nga dashuria për ty.

Ofelia – Imzot, nuk e di. Po me të vërtetë që jam kam frikën kësaj.
Polloni– Ç'të tha?
Ofelia – Më kapi qafën e dorës dhe ma mbante shtrënguar; pastaj u zbraps sa gjatësi e krahut të tij, dhe me dorën tjetër, kështu përmbi vetullat, zuri të më vëzhgojë fytyrën në mënyrë të atillë, sikur do ta vizatonte.
Qëndroi kështu gjatë,
më në fund si më tronditi pak krahun,
dhe duke tundur tri herë kokën
kështu posht e lartë, - nxori një psherëtimë
aqë të brengosur dhe të thellë,
sa u duk sikur do t'i pëlciste tërë trupin,
dhe do mbaronte qënien e tij, si bëri këtë, më lëshoi;
dhe me kokën e tij të kthyer përmbi supet,
ay dukej se gjente udhën pa shikuar,
se dolli përjashta pa ndihmën e syve, dhe e mbërtheu gjer në gund dritën e tyre përmbi mua.
Polloni– Eja me mua, do të vete të kërkoj mbretin. Ky është ekstazi thjesht i dashurisë;
që prona e saj e furishme prish veten dhe prin vullnetin në ndërmarrje të dëshpëruara aqë shpesh sa çdo pasion tjetër nën diellin që mundon natyrat tona. Më vjen keq! Mos i ka thënë gjëkafsh fjalë të ashpra tani vonë?
Ofelia – Jo, i mirë imzot, po ashtu siç më urdhrove, ja ktheva letrat dhe refuzova të takohemi ose të vijë pranë meje.
Polloni– Kjo e ka marrosur. Më vjen keq që s'e vëzhgova me kujdes dhe gjykim më të mirë.
U trëmba se mos vetëm loste dhe do të të merrte në qafë, po i mallkuar qoftë dyshimi im!

Për zotin kjo është e përshtatshme në moshën tonë
të hedhim dhelpëritë më tutje se arësya mund t'i
shoqërojë, siç është e ditur për rendin e të rinjve,
që u mungon gjykimi. Eja të vemi te mbreti.
Duhet t'ia njoftojmë; se në e mbajtshim të mbuluar,
mund të bëhet më keq, se dashuria shkakëton më
shumë hidhërim pot a fshehësh, se sa inat kur
sheshit e këndon. Eja.

(Dalin)

Skena e dytë

Në Elsinor. Një dhomë në kështjellë.
Dëgjohen fanfare. Hyjnë Klaudi , Gertruda,
Rozenkranci, Guidelsterni dhe shoqëronjës.

Klaudi – Mirëseardhtë të shtrenjtë Rozerkranc dhe
Guidelstern! Përveç kësaj që na kishte marrë malli
t'ju shihnim, nevoja që kemi për shërbimet tuaja
shkakëtoi thirrjen tonë të ngutë.
Do të kini dëgjuar diçka për ndryshimin e Hamletit;
se ashtu e quaj unë atë,
mbasi as i jashtmi, as i brendshmi njeri
ngjet me atë, që ay ishte. Çfarë do të jetë kjo,
përveç se vdekja e t'et, që ta ketë turbulluar
aqë shumë sat ë mos kuptojë veten e tij,
se marr dot me mënd. Ju lutem që të dyve,
me që kini qënë bashkë qysh fëmijë dhe më të rritur
dhe mbasi kini një moshë dhe dëshira,
të jini të hirshëm mjaft të prehi këtu në oborrin tonë
ca pak kohë; dhe me shoqërimin tuaj
ta tërhiqni në dëfrime dhe të mblidhni
diçka dhe kur t'ju jepet rasti – në gjetshi
gjësendi të panjohur që e mundon atë, ashtu
ajo po të zbulohet – brënda është ilaçi ynë.
Gertruda – Besnikë të mirë, ay fliste dëndur për ju
dhe jam e sigurtë, që dy njerëz të tjerë në botë
s'rrojnë,
të cilët ay adhuron më tepër. Po të kini kënaqësinë
të na tregoni aqë fisnikëri dhe vullnet të mirë,
as të harxhoni kohën tuaj me ne për ca pak kohë,
të na ndihmoni për realizimin e qëllimit tonë.
Vizita juaj do të ketë të tilla falënderime
Siç i ka hije kujtesës së një mbreti.

Rozenkranci – Të dy madhërit tuaj
mundni nga pushteti Sovran që kini përmbi ne,
të ushtroni kënaqësinë tuaj të rëndësishme
më tepër me urdhër se sa me lutje.
Guidelsterni – Po ne të dy bindemi dhe ju falim vetet
tona me dëshirë të zjarrtë dhe ju shtrojmë shërbimet
lirisht në këmbët tuaja që t'i urdhëroni.
Klaudi – Ju falnderoj Rozenkranc dhe fisnik
Guidelstern.
Gertruda – Ju falnderoj Gudelstern dhe fisnik
Rozenkranc. Dhe ju lutem ta vizitoni menjëherë
birin tim të ndërruar shumë. Shkoni ca prej jush
dhe shpjerini këta fisnikë atje ku Hamleti është.
Guidelsterni – Perëndia e bëftë afrimin dhe
shërbimet tona të pëlqyera dhe të dobishme!
Gertruda – Po, ashtu qoftë!

(Dalin Rozenkranci,
Guidelsterni dhe disa shoqëronjës)
Hyn Polloni

Polloni– Ambasadorët nga Norvegjia, i mirë imzot,
u kthyen shumë të gëzuar.
Klaudi – Ti gjithnjë ke qënë babai i të rejave të mira.
Polloni– Vërtet, imzot?
Të siguroj lartmadhëri, që unë e ndjej detyrën time,
siç ndjej shpirtin tim, në të dy, te perëndia ime dhe
tek i hirshmi mbreti im. Dhe mendoj se ky truri im
s'do ta gjuante vazhdën e dinakërisë me aqë siguri,
siç bëra unë që gjeta shkakun e sëmundjes së hënës
të Hamletit.
Klaudi – O, thuama, se dhe unë atë dua të dëgjoj.
Polloni – Sefte pranoni ambasadorët:
të ratë e mia do të jenë e gostisë së madhe.
Klaudi – Priti me nderime dhe silli brënda.
(Polloni del)

Më thotë, Gertruda ime e shtënjtë, se ka gjetur
kryen dhe burimin e turbullimit të tët' biri.
Gertruda –Dyshoj se s'është tjetër përveç kryesores,
- vdekja e të jatit dhe martesa jonë me nxitim.
Klaudi – Po, mirë, do ta shoshitim.
(Hyn përsëri Polloni me Voldimandin dhe Kornelin)
Thuaj Voldimand, ç'kemi nga Norvegjia, vëllai ynë?
Voldimandi – Ju dërgonë përshëndetje dhe urime të
mira, që me pritjen e parë dha urdhër të ndalohen
rekrutimet e të nipit, të cilat atij i dukeshin, se qenë
pregatitje kundër Pollonisë,
po kur i pa me vëmendje, i gjeti me të vërtetë
se ato ishin kundër madhërisë suaj;
të cilat u hidhërua, që ashtu me të pabesë
plakun e sëmurë dhe patakat e mashtruan,
dërgoi urdhër kudo t'i qëndrojnë
veprimet e Portinbrasit, i cili u bind menjëherë
dhe u qortua prej mbretit, dhe më në fund
u betua para ungjit të tij kurrë më
të mos provojë armët kundër madhërisë suaj.
I mallëngjyer nga gëzimi, novergjezi plak,
i jep tri mirë korona shpërblim vjetor
dhe autorizim të përdorjë ushtarët
e rekrutuar, si më parë, kundër Pollonisë;
me një lutje, këtu brënda çfaqur,
që mund të të kënaqë, t'i japsh kalim të lirë
përmes shtetit tuaj për këtë ndërmarrje,
me kondita që garantojnë sigurimin e vëndit
dhe rrëgullojnë kalimin e trupave përmes tij,
sikundër aty brenda i ka shkruar.
Klaudi – Na pëlqen shumë; dhe në kohën tonë më të
volitshme do ta lexojmë, do t'i përgjigjemi dhe do
mendohemi mbi këtë çështje.
Ndërkohë ju falënderoj për punën tuaj të mirë.

Shkoni të çlodheni! Sonte do të gostitemi bashkë.
Jemi të lumtur që ju shikojmë prapë këtu.
(Voldimandi dhe Korneli dalin)
Polloni– Kjo çështje madhëria, ç'është detyra, pse
dita është ditë, nata natë, dhe koha kohë, do mos bëj
asgjë veçse të harxhoj natën ditën dhe kohën.
Prandaj, meqë shkurtimi është shpirti i zgjuarsisë,
dhe zgjatja, gjymtyrat dhe lulëzimet e përjashtme,
do të shprehem shkurt.
Yt bir bujari është i marrë: të marrë e quaj;
se të caktosh vërtetësinë e marrëzisë,
se ç'është prapë s'është asgjë tjetër veçse marrëzi?
Po le ta lemë këtë.
Gertruda – Më tepër lëndë, më pak mjeshtri.
Polloni– Zonjë, betohem, s'përdor mjeshtëri aspak,
që ay është i marrë, është vërtet;
është vërtet dhe është gjynah, dhe gjynah është,
që është vërtet, një figurë e padenjë;
po udhën e mbarë për këtë,
se nuk do të përdor mjeshtëri.
Të marrë pra, le ta pranojmë shere;
dhe tani mbetet që të gjejmë shkakun e këtij efekti,
ose më mirë të themi, shkakun e kësaj të more,
se ky efekt i metë vjen nga ndonjë shkak.
Kështu kjo mbetet dhe mbetja është kjo.
Gjykoni. *(Nxjerr letra nga gjiri i tij)*
Unë kam një bijë, - e kam bijë derisa është imja,
- e cila prej detyrës saj dhe bindjes, shikoni,
më ka dhënë këto;
tani mblidhuni dhe merreni me mend.
(Lexon)
Qiellores dhe idhullit të shpirtit tim,
të stërbukurës Ofeli, -
kjo është frazë e keqe, shprehje e poshtër,

"të stërbukurës", po le të dëgjojmë. Kështu, -
(Lexon) Në të shkëlqyerin dhe të bardhin gjirin tënd!
– këto dhe të tjera.
Gertruda – E ka marrë nga Hamleti këtë?
Polloni – Zonjë e mirë, prit pak; do ta lexoj fjalë për fjalë. *(Lexon)*

Dysho se yjtë janë zjarr,
dysho dhe se dielli luan,
dysho çdo gjë në botën mbar,
por mos dysho se a të dua.

O e shtrënjtë Ofeli, jam i pafuqishëm me këto vargje,
s'kam mjeshtërinë t'i numroj psherëtimat e mia,
po që të dashuroj shumë, o shumë e dashur, besomë.
Lamtumirë!
Yti për jetë, shumë e shtrenjtë zonjë,
Derisa ky trup është imi, Hamlet.
Këtë bija ime e bindur ma dëfteu;
por veç kësaj dhe nxitjet e tij,
siç u bënë në ç'kohë, me ç'mjet dhe ç'vend,
të gjitha m'u kumtuan në veshin tim.
Klaudi – Po si e konsideron ajo dashurinë e tij?
Polloni– Ç'mendoni ju për mua?
Klaudi – Si për një njeri besnik dhe të ndershëm.
Polloni– Ne kënaqësi do ta provoj këtë.
Po çdo të mendonit ju,
kur e pashë këtë dashuri të zjarrtë në fluturim, -
(Siç e dallova atë dhe duhet që t'ju them,
më parë se të ma thotë ime bijë)
çdo të thoshit ju, ose e shtrënjta madhëria e saj,
mbretëresha juaj këtu, çdo të thoshte.
po ta kasha kuçyr këtë secret në gjirin tim,
aqë fshehtë, sikur ta kasha mbyllur në një sirtar,
apo në fletore shënimesh?

Ose t'i mbyllja syrin zëmrës,
të heshtte, të bëhej memece,
ose ta shikoja këtë dashuri me vështrim përtac,
- çdo të mendonit ju? Jo, unë veprova me urtësi,
dhe zonjushes sime të re kështu i thashë:
Imzot Hamleti është princ, nuk është i shkallës sate;
kjo patjetër të mos bëhet; dhe shere i dhashë urdhër,
që ajo të kuçjë veten e saj nga takimet e tij,
të mos pranojë lajmëtarë, simbole të mos marrë,
të cilat mbasi i bëri, mori frutat e këshillës sime;
dhe ay zbrapsur, një tregim të shkurtër të bëj,
ran ë melankoli, pastaj në agjërim,
pastaj në pagjumësi, pastaj në dobësi,
pastaj në kokëlehtësi, dhe prej këtij lakimi
në çkallim në të cilin ay çarton
dhe të gjitha ne vajtojmë.
Klaudi – Mendon ti të jetë kjo?
Gertruda – Mund të jetë, ngjet shumë.
Polloni– Ka ngjarë ndonjëherë, - jo, unë dua ta di, -
që unë të kem thënë: "Kjo është kështu",
dhe të ketë dalë ndryshe?
Klaudi – Jo, me sa di unë.
Polloni– *(Dëften e tij dhe supet*)
Merre këtë nga këtu, po të dalë ndryshe.
pot ë më prijnë faktet përkatëse, unë mund
ta gjej ku është e vërteta fshehur, sikur të jetë
fshehur dhe në mes të qendrës së dheut.
Klaudi – Si mund ta provojmë më mirë?
Polloni– Ju e dini, që ngandonjëherë shëtit
katër orë bashkë këtu në sallë.
Gertruda – Ashtu bën vërtet.
Polloni– Në një kohë të tillë do t'i lëshoj time bijë;
Ju edhe unë fshehur prapa ndonjë perdeje ahere,
vëzhgojmë takimin e tyre; dhe në se ay s'e do atë,

dhe s'e ka humbur arësyen e tij nga ky shkak,
të mos jem më kështilltar shteti,
po të bëhem bujk dhe të ngas qetë dhe qerren.
Klaudi – Do ta provojmë.
Gertruda – Po shikoni, ja ku po vjen i shkreti,
duke lexuar.
Polloni– Shikoni, ju lutem, që të dy shkoni;
do t'i afrohem menjëherë. – O, lejomëni!
(Klaudi , Gertruda dhe shoqëronjësit dalin)
Hyn Hamleti duke lexuar.
Ç'bën i miri im, imzot – Hamlet?
Hamleti– Mirë, lavdi zotit!
Polloni– Më njeh mua, imzot?
Hamleti– Fare mirë, ti je peshkatar.
Polloni– Jo unë, Imzot.
Hamleti– Ahere do të doja të ishte njeri po aq i
ndershëm.
Polloni– I ndershëm, imzot?
Hamleti– Po, zotëri, të jesh i ndershëm si po vete kjo
botë, është të jesh një njeri i zgjedhur
midis dhjetë mijësh.
Polloni– Kjo është shumë e vërtetë, Imzot.
Hamleti– Nëqoftëse dielli bijen krimba
në një qën të ngordhur,
meqë është perëndi që puth kërmat, - Ke një bijë?
Polloni– Kam, Imzot.
Hamleti– Mos e lerë të ecij në diellë, të ngjiturit
barrë është bekim, po jo siç mund të mbetet
me barrë jo bijë. Mik ki mëndjen!
Polloni– Ç'do të thuash me këtë? *(Mënjanë)*
Akoma po i bie harpës për time bijë:
sidoqë s'më njohu në fillim;
tha se jam peshkatar;
ka shkuar shumë, ka shkuar shumë;

dhe me të vërtetë në rini dhe unë vojta
shumë keq nga dashuria; pothuajse kaq sa ky
Do t'i flas përsëri. Ç'lexon, imzot?
Hamleti– Fjalë, fjalë, fjalë.
Polloni– Ç'është çështja, imzot?
Hamleti– Midis kujt?
Polloni– Dua të them çështja që lexon, imzot?
Hamleti– Shpifje, zotërie, se ky kopili satirik
thotë këtu, që pleqtë kanë mjekra të thinjura,
që fytyrat e tyre janë me rrudha,
syt e tyre rrjedhin qelibar të trashë
dhe rreshirë prej kumbulle;
dhe që u mungon krejt arësye,
kanë gjithashtu dhe kofshë të dobëta; tërë këto,
zotëri, ndonëse i besoj me shumë fortësi dhe
fuqi prapëseprapë s'e gjej të drejtë që t'i ketë
shkruar kështu; se ti vetë, zotëri, do të rritesh
plak si jam unë, po të mundje të ecje praptazi
si gaforre. *(Lexon përsëri)*
Polloni– *(Mënjanë)* Ndonëse kjo është marrëzi.
prapëseprapë ka metodë në të. –
Nuk do të hiqesh nga era, imzot?
Hamleti– Dhe të vete në varrin tim.
Polloni– Me të vërtetë, atje s'ka erë. *(Mënjanë)*
Sa kuptimplote janë nganjëherë përgjigjet e tij!
Është fatkeqësi që shpesh marrosja godit mbi gjëra,
që mëndja e shëndoshë dhe arësya s'mundin t'i
lindin me aqë buri. Do ta le dhe begas të gjej
mënyrë për pjekjen në mes të tij dhe bijës sime. –
I ndershëm, imzot, me shumë përulësi dua
Të marr lejen time prej teje.
Hamleti– Ti s'mund, zotëri, të marsh prej meje
diçka, që unë me kënaqësi dua të ndahem prej saj,
përveç jetës sime, përveç jetës sime…

Polloni– Rri me shëndet, Imzot.*(Përul kryet dhe del)*
Hamleti– Këta të bezdisur budallenj pleq!
(Kthehet prapë te libra)
Hyjnë Rozenkranci dhe Guidelsterni
Polloni– Kërkoni imzot Hamletin? Ja ku është.
Rozenkranci – *(I thotë Pollonit)* Perëndia qoftë me ty, Imzot.(*Polloni del)*
Guidelsterni – I ndershmi im, imzot!
Rozenkranci – Shumë i shtrënjti im, imzot!
Hamleti– Të shkëlqyer miqt e mi të mirë!
Si je Guidelstern?
Ah, Rosenkranc? Djem të mirë, si jini që të dy?
Rosenkranci – Si të gjithë djemt e rëndomtë të dheut.
Guidelsterni – Të lumtur në të që s'jemi shumë të lumtur.
Mbi kësulën e fatit ne s'jemi e njëjta xhufkë.
Hamleti– As shollat e këpucëve të saj?
Rosenkranci – Asnjëra, Imzot.
Hamleti– Ahere ju rroni rreth mesit,
ose në mes të favorëve të saj?
Guidelsterni – Oër besë, ne jemi intimët e saj.
Hamleti– Në pjesët e fshehta të fatit? O, me të vërtetë;
Ay është kurvë. Po ç'janë të rejat?
Rosenkranci – Asgjë tjetër, imzot veç asaj që bota po bëhet e ndershme.
Hamleti– Ahere iu afrua fundi botës;
po të rejat tuaja s'janë të vërteta.
Po lermëni t'ju pyes posaçërisht:
Ç'i kini bërë fatit, miqt e mi të mirë,
që u dërgon këtu në burg?
Guidelsterni – Burg, imzot!
Hamleti– Danimarka është burg.

Rosenkranci – Ahere është tërë bota.
Hamleti– Dhe shumë i gjerë, ku ka shumë kufizime, të ndara dhe bodrume;
dhe Danimarka është një nga më të liqtë.
Rosenkranci – Ne s'mendojmë kështu, Imzot.
Hamleti– Po, ahere për ju s'është; s'është asgjë, as e mirë, as e ligë, po të menduarit e bën ashtu; për mua është burg.
Rosenkranci – Ahere ambicja jote e bën atë të tillë; është shumë e ngushtë për mëndjen tënde.
Hamleti– O perëndi! Unë mund të mbyllesha në një guaskë arre dhe ta quaja veten time mbret të hapësirës pafund, pot ë mos ishte ajo që shoh ëndra të liga.
Guidelsterni – Ëndrra, të cilat në fakt janë ambicje; veçse hija e ëndrës.
Hamleti– Ëndra vetë patjetër është hije.
Rosenkranci – Me të vërtetë dhe unë e konsideroj ambicjen cilësi prej një ere aqë të lehtë, që s'është tjetër veçse hija e hijes.
Hamleti– Ahere lipsarët tanë janë trupat dhe mbretërit tanë dhe heronjtë janë hijet e zmadhuara të lipsarëve. S'vemë në pallat?
Se për zotin, s'mund të arësyetoj.
Rosenkranci dhe Guidelsterni – Ne presim urdhërin tuaj.
Hamleti– Jo një gjë të tillë;
nuk do t'ju krahasoj ju me shërbëtorët tim;
se t'ju them si njeri i ndershëm
shoqëronjësit e mi janë shumë të urrejtur.
Po në rrugën e rrahut miqësisë, ç'u solli në Elsinor?
Rosenkranci – Të të vizitojmë ty, imzot, asgjë tjetër.
Hamleti– Sa lipsat që jam, unë jam i varfër akoma dhe në falënderime; po ju falënderoj;

dhe me siguri, të dashur miq, falënderimet e mija
janë shumë të shtrënjta dhe për një gjysmë leku.
Po s'ju dërguan të vini? Është kjo dëshira juaj?
Është kjo vizitë e lirë? Ejani, veproni
drejtësisht me mua, ejani; thomëni.
Guidelsterni – Ç'të themi, imzot?
Hamleti– Por, çdo gjë, po më mirë mbi subjektin që kemi. Ju dërguan që të vini!
Dhe ka një lloj rrëfimi në dukjen tuaj, që modestitë tuaja s'kanë mjeshtëri mjaft ta ngjyrosin.
Unë e di që mbreti i mirë dhe mbretëresha ju kanë thirrur.
Rosenkranci – Për ç'arësye, imzot?
Hamleti– Atë ju duhet të ma thoni.
Po lermëni t'ju përbetoj, në të drejtat e shoqërisë sonë, në harmoninë e rinisë sonë, në detyrimin e dashurisë sonë të përhershme që ruajmë dhe për çdo tjetër gjë të shtrënjtë, që një propozonjës i mirë mund t'ju ngarkonte veç këtyre, të më thoni të drejtën dhe drejtpërdrejt, në se ju thirrën apo jo?
Rosenkranci – *(I thotë mënjanë Guidelsternit*) Ç'thua ti?
Hamleti– *(Mënjanë)* Jo, ahere kam një ay mbi ju, - po në më doni mos e mbani të fshehtë.
Guidelsterni – Imzot, na dërguan.
Hamleti–
Do t'ju them unë pse: dhe kështu parashikimi im
do ta ndalojë zbulimin tuaj, dhe fshehtësia juaj
të mbreti dhe mbretëresha nuk do ndrrojë as një
qime. Tani vonë ka humbur, por nga ç'arësye s'e di,
tërë qejfet e mia, i kam lënë tërë zakonet e
stërvitjeve;
dhe, me të vërtetë, ma kanë rënduar aqë shumë
tabijetin tim, saqë kjo formë e bukur,

dheu, më duken si një kep i shterptë;
kjo mbulesa ime e shkëlqyer, era, vështroni,
kjo pamja e bukur kubeja që varet përmbi ne,
kjo çatia madhështore e zbukuruar me zjarr të artë,
po, mua këto s'më duken asgjë tjetër veçse një
grumbullim prej avujsh të ndotur dhe të molepsur…
Ç'vepër artistike është njeriu! Sa bujar në arësye!
Sa i pakufizuar në aftësi! Në formë dhe lëvizje,
Sa ekzakt dhe i admiruar! Në veprim porsi një
ëngjëll. Në kuptim, si një perëndi! Bukuria e botës!
Modeli i shtazëve! Dhe megjithkëtë për mua ç'është
kjo pesëlënda prej pluhuri? Burri mua s'më
gëzon; jo, as gruaja, ndonëse prej buzëqeshjeve
tuaja, ju ashtu dukeni se thoni.
Rosenkranci – Imzot, s'kisha një gjë të tillë në
mëndjen time.
Hamleti– Ahere pse qeshe, kur thashë që burri
s'më gëzon.
Rosenkranci – Se mendova, imzot, nëqoftëse burri
s'të gëzon, ç'pritje kreshnore do të marrin nga ty
aktorët; i takuam udhës; dhe vinë këtu të të ofrojnë
shërbimet e tyre.
Hamleti - Ay që luan mbretin mirësetëvijë;
madhëria e tij do të marrë shpërblim nga unë;
kreshniku aventurier do të përdorjë shpatën dhe
shqytin;
dashnori nuk do të psherëtijë gratis;
idhnaku do ta mbarojë pjesën e tij në paqe;
komiku do të bëjë të qeshin ata që mushkëritë
u dugulizen nga provokimet më të lehta;
dhe zonja do ta çfaqjë mendimin e saj lirisht,
ose vjersh' e lirë do ta pengojë. Ç'aktorë janë?
Rosenkranci – Po ata që të pëlqenin aqë shumë,
tragjedianët e qytetit.

Hamleti– Ç'u ngjau që udhëtojnë? Në qytet ishin
më mirë nga të dyja, nga fama dhe nga fitimi.
Rosenkranci – Mendoj se ndalja e tyre u vjen nga
inovacionet që janë bërë në kohët e fundit.
Hamleti– Kanë ata të njëjtën çmim që kishin, kur
unë isha në qytet? I frekuentojnë ashtu si ahere?
Rosenkranci – Jo, përnjëmend, ata s'janë.
Hamleti– Pse kështu? Apo mos e ndryshknë?
Rosenkranci – Jo, përpjekja e tyre vazhdon në
përçapjen e zakonshme; po ajo është, zotëri,
një fole prej çiliminjsh petritë të vegjël,
që thërreshin me notën më të lartë të zërit të tyre,
ku është fare e papërshtatshme,
dhe marrin duartrokitje të dhunshme për të;
këta janë tani moda, dhe aqë i rrapëllojnë teatrot
publike, se ashtu i quajnë, që dramatistët e vërtetë,
zgjuarsia e të cilëve ashtë aqë e fortë dhe mbreptë
sa një shpatë, kanë frikë të ndeshen me këta
çiliminj, të cilët lëftojnë, me një farë mënyre, me
pëndët e patës.
Hamleti– Çfarë janë ata çiliminj? Kush i mban ata?
Si paguhen? Nuk do ta ndjekin mjeshtërinë e tyre
ata më tej se sat ë mundin të këndojnë?
Nuk do të thonë ata pastaj, po të bëhen aktorë
të rëndomtë, - dhe siç duket do të ngjasë, po të mos
përmirësojnë mjetet e tyre, - që shkrimtarët e tyre
bëjnë padrejtësi, që i bëjnë të bërtasin
kundër trashëgimit të tyre?
Rosenkranci – Për besë, atje është bërë çështje e
madhe nga të dy anët,
dhe populli s'e ndjen për mëkatë që t'i ndërsejnë
të zihen, atje për disa kohë drejtorët e skenave
s'ofronin çmim për një vepër, që s'pajtohej
me shijën e popullit, të cilat interesohen

të shohin vetëm ato drama, në të cilat dialogu
është trajtuar mirë me daçka.
Hamleti– A është e mundur një gjë e tillë?
Guidelsterni – O, atje janë bërë shumë diskutime
të mprehta dhe të mira.
Hamleti– Dhe djemtë duallën fitonjës?[9]
Rosenkranci – Po, imzot, ata atë e bënë, muarrën
Herkulin
edhe barrën e tij.[10]
Hamleti– Kjo s'është fare çudi; se im ungj është
mbret i Danimarkës dhe ata që I shtrëmbëronin
buzët atij ndërsa rronte im atë japin njëzet,
dyzet, pesëdhjet, njëqint dukatë për një copë
fotografi të tij në miniaturë. Për zotin,
është diçka e mbinatyrshme në këtë,
filozofia po të mundje ta diktojë.
(Dëgjohen buçitje trumbetash që brënda në kështjellë)
Guidelsterni – Ja tek erdhën aktorët.
Hamleti– Zotërinj, mirsenaerdhët në Elsinor.
(U ul kryet)
Ejani, epëmni duart, shoqërimi i përshtatshëm i
pritjes është modë dhe ceremoni, pranoni të vëzhgoj
formalitetet e oborrsisë me ju, dhe t'ju përshëndes
me të gjitha format e sjelljes… *(U jep dorën)*
se përndryshe shtrija e sjelljes sime te aktorët,
e cila, ja ku po ju them, duhet të duket bujare
nga jashtë, do të duket sikur i prita ata më mirë
se juve… mirsenaerdhët: po im ungj babai dhe
hallua nënë u gënjyhen.
Guidelsterni – Në se i shtrënjtë, imzot?
Hamleti– Unë jam i marrë vetëm në veri-perëndim;
por kur fryn juga, dalloj petritin nga gata.
Hyn Polloni
Polloni– Tungjatjeta, zotërinj.

Hamleti– Dëgjo, Guidelstern,
- edhe ti, - në çdo vesh
dhe një dëgjonjës; atë foshnjën e madhe,
që shikon atje, s'ka dalë akoma nga pelengat.
Rosenkranci – Rastësisht ay ka ardhur dy herë në to; se siç thonë, një plak është dy herë foshnjë.
Hamleti– Do profetizoj, ay vjen të më thotë për aktorët; vini re. – (*Ngre zërin)* Drejt thua, zotëri; të hënën në mëngjes, ahere ishte me të vërtetë.
Polloni– Imzot, kam të reja për të të thënë.
Hamleti– Imzot, kam të reja për të të thënë. Kur Roski ishte aktor në Romë, -
Polloni– Aktorët erdhën këtu, Imzot.
Hamleti– Hajde, de!
Polloni– Për nder.
Hamleti– Ahere erdhi çdo actor mbi gomarin e tij. –
Polloni– Aktorët më të mirë në botë, ose për tragjedi, komedi, histori, idile, idilike – komike, historike – idilike, tragjike, historike, tragjike – komike – historike, idilike, skenë e pandarë ose poezi e pakufizuar;
Seneka s'mund të jetë shumë i rëndë, ose Plauti shumë i lehtë, për zgjuarsi dhe dritë, për liri: - Këta janë të vetmit.
Hamleti– O Jeftha, gjykatës i Izraelit, ç'thesar që kishe ti!
Polloni– Ç'thesar kish ay, imzot?
Hamleti– Po,
Një bijë – një kryevepër,
të cilën e donte tepër.
Polloni– *(Mënjanë)* Akoma me bijën time.
Hamleti– S'kam të drejtë, plak Jeftha?
Polloni– Në më çuan mua Jeftha, imzot, unë
Kam një bijë që e dua tepër.

Hamleti– Jo, vazhdon kështu.
Polloni– Si vazhdon, imzot?
Hamleti- Po,
Perëndia vonon,
po kurrë s'harron.
dhe pastaj ti e di,
dhe ahere u bë siç ishte thënë për të, -
rradha e parë e këngës së shkrimeve të shënjta
do të dëftejë më shumë;
po vështro, ja ku po vjen ndërprerja ime.
(Hyjnë katër a pesë aktorë)
Mirsenaerdhët, mjeshtër, mirsenaerdhtë të gjithë.
Gëzohem që ju shikoj mirë. Mirsenaerdhtë miq.
– O, miku im i vjetër!
Fytyra jote ka nxjerrë thekë, që kur të pashë
herën e fundit, mos erdhe në Danimarkë
të më hakërrosh me mjekrën?
O, zonjushja ime e re dhe zonjë! Për virgjëreshën,
zonjëria jote është më afër qiellit se qëkur të pashë
herën e fundit një takë m'e lartë. I lutem zotit,
zëri yt, të mos jetë si flori kallp, I plasur përbrenda[11]
rrethit… mjeshtër, të gjithë mirseerdhtë.
Edhe ne do të bëjmë po ashtu si skifterët francezë,
do të fluturojmë pas çdo gjëje që do të shohmë;
do të kemi një recitim menjëherë; ejani
na jepni një shëmbëll të mjeshtërisë suaj;
ejani, thonani një recitim me pasione.
Aktori i Parë – Çfarë recitimi, imzot?
Hamleti–
Të dëgjova të më recitosh një vepër një herë,
po kurrë s'u paraqit; ose dhe në u lojt, jo më shumë
se një radhë, se vepra, më kujtohet, s'i kënaqi
turmat; ishte havjar për vegjëlinë; por siç e kuptova
unë dhe të tjerë, mendimi i të cilëve,

në çështje të tilla u kishte më shumë autoritet
se imi, - ishte një vepër e shkëlqyer,
e renditur mirë në skenat, e shkruar me aqë shumë
modesti sa dije. Mbaj mënd, një, tha se vargjeve
s'u kishibn hedhur kripë,
që ta bënin lëndën të shijshme,
po as lëndë në shprehjet që mund ta ngarkojë
autorin me pretekste; pot ha që ishte një vepër
realiste, aqë e shëndoshë, sa e kënaqëshme, dhe
me më shumë bukuri natyrale, se sa me art:
sidomos një pjesë të saj e dashurova shumë;
ishte historia e Eneut që i tregon Didonës;
dhe diku atje rrotull ku posaçërisht
flet për vrasjen e Priamit.
Nëqoftëse rren edhe në kujtesën tënde, fillo
në këtë radhë. Dale, dale, si ishte?
Pirrua i rreptë si bisha e Hykarnisë,
jo s'ishte kështu; po prapseprap fillon me Pirron:
Pirrua i rreptë, armatimi i të cilit,
i zi si qëllimi i tij, natës i ngjiste,
kur ay rrinte i tulatur mbi kalin ogurzi;
e ka tani lyer fytyrën e zezë dhe të tmerrshme
me stemat më të llahtarisura. Nga koka e në këmbët
është i tëri i kuq. Tmerrësisht i vijosur
me gjakun e etërve, nënave, bijve dhe bijave,
djegur dhe përcëlluar nga rrugët e flakëta,
që huajnë një dritë tradhtare dhe të mallkuar
në vrasjet e njerëzve të tyre;
i ndezur me tërmeqje dhe zjarr,
dhe ashtu i përlyer me gjak të piksur,
me sytë si thëngjij të ndezur, Pirrua si ferri
gjyshin plak Priamin kërkonte.
Kështu vazhdo!
Polloni– Për perëndi, imzot, e the mirë, me theks

të mirë dhe me shkoqitje të mirë.
Aktori i Parë – E gjeti menjëherë –
tek po lëftonte kot me grekët; shpata e tij e vjetër,
rrebele në krahun e tij rri atje ku bie,
kundërshton të bindet, me forcë të pabarabartë
Pirrua iu sul Priamit; në tërmeqen e tij goditi hapët,
po prej vërshëllimit dhe erës së shpatës që ra,
babai i pafuqishëm shëmbet.
Ahere Ilioni pa ndjenja u duk se ndjeu këtë goditje,
me kulmin të ndezur flakë u kërrus në themelet e tij;
dhe me një krismë të shëmtuar robëron veshin e
Pirros; po, shiko! Shpata e tij,
e cila po binte mbi kokën e bardhë qumësht
të të ndershmit Priam, u duk sikur në erë kolisi,
pra si një Tiran i pikturuar, Pirrua qëndroi;
dhe si i paanshëm në vullnetin e tij dhe çështjen,
s'bëri asgjë.
Po sikundër ne shpesh shohim, më parë
se të vijë shtërgata,
heshtje në qiej, të palëvizura retë,
erërat guximtare të nemitura, dhe dheun në të
të qetë si vdekja, befas bubullima e tmerrshme
çan hapësirën; pra pas pushimit të Pirros
një hakmarrje zgjohet dhe e vë përsëri të punojë;
dhe kurrë çekanët e qiklopit s'ranë
mbi armët e Marsit, që i farkëtonte për një
kohë të pasosur,
me më pak tërbim, se sa shpata gjakderdhëse e
Pirros ra tani mbi Priamin.
Çporru, çporru, çporru, fat kodosh!
Të gjitha ju perënditë,
në kuvënd mbledhur, merrjani atij fuqinë,
thyejani të gjitha peronat dhe rrathët nga rrota e tij,
dhe rrëkëllejeni kopilin rrumbullka

tatëpjetë bregut qiellor,
aqë poshtë sa të vejë në djajtë.
Polloni– Është shumë e gjatë.
Hamleti – Do të vejë te berberi me mjekrën tënde. – Të lutem vazhdo; ay do ndonjë kërcim, ose ndonjë tregim të ndyrë, ose e zë gjumi, - thuaj, vazhdo, eja te Hekuba.
Aktori i Parë – Po kush, o kush e pa mbretëreshën vel mbuluar…
Hamleti– Vel mbuluar?
Polloni– Kjo është mirë, mbretëreshë vel mbuluar, është mirë.
Aktori i Parë – Të rendjë posht e lartë,
flakëve t'u kanoset me rrufë verbuar;
një leckë mbi atë kokë,
ku gjer tani vonë kurora qëndronte; për rrobe,
rreth hijeve të saja të këputura nga lindjet e shumta,
një babanie, në kushtrimin e frikës, kapi;
këtë kush e pa, me gjuhën vrer njomur,
kundër pushtetit të fatit tradhëti do shqiptonte,
po në se vetë perënditë e panë atë ahere,
kur ajo pa Pirron të bëjë lodrën shpirtkeqe,
të grijë me shpatën e tij trupin e të shoqit,
në hopkin e klithjes dhe të kujës që dha,
veç në mos gjërat vdekëse
s'i mallëngjejnë perënditë fare
do t'i bënte të qanin syt e zjarrtë të qiellit
dhe perëndive t'u dhimbset.
Polloni– Vështro si iu ndrrua boja, dhe sytë
iu mbushnë me lot. Të lutem, jo më tepër.
Hamleti– Është e mirë; kusurë ma thuaj më vonë. I mirë, imzot do të kesh kënaqësinë të kujdesesh për aktorët, t'u bëjnë pritje të mirë!
Më dëgjon, t'u sillen mirë, se ata janë përmbledhja

dhe kronikat e shkurta të kohës; pas vdekjes sate
do të jetë më mirë të kesh një mbishkrim të lik,
se sa raportin e tyre të keq gjatë kohës që rron.
Polloni– Imzot, do t'i pres, siç u meriton.
Hamleti– Për merin e perëndisë, zotëri, shumë më
mirë! Po të trajtosh çdo njeri pas meritës së tij,
cili do të shpëtojë nga druja?
Priti ata sipas nderit tënd dhe dinjitetit;
sa më pak e meritojnë ata, aqë më shumë meritë
ka bujaria jote. Merri brënda.
Polloni– Ejani, zotërinj. *(Vete te dera)*
Hamleti– Shkoni me të, miq, nesër do të na çfaqni
një lodër; *(Ndalon aktorin e parë)* më dëgjon, mik
i vjetër, mund ta luash t'i vrasjen e Gonzagos?
Aktori i Parë – Po, Imzot.
Hamleti– Do ta kemi nesër mbrëma.
Mund ti, po të jetë nevoja, të mësosh një fjalë,
ndonjë dyzinë ose gjashtëmbëdhjetë radhë,
të cilat do t'i shkruaj unë; a mund?
Aktori i Parë – Po, Imzot.
(Polloni dhe katorët dalin jashtë)
Hamleti– Shumë mirë. Shko pas atij imzotit dhe
shiko mos e tallni. (*Del aktori i parë)*
(U thotë Rosenkrancit dhe Guidelsternit)
Miqt e mi të mirë, do t'ju le gjer në mbrëmje.
Mirsenaerdhtë në Elsinor.
Rosenkranci – I mirë, Imzot.
Hamleti– Po, po ditën e mirë. *(Rosenkranci dhe
Guidelsterni dalin)* Tani jam vetëm.
O ç'kopil dhe rob i poshtër që jam unë!
S'është përbindëse që ky aktori këtu,
vetëm në një trillim, në një ëndër pasioni,
mundi të shtrëngonjë shpirtin
aqë në përfytyrimin e tij,

që prej veprimtarisë së vet, iu verdh gjithë fytyra;
sytë iu mbushnë me lot, iu ngatërrua pamja,
iu thye zëri dhe tërë shqisat e tij iu pajtuan
me format e imagjinatës së tij;
dhe të gjitha për hiçgjë!
Për Hekubën? Ç'e ka Hekuba atë, ose ay Hekubën,
që ay të qajë për të? Çdo të bënte ay, po të kishte
shtysën dhe rolin për pasion që kam unë?
Ay do të mbytte skenën me lot, dhe do të çante
veshët e popullit me fjalë të tmerrshme,
do t'i marroste fajtorët dhe llahtariste të pafajshmit;
do shastiste të padituri t dhe do ngatërronte
pashpresë,
përnjëmënd shqisat e syve dhe të veshëve;
prapseprap unë,
një i mefshtë, karakter – baltë, kopil, i pavendosur
si një njeri nëpër ëndra, sprekem prej shkakut tim,
dhe s'them dot asgjë. Bile dhe për një mbret.
mbi pronat e cilit dhe jetën e shtrënjtë të tij,
i bënë prishje të mallkuar: Jam unë frikaman?
Cili më quan të poshtër? Më çan kokën në mes?
Më nduk mjekrën dhe ma hedh turinjve?
Më heq për hunde? Më fut gënjeshtrën në gurmas,
thellë gjer në mushkëritë? Cili m'i bën këto? Eh!
Për zotin duhet t'i duroj; se kjo s'mund të bëhet;
Po, unë kam shpretkë prej pllumbi,
dhe më mungon t'ëmblit
që të më bëjë të ndjej hidhrimin e keqbërjes;
ose që më parë do t'i kasha majtur korbrit
e tërë tokës me kërmën e këtij robit; gjakatar,
keqbërës, kodosh! I pamëshirshëm, tradhtar,
sensual, katil i panatyrshëm! O, hakmarrje!
Po ç'gomar jam unë!
Kjo, para është trimëri e madhe,

Që unë, biri i një babai të shtrenjtë të vrarë,
shtytyr për hakmarrjen time prej qiellit dhe ferrit,
duhet si një lavire të çngarkoj zëmrën me fjalë
dhe të çpërthehem në mallkime, si një kurvë,
një kopil!
Turp për mua! Puh! Tru, në punën tuaj! Hm, kam
dëgjuar, që njerës të fajshmë, ndënjur në një çfaqje,
prej të njëjtës mjeshtërie të skenës,
u goditnë që në shpirtin e tyre, sa menjëherë
çpallën keqbërjet e tyre;
se vrasja, ndose s'ka gjuhë, do të flaës
me organ më të mrekullueshëm. Do të vë aktorët
të lozin diçka si vrasjen e tim' eti,
përpara tim' ungji; do të vëzhgoj pamjen e tij;
do ta çpoj ku i dhëmb; në sy ay kapsallitet,
e di se ç'duhet të bëj. Fryma që kam parë
mund të jetë djalli; dhe djalli ka fuqi
të marrë çdo trajtë të pëlqyerl po, dhe mbase,
me që jam i dobët dhe melankolik,
dhe ay është shumë i aftë me shpirtra të tillë,
do të më mashtrojë. Dua të kem prova
më të sakta se këto. Çfaqja është mjeti,
ku brënda do të kap ndërgjegjen e mbretit. *(Del)*

AKTI I TRETË

Skena e parë

Një dhomë në kështjellë

Hyjnë Klaudi , Gertruda, Polloni, Ofelia,
Rosenkranci, Guidelsterni dhe imzotër të tjerë.

Klaudi
– Dhe s'mundtë të zbulonit me ndonjë farë mënyre,
ç'është shkaku i këtij çqetësimi shpirtëror,
që çokëllon aqë ashpër ditët e tij të qeta
në çmënduri të turbullt dhe të rrezikshme?
Rosenkranci
– Ay rrëfen, që e ndjen veten e tij të çakërdisur,
po se nga se as me ndonjë mënyrë s'do ta thotë.
Guidelsterni – As e gjetëm për mbarë ta hetojmë;
po me një marrëzi dinake e mban veten mënjanë,
sa herë e suallëm në fjalë të na tregojë
gjëndjen e tij të vërtetë.
Gertruda – A ju priti mirë?
Rosenkranci – Shumë, si fisnik.
Guidelsterni
– Po dukej që më pahir, gjithë gjatë kohës.
Rosenkranci – I kursyer në përgjigjet tona,
por në pyetje ishte shumë i lirë.
Gertruda – S'e provuat me ndonjë dëfrim?
Rosenkranci
– Zonjë, ashtu rastisi, që udhës ne arritëm
disa aktorë dhe i lamë prapa; për ata i thamë,
dhe u duk në veten e tij një lloj gëzimi
kur dëgjoi për ta; ata janë aty rrotull në kështjellë;
dhe më ngjan se posa muarrën urdhër

të lozin përpara tij sonte.
Polloni– Po, është e vërtetë;
dhe më tha t'ju lutem me ngulm madhërive tuaj
ta dëgjoni dhe ta shikoni çfaqjen.
Klaudi – Megjithë zëmër, dhe kënaqem shumë
të dëgjoj që ka prirje të tilla.
Të mirë zotërinj, ngacmojani dëshirat e tij akoma
dhe nxitjani qëllimin e tij me të këtilla dëfrime.
Rosenkranci – Po, Imzot.
(Rosenkranci dhe Guidelsterni dalin)
Klaudi – Gertrudë e ëmbël, lerna edhe ti;
se pakë më parë dërguam Hamleti të vijë
këtu rastësisht Ofelinë të takojë.
I jati i saj dhe unë, - si spiunë të ligjshëm,
do të fshihemi e të përgjojmë pa parë,
se mnd që nga takimi i tyre të gjykojmë qartë,
se si do të sillet, dhe të zbulojmë,
nëse është hidhërimi i dashurisë së tij
ose jo, që kështu ay po vuan.
Gertruda – Si urdhron.
Sa për ty, Ofeli dëshëroj,
që bukuria jote të jetë shkaku i lumtur
i tërbimit të Hamletit; kështu do shpresoj,
që virtutat tënde
do ta sjellin në rrugën e zakonshme përsëri,
dhe do të nderoheni që të dy.
Ofelia – Zonjë, dëshiroj të mundjë, edhe unë.
*(**Gertruda** del)*
Polloni– Ofeli, shëtit këtu. Imzot, ju lutem
të zëmë vënd. Dhe *(Ofelisë)* lexo këtë libër;
që dukja e një stërvitjeje të tillë të mashtrojë
vetminë tënde. Ne jemi shpesh të fjashmë në këtë,

dhe është provuar më së miri, që me fytyrë adhurimi
dhe me sjellje kushtuar besimit, ne maskojmë dhe
djalin vetë.
Klaudi – Mënjanë, Oh, kjo është vërtetë!
Si kamçik ma thumbin kjo fjalë ndërgjegjen time!
Faqja e prostitutes, zbukuruar me mjeshtërinë e
lyerjes, s'është më e shëmtuar nën lëndën që e
ndihmon atë, se sa është vepra ime në fjalën time më
të pisipillosur:
O barrë e rëndë!
Polloni– Dëgjoj çapet e tij. Le të tërhiqemi,
Imzot.*(Klaudi dhe Polloni dalin).*
Hamleti– Të jesh, a të mos jesh, kjo është çështja;
apo është më bujari për mëndjen të durojë
hobetë dhe shigjetat e fatit të padrejtë,
ose të rrokjë armët kundër një deti me brenga,
dhe në përpjekje, t'u japë fund. Të vdeshç, të flesh.
Jo më tepër; dhe në gjumin, të themi, u japim fund
dhëmbjeve të zëmrës dhe mijë tronditjeve natyrale
që mishi është trashëgimtar; ky është një mbarim,
që me zjarr duhet dëshëruar. Të vdeshç; - të flesh; -
të flesh! Ndofta të ëndërrosh!
Po, këtu është pengesa; se në atë gjumin e vdekjes
ç'ëndra vallë do të shohmë,
kur ta hedhim këtë lëmshin e vdekshëm,
kjo na bën të arsyetojmë; ky është shkaku
që e bën fatkeqësinë të rrojë aqë gjatë;
se cili do ti duronte kamçikët dhe përbuzjet e kohës,
padrejtësinë e shtypësit, fyerjet e kryelartit,
dhëmbjet e dashurisë së përbuzur, vonimin e ligjit,
arrogancën e zyrtarit, dhe neveritjen
që merita e duruar merr nga të padenjët,
kur ay vetë mund ta shpëtojë veten
me një copë kamë?

Kush na bën ta mbajmë barrën,të rënkojmë dhe të
dërsijmë nën një jetë të rraskapitur,
përveç se ay tmerri i diçkaje pas vdekjes,
vëndi i pazbuluar, nga kufit' e të cilit asnjë
udhëtar nuk kthehet, na ngatërron vullnetin,
dhe na bën të durojmë të këqiat që kemi,
se sat ë fluturojmë në të tjera që s'i dimë;
kështu ndërgjegja na bën të gjithëve frikamanë;
dhe kështu të kuqtë e fytyrës, nga vendimi,
sëmuret dhe verdhet prej mendimit.
Dhe ndërmarrjet më të guximshme e më të mëdha,
kështu duke arsyetuar, kthehen nga udha e tyre
dhe e humbin emrin e veprimit. Po hesht tani!
Ofeli e bukur! Nimfë, në lutjet e tua,
kujto dhe të gjitha mëkatet e mia.
Ofelia – I miri im, imzot, si kini qënë tërë këto ditë?
Hamleti
– Të falënderoj me përulësi, mirë, mirë, mirë.
Ofelia – Imzot, kam ca kujtimet e tua,
që kam dashur me kohë të t'i kthej;
të lutem tani merri.
Hamleti
– Jo, jo, unë; unë kurrë s'të kam dhënë gjësendi.
Ofelia
I ndershmi im, imzot, ti e di shumë mirë që m'i dhe;
dhe me ato bashkë fjalë
me aromë aq të ëmbël shoqëruar,
që i bënin gjërat më të pasura;
aroma – shkuar, merri prapë;
se dhurat' e pasur, varfërohet në mëndjen e dlirë,
kur provohet që dhënësi nuk është zëmërmirë.
Merri, Imzot. *(Nxjerr xhevaire nga kraharori i saj dhe i
vë mbi një tryezë pranë tij)*
Hamleti– Ha, ha! Je e ndershme?

Ofelia – Imzot?
Hamleti– Je e bukur?
Ofelia – Çdo të thotë, imzoti im me këtë?
Hamleti - Që, në je e ndershme dhe e bukur,
të mos e pranosh
nderi yt të ketë lidhje me bukurinë tënde.
Ofelia – A mund bukuria, imzot, të ketë lidhje
më të mirë, se sa me nderin?
Hamleti– Po, me të vërtet, se fuqia e bukurisë do ta
kthejë më shpejt nderin nga ç'është në një kodosh,
se sa fuqia e nderit mund të ndrrojë bukurinë
në shëmbëllimin e tij; kjo ishte më parë paradoks,
po tani koha e vërtetoi. Të dashuroja një herë.
Ofelia – Me të vërtet, imzot, ashtu më bëre të besoj.
Hamleti– Nuk duhej të më kishe besuar, se virtuti
s'mund të na e shartojë aqë fisin tonë të vjetër;
p one do shijojmë të metat e tij; nuk të dashuroja.
Ofelia – Qënkam në manastir; pse të lindsh ti
fëmijë mëkatarë? Vetë unë jam disi
I virtutshëm; po prapëseprapë mund ta akuzoj
veten time me gjëra t'atilla, që do të ishte
më mirë nëna të mos më kishte lindur;
jam shumë krenar, hakmarrës, ambicioz;
dhe me aqë ide të këqia në kokë,
se s'i kap dot me mënd
dhe përfytyrimi t'u japë trajtë, ose
kohë t'i vë në veprim. Ç'duhen këtu
njerës të tillë si unë të hiqen zvarrë
midis qiellit dhe dheut? Ne jemi endacakë kopilë
që të gjithë; mos beso as ndonjë prej nesh. Shko,
tërhiqu në manastir. *(Befas)* Ku është yt atë?
Ofelia – Në shtëpi, Imzot.
Hamleti– Mbylleni brënda që të mos mundjë
të lozë rolin e budallait gjëkundi gjetkë,

veçse në shtëpinë e tij. *(Del jashë)*
Ofelia – *(Lutet)* O qiej të shenjtë, ndihmohini!
Hamleti– *(Kthehet i turbulluar)*
Në u martofsh, do të të jap këtë mallkim
si pajë: qofsh i dlirë si akulli,
dhe e pastër si dëbora, prapë nuk do shpëtosh
nga shpifja. Ecë në manastir, shko;
udhën e mabrë.
Ose në do medomosdo të martohesh,
martohu me ndonjë sylesh; se burrat e urtë
e dinë mjaft mirë se ç'përbindsha
i bëni ju ata. Në një manastir, shko;
dhe sa më shpejt. Lamtumirë. *(Vrapon për jashtë)*
Ofelia – O fuqi qiellore, silleni në vete!
Hamleti– *(Kthehet dhe një herë)*
Kam dëgjuar edhe për pispillosjet
tuaja aqë shumë, zoti ju ka dhënë një fytyrë
dhe ju i bëni vetes tuaj një tjetër;
kërceni, tundeni dhe belbësoni,
u ngjisni llagape tallëse krijesave të natyrës
dhe çthurjet tuaja i paraqitni si padijeninë tuaj.
Eja, nuk dotë vuaj më prej tyre; ato më marrosnë. Ja
ku të them nuk do të kemi
martesa të tjera; ata që janë martuar
deri tani, të gjithë, përveç një, do të rrojnë;
të tjerët do të mbeten siç janë. Në manastir, shko.
(Del)
Ofelia – O çfarë mëndje bujare këtu u çfronësua!
E oborrtarit, e ushtarit, syri i shkollarit, gjuha,
shpata;
shpresa dhe trëndafili i shtetit të bukur,
pasqyra e modës, modeli i sjelljes,
shëmbëlla e të gjithëve, krejt, krejt, përdhe!
Dhe unë prej grave më e dëshpëruara dhe e mjera,

që thëthita mjaltët e beve të tij muzikore,
shoh tani atë arësyen bujare dhe shumë sovrane,
sikambanë e çarë të zhangllojë, pa harmoni dhe
ashpër; atë pamjen e përsosur dhe bukurinë rinore
të lulëzuar ta fishkjë marrëzia. O, unë e mjera obobo,
që kam parë, ato që kam parë, dhe që shoh, këto që
shoh!

(Hyjnë përsëri Klaudi dhe Polloni)

Klaudi – Dashuri? Tronditjet e mëndjes së tij s'të
çojnë në atë rrugë,
as ç'tha ay, ndonse atyre u mungon pakë lidhja,
nuk ishin si prej të marri. Në shpirtin e tij ka diçka,
mbi të cilën melankolia e tij rri e klloqit,
dhe kam dyshim se çelja dhe zbulimi
do të jetë ndonjë rrezik, dhe që ta ndal,
vendosa për së shpejti
atë që duhet të bëj: ta dërgoj menjëherë në Angli,
të kërkojë haraçin tonë të prapambetur;
ndofta udhëtimi dhe vëndet e huaja,
me larminë e tyre t'ia dëbojnë
këtë diçka maraz në zëmrën e tij vendosur,
mbi të cilin trutë e tij rrajnë gjithnjë
dhe e bën atë të mos jetë në vete. Si thua ti?

Polloni– Do t'i bëje mirë; por megjithkëtë unë besoj
se burimi dhe nisja e merakut të tij
shpërtheu nga dashuria e papërfillur.
Si je tani, Ofeli?
S'kemi nevojë të na thuash, se ç'tha imzot Hamleti;
i dëgjuam të gjitha Imzot bëj siç të pëlqen;
po në e gjen të arësyeshme, pas çfaqjes,
lerë mbretëreshën, t'ëmën e tij të takohet me të
dhe t'i dëftejë hidhërimin e tij; le t'i flaës hapur
dhe po të kesh kënaqësinë,
do të vendosem gjëkundi

për të përgjuar bisedën e tyre.
Dhe po të mos gjej shkakun
dërgoje në Angli, ose e kufizo atje
ku urtësia juaj e gjykon për më mirë.
Klaudi – Ashtu le të bëjmë,
marrosja e një të madhi s'duhet
të lihet e lirë udhëvet. *(Dalin)*

Skena e dytë

Një sallë në kështjellë
Hy Hamleti dhe dy ose tre aktorë

Hamleti – T'i thoni fjalët, ju lutem siç jua shqiptova unë duke shkarë ato lehtë mbi gjuhën. Por, po t'i përtypni, siç bëjnë shumë prej aktorëve tanë, do të dëshëroja tellallin e qytetit t'i thoshte vargjet e mia. As erën të sharroni kështu me duart tuaja; po t'i bëni të gjitha me masë; bile dhe në rrëkenë vetë, në shtërgatën, dhe, si të them, në ngjirën e pasionit, ju duhet të krijoni një përkorje, që të mundjë të zbutjë ashpërsinë e saj. O, më vret shpirtin kur dëgjoj ndonjë zdap me perukë në kokë, të çjerrë pasionin lecka lecka, të çajë veshët e dëgjonjësve në sallën e teatros, shumica e të cilëve s'kanë aftësi të kuptojnë asgjë, veçse lodra-memecë të pashpjeguara dhe zhurmë.
Një aktor i tillë duke frushkulluar, që tepëron Fermagantin [12] dhe ia tejkalon Herodi, Herodit; ju lutem këto t'i evitoni.
Aktori i Parë – Ju siguroj, i nderuar Imzot.
Hamleti– Të mos jini as shumë të msheftë, po lini gjykimin tuaj, t'u bëhet kujdestari juaj; përshtatni veprimin në fjalë, dhe fjalën në veprim; me këtë rregull të posaçmë që të mos kapërceni masën e natyrës; ose çdo gjë që tepërohet është larg qëllimit të lodrës i cili që nga nisja dhe deri tani, ishte dhe është, sikur të themi, t'i mbajmë përpara pasqyrën natyrës; t'i dëftejë virtutit fytyrën e

tij, poshtërsisë pikturën e saj, dhe çdo epoke
zhvillimin dhe tiparet e saja.
Kjo po të tepërohet,
ose të mungojë, ndonëse do ta bëjë
syleshin të qeshjë, të kuptuarin
do ta shtyjë të hidhërohet, gjykimi i të cilit,
siç e pranuat dhe ju, duhet të ketë rëndësi
më shumë, se një teatër plot me njerës të tjerë.
O, ka aktorë,
që i kam parë të lozin, dhe kam dëgjuar
t'i lëvdojnë, dhe shumë, që të mos fyejnë zotin,
s'kishin as theksin e të krishterit,
as hapin e paganit,
as të ndonjë njeriu tjetër,
se aqë tundeshin dhe pëllisnin,
saqë mendova se ndonjë nga çirakët e natyrës do t'i
kishte krijuar këtë njerës, dhe s'kishte bërë mirë,
se aqë keq e imitonin njerëzinë.

Aktori i Parë

– Shpresoj se këto i kemi ndrequr deri diku, Imzot.

Hamleti

– O, ndreqini krejt. Dhe ata që lozin palaçot,
Mos i lerë të thonë me tepër se sa është shkruar
për ta; se shumë prej tyre, qeshin prej vetes së tyre,
që të bëjnë disa budallenj të qeshin dhe ata,
ndonse, atëhere, ndonjë pjesë të lodrës me rëndësi
duhej ta shikonin me vëmendje; kjo është poshtërsi;
dhe dëften një ambicje për të ardhur keq, për
budallanë që përdor këtë. Shkoni bëhuni gati.
*(Aktorët dalin) Hyjnë Polloni, Rosenkranci dhe Guidelsterni.*Ç'thua, imzot, a do të vijë mbreti ta
shikojë çfaqjen?

Polloni– Edhe mbretëresha dhe menjëherë.

Hamleti– Thuaju aktorëve të nxitojnë. *(Polloni përulet dhe del)* A doni edhe ju t'u ndihmoni aktorëve?
Rosenkranci dhe Guidelsterni – Po, Imzot.
(Rosenkranci dhe Guidelsterni dalin)
Hamleti– Ej! Horat!
Hyn Horati
Horati – Këtu jam, i mirë imzot, në urdhrat e tua.
Hamleti– Horat, ti je njeriu më i drejtë nga të gjithë sa kam takuar dhe biseduar unë.
Horati – O, i shtrenjti im Imzot.
Hamleti– Jo, mos pandeh se të bëj lajka;
se ç'dobi mund të pres në prej teje,
ti të ardhura s'ke, përveç mëndjes tënde të mirë,
që të ushqen dhe të vesh;
pse t'i bësh lajka të vobegtit?
Jo, lere gjuhën e sheqerosur
të lëpijë madhështinë e fryrë,
dhe le të kërrusen gjunjët e zhdërvjelltë,
ku servili nxjerr fitim… më dëgjon?
Qëkur shpirti im i shtrenjtë
u bë zot i zgjdegjes së tij,
të ka vulosur ty për veten e tij; se ti ke qënë
si një, që i pëson të gjitha, dhe s'pëson hiçgjësendi;
që i ka marrë dackat dhe favoret e fatit
me falënderime të barabarta; të bekuar janë ata,
që kanë gjakun dhe gjykimin aqë mirë përzjerë,
dhe s'bëhen pizga për gishtrinjtë e fatit,
të lozin ç'havaz ay të dojë; epmë atë njeri,
që s'është rob i pasionit dhe ta vë thelbin
e zemrës sime, po, në zemrën e zëmrës sime,
sikundër të kam ty. Po diçka shumë folëm për këtë.
Sonte do paraqesim një çfaqje para mbretit,
një skenë e saj i ngjet ngjarjes,
të cilën të kam thënë; të vrasjes së tim' eti;

të lutem, kur ta shikosh atë pjesën të çfaqet,
vëzhgo edhe me vëmendjen e shpirtit tënd
tim ungj; fajësia e tij e fshehtë,
në mos e zbuloftë veten e saj,
nga ca fjalë që ata thonë,
është lugat i mallkuar ay që pamë,
dhe përfytyrimet time janë të pluhrosura
si farka e Vullkanit. Vështrohet me vërejtje;
se unë sytë e mij do t'i ngul në fytyrën e tij,
dhe pastaj bashkojmë të dy gjykimet tona
për të nxjerrë përfundime nga qëndrimi i tij.
Horati – Mirë, imzot;
dhe në vjedhtë gjëkafsh, gjatë kohës që luhet lodra,
dhe të më shpëtojë i papikasur, vjedhjen
do ta paguaj unë.
(Dëgjohen fanfare dhe daulle)
Hamleti– Po vinë në çfaqje, unë duhet të sillem
si i marrë. Ti zërë vënd gjëkundi.
(Tribuna është ndërtuar në një anë.
Hyjnë nën tingujt e një marshi danez Klaudi,
Gertruda, Ofelia, Rosenkranci, Guidelsterni,
imzotër dhe garda me pishtarë.
Dëgjohen fanfare. Klaudi dhe Gertruda rrinë në
vëndet e tyre, më të mëngjër Polloni dhe
Ofelia dhe imzotërit e tjerë nga ana tjetër.)
Klaudi – Si është kushëriri ynë, Halmet?
Hamleti– Shumë mirë, për besë, me ushqimet e
kameleonit, ha erë,[13] dëndem me premtime; as
kaponj s'mund të ushqesh kështu!
Klaudi – Kjo përgjigje s'është për mua, Hamlet;
këto fjalë s'janë timet.
Hamleti– As timet tani. *(I thotë Pollonit)* Imzot, t'i
thua se ke lojtur një herë në universitet.
Polloni

– Po, imzot, dhe më konsideronin aktor të mirë.
Hamleti– Dhe ç'rol lojte?
Polloni– Paraqitja Jul Qesarin; më vrisnin në Kapitol; më vrau Bruti.
Hamleti– Ajo ishte një pjesë e tij brutale, të vrasë kaqë krerë, një mjeshterrë atje. A janë gati aktorët?
Rosenkranci
– Po, imzot, ata presin kënaqësinë tuaj.
Gertruda
– Eja këtu, i shtrënjtë Hamlet, rri pranë meje.
Hamleti
– Jo, nënë e mirë, këtu ka magnet më tërheqës.
Polloni– (*I thotë Klaudit*), O, o! E dëgjon?
(Rri poshtë në këmbët e Ofelisë)[14]
Ofelia – Jo, Imzot.
Hamleti– Dua të them kryet në prehërin tënd?
Ofelia – Po, Imzot.
Hamleti– Ç'mendon ti, se kasha ndërmend gjësendi të ligë?
Ofelia – S'mendoj asgjë, Imzot.
Hamleti– Është gjë e bukur të shtrihesh midis këmbëve të një vajze.
Ofelia – Çfarë, imzot?
Hamleti– Asgjë.
Ofelia – Ti je me qef, Imzot.
Hamleti– Kush, unë?
Ofelia – Po, Imzot.
Hamleti– O perëndi, jam gazetari yt i vetëm, si mund të mos jem me qef?
Po vështro sa e kënaqur duket nënja ime,
kurse im atë s'ka dy orë, që ka vdekur.
(Gertruda kthehet dhe pëshpërit diçka me Klaudin dhe Pollonin)
Ofelia

– Jo, ka dy herë dy muaj, Imzot.

Hamleti

– Aqë shumë? Jo, ahere le të vishet djalli në të zeza, se unë do të vesh një kostum gëzofi; o qiej, ka dy muaj që ka vdekur dhe s'është harruar akoma? Ahere
ka shpresë që kujtimi i një burri të madh të rrojë pas vdekjes së tij një gjysmë moti, po për zotin, prapë duhet të ndërtojë kishëra;
ose përndryshe do të vuajë në harresë,
së bashku me kalin qesharak, mbishkrimi
i të cilit është:

Por, o, por o, s'u mënua,
kali qesharak u harrua![15]

Bien trumbeta, kurtinat ngrihen, zbulohet skena e brëndshme dhe fillon të lozë pantomime. Hyn një mbret dhe një mbretëreshë, shumë të dashuruar. Mbretëresha e përqafon atë dhe ay mbretëreshën. Ajo i bie në gjunjë dhe i çfaq dashurinë e saj. Ay ngre dhe ul kryet mbi qafën e saj. Ay shtrihet pas kësaj mbi një lehë me lule. Mbretëresha me ta parë që e zë gjumi e le. Menjëherë pas saj hyn brenda një njeri tjetër, i merr kurorën, e puth, derdh helmim në veshim e mbretit dhe del. Mbretëresha kthehet përsëri, mbretin e gjen të vdekur dhe qan me ngashërim, helmonjës, i shoqëruar me dy ose tre aktorë memecë vjen brënda prapë, dhe vajton edhe ay me të. Të vdekurin e nxjerrin përjashta. Helmonjës i çfaq dashurinë mbretëreshës duke i falur dhurata; ajo duket sikur s'do në fillim, po më në fund e pranon dashurinë e tij. (Kurtina bie)

Hamleti duket i turbulluar dhe hedh vështrimin e tij për nga Klaudi dhe Gertruda, ndërsa çfaqja vazhdon; ata vazhdojnë të flasin me Pollonin gjatë tërë kohës.

Ofelia – Ç'kuptim ka kjo, imzot?
Hamleti– Për zotin, kjo është një keqbërje e fshehtë, domethënë krim.
Ofelia – Ndofta çfaqja do të na e bëjë të njohur çështjen e veprës? *Hyn prologu*
(Aktori që luan pjesën e prologut)
Hamleti– Do ta mësojmë prej këtij mikut. Aktorët s'mbajnë të fshehta; ata i thonën të gjitha.
Ofelia
– Do të na e thotë se ç'kuptim kishte kjo çfaqje?
Hamleti– Po, se çdo çfaqje që ti do t'i çfaqësh, ay nuk do të turpërohet të ta thotë se ç'kuptim ka.
Ofelia
– S'të ka hije të flasësh kështu; do të shikoj lodrën.
Prologu – Për ne si edhe për tragjedinë,
ju lutem të kini mirësinë,
me durim të dëgjoni historinë, *(Del)*
Hamleti– Prolog është ky, apo mbishkrim unaze?
Ofelia – I shkurtër, Imzot.
Hamleti– Si dashuria e gruas.
Hyjnë dy aktorë, një mbret dhe një mbretëreshë.
Aktori – *mbret* –
Plot tridhjet herë ka ardhur rrotull qerrja e Febit[16] ujrave të Neptunit dhe sundmeve të rrumbullta të Tellit.[17] Dhe tridhjet herë nga dymbëdhjet hëna me drit të marrë hua, dymbëdhjet herë nga tridhjet rreth botës u rrotullua qëkur dashuria zëmrat edhe martesa duartë tona na i bashkoi me lidhje të shënjt, sipas dëshirës sonë.
Aktori - *mbretëreshë* –
Edhe aqë herë hëna dhe dielli të kalojnë
dhe prap t'i nëmërojmë më par se dashuria të mbarojë!
Po medet, un' e mjera, je i sëmurë tani vonë fare,

s'ke qef dhe ke ndrruar nga gjëndja jot'e parë.
Dhe jam e çqetësuar, po ndonse jam merak,
Kjo s'duhet të të tronditjë, imzoti im aspak;
se frika dhe dashuri e grave njëra me tjetrën
shkojnë, ose janë asgjë, ose kufirin e kalojnë.
Tani prova ime të tregoi, dashuria ime ç'është,
dhe sa e madhe është ajo, e njëjta dhe frika ime
është; ku dashuria s'ka kufi, dyshimet më të vogla
janë frikë, ku frikët e vogla rriten të mëdha, dashuria
bëhet dritë.
Aktori -*mbret* –
Do të të le e dashur, ditët time të paka janë;
shpejt zëmra do më qëndrojë, fuqitë krejt më lanë;
dhe ti do të rrosh pas meje në këtë botë të bukur,
e dashur, e nderuar dhe me siguri e lumtur,
dhe prapë do të martohesh.
Aktori -*Mbretëreshë* –
Të nëmur qofshin të tjerët, asnjë mos mbetë!
Dashuri të tillë s'dua, tradhti në gjirim tim të jetë;
n'u martofsha përsëri djajtë të më marin,
se asnjë nuk merr të dytë, veç ajo që vret të parin!
Hamleti– *(Mënjanë)* Pelin, pelin!
Aktori -*mbretëreshë* –
Shkaqet që të shtynë në një martesë të dytë
janë lakmia e pasurisë dhe jo zjarr i dashurisë;
Dhe për herë të dytë burrin tim do ta vras,
kur burri im i dytë të më puthjë në shtrat.
Aktori -*mbret* –
Besoj se ti mendon ashtu si tani flet,
po ato që ne vendosim shpesh i thyejmë krejt.
Qëllimi pra ne kujtimi ynë skllavërohet,
Lindet me shumë vrull, po ngadalë pakësohet;
dhe ngjitet mbi pemën si frut i paarrirë,
por bie pa e tundur, kur ay piqet mirë.

Është e nevojshme që këtë ta harrojmë,
se këtë borxh ia kemi hua vetes tonë,
atë që vetes i parashtrojmë me pasion,
qëllimin e harrojmë, kur pasioni kalon.
Furitë e hidhërimit ose të gëzimit,
me plotësimin e tyre zhduken,
sëbashku zhduket dhe plotësimi,
ku gazi dëfren shumë, hidhërimi shumë do vajtojë,
hidhërimi gëzohet,
gazi hidhërohet nga një gjë e vogël.
Bota ndrron dhe s'ka se përse njerëzit të hutohen
dhe dashuritë tona me fatet tona ndrrohen.
se kjo është një çështje që vërtetimin s'ia dimë,
nëse dashuria prin fatin, apo fati dashurinë.
Bie i madhi, vëre re, e lanë të gjithë miqtë;
bën prokopi i varfri i bëhen miq armiqtë;
dhe gjer tani dashuria shërbim fatit i ka bërë,
se ay që ka buri të mirash, s'mbet pa mik as
ndonjëherë,
dhe cilido që në nevojë një mik fyl do të provojë
drejtpërdrejt armikun e tij do ta bëjë.
Por me rregull ku nisëm të mbarojmë
vullnetet dhe fatet tona aqë kundër shkojnë,
që planet tona çfronësohen gjithëmonë,
mendimet tona, janë tonat,
përfundimet asnjë i vetes sonë;
pra, mendon tani, se s'do të dytë martesë,
por do të të vdesin mendimet,
burri i parë po të të vdesë.
Aktori -*mbretëreshë -*
As dheu të mos më japë ushqim, as qielli dritë!
Lodër dhe prehje të mos gjej natë dhe ditë!
Besim im dhe shpresa të kthehen në dëshpërime!
Si murgë në qeli ta kaloj jetën time!

Çdo prapësi që fytyrën e gëzimit errëson,
le të prishjë e çdo të mirë që unë dëshiroj!
Në këtë dhe, në botën tjetër të mundohem,
në qofshta ndonjëherë e ve dhe prapë të martohem!
Hamleti – Shiko tani kur ta thyejë benë!
(I thotë Ofelisë)
Aktori *mbret* –
Kjo është be e rëndë. E dashur lermë të dremit,
jam shumë pa qef dhe dua këtë ditë
të mërzitur ta gënjej me gjumë. *(Bie të flerë)*
Aktori mbretëresha –
Gjumi të nanuristë trutë, fli
dhe kurrë mos ardhtë midis nesh fatkeqësi! *(Del)*
Hamleti– Zonjë, si të pëlqen lodra?
Gertruda – Më duket se zonja premton shumë.
Hamleti– O, po, ajo do ta mbajë fjalën.
Klaudi – E di subjektin?
Mos ka ndonjë fyerje brënda?
Hamleti– Jo, jo, ata bëjnë vetëm shaka, helmojnë
me shaka! S'ka asnjë fyerje këtu.
Klaudi – Si e quajnë çfaqjen?
Hamleti– Kurth i miut, për besë, si metaforë.
Kjo çfaqje paraqet një vrasje që është bërë
në Vienë. Gonzago ia thonë emrin dukut, të shoqes
së tij Batistë, do të shikosh tani shpejt,
që kjo është një vepër prej kopili,
por s'ka, madhërinë tuaj dhe ne
që kemi shpirtra të pafajshme s'na prek aspak.
Lere kalin plak të zdramosur të shtrëmbërohet
nga dhëmbja, ne e kemi zverkun të pavrarë…
Hyn një aktor si Luçiano, me një shishe
Ky është një farë Luçiano, nip i mbretit.
Ofelia – Ti je shpjegonjës i mirë, Imzot.

Hamleti – Unë mund të ta shpjegoja dashurinë
tënde, midis teje dhe të dashurit tënd, po të shikoja
kukllat të gërgitshin.
Ofelia – Ti je i mprehtë, imzot, i mprehtë.
Hamleti– Do të të kushtojë ty një të rënkuar,
që të topitsh presjen e dëshirës sime.
Ofelia- Edhe më mirë dhe më keq.
Hamleti – Ashtu i keqkuptoni ju burrat tuaj… fillo,
vrasës; Lijë! Leri fytyrat e tua të mallkuara dhe fillo!
Eja: korbi krrokës ungron për hakmarrje.
Luçioano – Mendime të zeza, duart gati, lëngjet të
aftë dhe rrethanat pajtohen;
njeri s'ka rrotull, ora ësht e përshtatshme dhe të
gjitha përbetohen.
Barëra kndërmonjëse mbledhur dhe përzjerë në mes
të natës,
tri herë fryrë, tri herë yshtur dhe tmerrë,
jetën e shëndetshme, merrni menjëherë.

(Derdh helmin në veshin e mbretit që fle)
Hamleti – E helmon në kopshtin e tij që t'i marrë
tokat. Emëri i tij është i Goznago; historia është e
gjallë akoma. Dhe është shkruar se si vrasësi fiton
dashurinë e të shoqes së Gonzagos.
Ofelia – Mbreti po ngrihet!
Hamleti– Si, u trëmb nga zjarri i rremë!
Gertruda – Ç'ke, imzot?
Polloni– Ndalni çfaqjen!
Klaudi – Më jepni pak dritë të shkoj!
Të gjitha – Dritë, dritë, dritë!
(Dalin që të gjithë, përveç Hamletit dhe Horatit)
Hamleti– Po, lere drerin e goditur duke blegëritur të
rendë, luan dreri i paplagosur;
se ca duhet t'i ruaj, ndërsa ca do të flenë;

kështu bota sillet rrotull.
Me këtë zotëri dhe me një tufë me pendë[18] – fati
po të më tradhëtojë – dhe me dy trëndafij të rremë
përmbi këpucët e mia të çara, nuk do të mundja
të bëhesha ortak në një zogori aktorësh, zotëri?
Hamleti– Për një gjysmë pjeso![19]
Hamleti– Unë për një të tërë,
se ti e di, o i shtrënjtë Damon,[20]
që këtë vend e xhveshnë nga një mbret.
i cili kishte madhërinë e Jupiterit,
dhe tani mbretëron – nja pallua.[21]
Horati – Ti mund ta kishe thënë këtë varf me rimë.
Hamleti– O, i mirë Horat, e çmoj fjalën e lugatit
një mira lira. A e vure re?
Horati – Shumë mirë, Imzot.
Hamleti– Kur u thanë fjalët e hemosjes?
Horati – E vëzhgova shumë mirë.
Hamleti– A, a! Ejani, muzikë! Hajdeni, fyejt!
Në qoftë se mbretit s'i pëlqen komedia,
për zotin, duke se s'i pëlqen historia.
Hajdeni, muzikë!
(Hyjnë përsëri Rosenkranci dhe Guildesterni)
Guidelsterni
– I miri im, imzot, më lejoni të të them një fjalë.
Hamleti– Zotëri, një histori të tërë.
Guidelsterni – Mbreti, Imzot…
Hamleti– Po, zotëri, ç'ka?
Guidelsterni – U tërhoq në dhomën e tij, i turbulluar pamasë.
Hamleti– Prej të pirit, zotëri?
Guidelsterni – Jo, imzot, prej vrerit.
Hamleti
– Urtësia jote do ta dëftente veten e saj më të pasur,
po t'i thoshte këtë mjekut të tij; se po t'i porosit

unë pastrim, do ta zhyt ndofta në vrer më të madh.
Guidelsterni – I mirë imzot, dëgjomë një herë,
dhe mos u largo kaq me inat nga çështja ime.
Hamleti– Më zbute, zotëri, folë.
Guidelsterni – Mbretëresha, jot'ëmë, me hidhërim të madh dhë shpirt të brengosur, më dërgoi tek ty.
Hamleti– Mirseerdhe.
Guidelsterni – Jo, i mirë imzot, kjo oborrsi s'është e përshtatshme. Por, po të kesh kënaqësinë të më japsh një përgjigje të saktë, do kryej urdhrin e sat'ëme; në mos, ndjesa juaj dhe kthimi im do jenë fundi i punës sime.
Hamleti– Zotëri, s'mund.
Rosenkranci – Çfarë, imzot?
Hamleti– Të të jap një përgjigje të saktë; se kam mëndjen të sëmurë. Po, zotëri, një përgjigje që unë mund të bëj, është – në urdhrin tënd; ose më mirë, siç thua ti, në urdhrin e simëje; prandaj jo më tepër përmbi çështjen; imë, thua...
Rosenkranci – Ahere kështu thotë sjellja jote e habiti sa e la me gojëhapur.
Hamleti– O, djali i çuditur, që habiti aqë nënën! Po s'është aty diçka tjetër, që ndjek thëmbrat e habitjes të kësaj nëneje? Thuaj?
Rosenkranci – Ajo dëshëron të flasë me ty në dhomën e saj, para se të vesh të flesh.
Hamleti– Do t'i bindemi dhe sikur të ishte dhjetë herë nëna jonë. Ke ndonjë punë tjetër me ne?
Rosenkranci – Imzot, ti një herë më donje?
Hamleti– Dhe akoma të dua, betohem për këtë kapës dhe vjedhës.
Rosenkranci – I mirë, imzot, ç'është shkaku i turbullimit tënd?
Ti sigurisht i mbyll derën vetë lirisë tënde,

po të refuzosh t'i thuash hidhrimet e tua,
mikut tënd.
Hamleti– Zotëri, do të mbetem pa u graduar.
Rosenkranci
– Imzot, kjo është e pamundur, mberti vetë
të dha fjalën që ti je princi trashëgimtar
i Danimarkës.
Hamleti– Vërtet, zotëri, por gjersa të rritet bari...
fjala e urtë mban erë myk.
(Hyjnë përsëri aktorë me fyej)
O, fyejt! Më jep të shoh një. Të mbaroj me ju;
pse vini rrotull të më merrni erën, sikur
do të më futni në ndonjë kurth?
Guidelsterni – O, imzot, nëse detyra ime është shumë guximtare, dashuria ime është shumë e pasjellshme.
Hamleti– Nuk të kuptoj se ç'më thua.
Po, nuk i bie pak këtij fyelli?
Guidelsterni – Imzot, nuk di t'i bie.
Hamleti – Të lutem.
Guidelsterni – Besomë, s'mund.
Hamleti – Të lutem shumë.
Guidelsterni – Nuk di as si ta zë, Imzot.
Hamleti – Është aq kollaj si gënjeshtra; zëri këto vrimat me gishtrinjtë e tu, fryji me gojë dhe do të bjerë shumë bukur. Ja, këto janë rregullat.
Guidelsterni – Por unë s'mund t'i luaj këta të nxjerrin shprehja të ëmba; nuk jam stërvitur.
Hamleti – Po vështro ti tani, se sa gjë të padenjë më bën mua. Ti do të më luash mua; ta të duket sikur i di kyçet time, do të ndukësh të fshehtat e zëmrës sime, ti do të nxjerrë zë prej meje,

nga nota më e ulët gjer në kulmin e notës sime më të larta. Dhe këtu ka shumë muzikë, me zë të shkëlqyer, në këtë instrument të vogël!
Prapsepra ti s'e bën dot të flasë.
Për zotin, panden ti se unë
jam më kollaj të luhem se sa një fyell?
Quam çfarëdo vegle që të duash, ndonëse ti
mund të më ngacmosh, po nuk mund të më luash.
(Hyn Polloni përsëri)
Perëndia të bekoftë, zotëri.
Polloni– Imzot, mbretëresha dëshëron të flasë me ty dhe menjëherë.
Hamleti– E sheh atë re atje tej, që forma e saj është pothuajse si e një deveje?
Polloni– Për besë, dhe është si deve me të vërtetë.
Hamleti– Më duket se është si nus'e lalës.
Polloni– Po, e ka kurrisin si nus' e lalës.
Hamleti– Ose si balenë.
Polloni– Ngjet shumë si balenë.
Hamleti– Ahere, do të vete tek im më, pak më vonë.
(Mënjanë) Këta po më detyrojnë të loz rolin e të marrit. Me tërë forcat e mundësive time.
Do të vij menjëherë.
Polloni– Do të vete t'i them.
(Polloni, Rosenkranci dhe Guildensterni dalin)
Hamleti– Menjëherë, thuhet kollaj, Lermëni miq.
(Dalin Horati dhe aktorët)
Tani është tamam koha magjistare e natës,
kur varret hapin gojët dhe vetë ferri çfryn
molepsje nëpër botë.
Tani mund të pija gjak të ngrohtë,
dhe do të bëja të tilla vepra mizore, që dita
po t'i shihte do të dridhej.
Po dale! Tani te nënan ime.

O zemër mos e humb natyrën tënde,
kurrë mos e lerë Shpirtin e Neronit të hyjë në këtë gji
të ngurtë;
mizor le të jem, po jo i panatyrshëm;
me fjala kama do t'i jap, po me dorë asgjë;
gjuha ime dhe shpirti im të bëhen hipokritë;
dhe me fjalë sado rreptë ta qërtoj
ato kurrë, shpirti im, të mos më lerë t'i zbatoj.
(Del)

Skena e tretë

Një dhomë në kështjellë
Hyjnë Klaudi , Rosenkranci dhe Guildensterni

Klaudi – Nuk më pëlqen; as është siguri për ne
ta lëmë çmëndjen e tij të rravgohet. Prandaj
bëhuni gati, urdhëresat i kam përpilluar,
dhe ay do të vijë bashkë me ju në Angli;
kushtet e shtetit s'mund të durojnë një rast
kaq të rrezikshëm, që rritet në çdo hop
prej tërbimit të tij.
Guidelsterni – Do të gatitemi;
Është detyrë e shënjtë dhe frikë legjitime,
të ruash sigurinë e kaq shumë shumë njerëzve,
që rrojnë dhe ushqehen nga madhëria juaj.
Rosenkranci
– Jeta e njeriut të veçantë është e detyruar
megjithë fuqitë dhe armët e mëndjes
të mbrojë veten e saj nga dëmi; por edhe më tepër
ajo frymë, prej së cilës varen mirëqënia dhe sigurimi
i aqë shumë jetëve; zhdukja e madhërisë
s'vdes vetëm;
po si një ngushticë tërheq ç'është afër saj me të;
o, ajo është një rrotë e madhe,
ndërtuar mbi majën e malit më të lartë,
në spilcat e mëdha të së cilës
dhjetëmijë gjëra më të vogla
janë puthisur duke kolisur; e cila kur shëmbet,
çdo shtojcë e vogël, çdo çikërrimë që ndjek,
shoqëron prishjen zhurmëmadhe.
Psherëtitja e mbretit është rënkimi i tërë shtetit.
Klaudi – Përgatituni, ju lutem, të niseni menjëherë,
se ne do t'i vëmë pranga këtij gogoli,

i cili tani bredh shumë këmbë lirë.
Rosenkranci dhe Guidelsterni – Do të nisemi menjëherë *(Rosenkranci dhe Guildensterni dalin)*
Hyn Polloni
Polloni– Imzot, ay po vete te dhoma e s'ëmës;
unë do të fshihem prapa qilimit t'i përgjoj,
se çdo të thonë;
dhe jam i sigurtë që do ta qërtojë keq;
por siç the ti, dhe urtësisht e the,
është e nevojshme dhe ndonjë tjetër vesh
përveç atij të nënës, meqë natyra i bën ato të
anëshme ndaj fëmijëve të tyre.
Rri me shëndet, madhëri;
dhe më parë se të shkosh në shtrat do të kaloj
nga ju t'ju them se ç'mësova.
Klaudi – Faleminderit, i dashur. *(Polloni del)*
O, krimi im u qelb, era i arriti qiellin;
ka të parën, më të vjetrin mallkim mbi të –
vëllavrasjen! Të lutem, unë s'mund,
ndonëse dëshira ime është aqë e fortë sa vullneti,
Faji im i madh e mund qëllimin tim të fortë;
dhe si një njeri që e shtrëngojnë dy punë,
rri më këmbë e pres nga të filloj më parë
dhe nuk përfill as njërën.
Po sikur kjo dor' e mallkur
të jetë njollosur me gjakun e vëllait
– s'ka mjaft shi atje në qiellin e ëmbël
ta lajë e ta zbardhojë si dëborë?
Përse shërben mëshira?
Përveç se të përballojë fytyrën e krimit!
Dhe ç'është lutja, veçse ajo fyqi e dyfishtë
që na mban në këmbë, para se të bien,
ose të na ndjejë kur kemi rënë!
Ahere do t'i mbaj sytë lartë;

faji u bë. Po, o, çfarë lutje mund
të më ndihmojnë mua? Të më falet vrasja e ndyrë!
Kjo s'mund të bëhet, meqë unë nuk jam xhveshur
nga shkaqet për të cilat kreva vrasjen –
kurora imë, ambicja ime dhe mbretëresha ime.
Mund njëjt t'i falen mëkatet dhe të mbajë fajësinë?
Dora e praruar e fajësisë dëndur shtyn mënjanë
drejtësinë;
dhe shpesh e kemi parë vetë paranë e ndyrë
të blerë krejt ligjin; po s'është ashtu atje lartë;
atje s'shkojnë dinakëritë – atje vepra qëndron
në natyrën e saj të vërtetë;
dhe në vetë shtrëngohemi,
bile edhe me gojë dhe fytyrë të parashtrojmë
fajet tona. Ahere? Ç'mbetet?
Të provoj se ç'mund të bëjë pendimi;
Dhe ç'farë nuk mund?
Prapseprapë ç'mund të bëjë ay, kur një
s'mund të pendohet?
O gjëndje e mjerë! O gjiri im i zi si vdekja!
O shpirt në grackë, që sa përpiqesh të shpëtosh,
më keq ngatërrohesh.
Ndihmoëni ëngjëj! Bëni përpjekje!
Krrusuni kryeneçë gjunjë
dhe zemër me tela prej çeliku,
Bëhu e butë si gilcat e bebes të posa lindur!
Të gjitha mund të bëhen mirë! *(Bie në gjunjë)*
Hyn Hamleti në dhomën e pritjeve
dhe qëndron me të parë Klaudin.
Hamleti– *(I afrohet hyrjes së sallës)*
Tani mund ta kryej fare mirë, tani që falet;
dhe tani do ta pryej; *(Nxjerr shpatën)*
dhe kështu ay vete në qjell;
dhe unë marr shpagimin. Por kjo duhet parë:

një katil vret tim'atë; dhe për të
unë i biri i tij i vetëm këtë të poshtër
e dërgoj në qiell.
O, o po ky është shpërblim dhe jo hakmarrje.
Ay më vrau tim atë fare të papregatitur;
Me të gjitha krimet shpërthyer si maj i mblerë,
Dhe se si është gjëndja e mëkatave të tij,
një zot e di;
po sipas rrethanave tona dhe siç mendohemi ne,
e ka keq; dhe jam ahere unë i shpaguar duke
i marrë gjakun, ndërsa ay pastron shpirtin e tij,
kur ay është gati dhe i pregatitur për udhë?
Jo. *(Vë shpatën në këllëf)*
Prapa, shpatë,
dhe ta kapsh në rast më të tmerrshëm;
kur të jetë në gjumë i dehur, apo në tërmeqjet e tij;
ose në kënaqësitë e incestit të shtratit të tij;
tek po luan, blasfemon; ose në ndonjë vepër
që s'ka traga shëlbimi në të; ahere pengoje,
që thëmbrat e tij të shqelmojnë qjellin,
dhe shpirti i tij të jetë i mallkuar dhe i zi
si ferri, ku do të vejë. Nëna më pret. –
Ky ilaç vetëm t'i zgjat ditët e tu të sëmura në dhet.
(Del)
Klaudi – *(Ngrihet)* Fjalët më fluturojnë lartë,
mendimet përposh më mbeten,
fjala pa mendim në parajsë s'vete. *(Del)*

Skena e Katërt

Në dhomën e Gertrudës.
Qilima varur në mur.
Portretet e mbretit Hamlet dhe Klaudit.
Karrike dhe një minder.
Hyjnë Gertruda dhe Polloni

Polloni– Do të vijë menjëherë.
Dhe vështro detyroje. Të vijë në vete.
Thuaji që lodrat e tij
u bënë shumë vulgare dhe s'durohen,
Dhe që biri juaj është bërë perde
dhe qëndron në mes
Të zëmërimit të mbretit dhe të atij;
Unë do të fshihem këtu.
Ju lutem thuajuni drejtpërdrejt këto.
Hamleti– *(Që jashtë*) Nënë, nënë, nënë!
Gertruda – Të siguroj se do t'ia them;
mos ki frikë; tërhiqu se po vjen.
(Polloni fshihet prapa çilimit)
Hyn Hamleti
Hamleti– Tani, nënë, ç'është çështja?
Gertruda – Halmet, e ke fyer shumë tët' atë.
Hamleti– Nënë, e ke fyer shum tim atë.
Gertruda:
Eja, eja në vete, më përgjigjesh me gjuhë të tërbuar.
Hamleti
– Shko, shko, më pyet me gjuhë të zvetëtuar.
Gertruda – Ç'janë këto, Hamlet?
Hamleti– Ti më thuaj ç'kërkon?
Gertruda – Më ke harruar?
Hamleti– Jo, për zotin, jo aqë.
Ti je mbretëresha, e shoqja e të vëllait të tyt'shoqi;

dhe donja që ti të mos ishe – jo, nëna ime.
Gertruda – Ahere do të vë njerës, të cilët do të të bëjnë të kuptosh.
Hamleti– Eja, eja. Rri poshtë. Mos lëviz;
nuk do të të le të shkosh para se të të vë
një pasqyrë përpara teje,
ku mund të shikosh pjesët tënde më të brëndshme.
Gertruda
– Ç'ke ndërmend të bësh? Mos do të më vraç?
Ndihmë! Ndihmë! Oh!
Polloni– *(Prapa qilimit)* Çfarë! Oh! Ndihmë! Ndihmë!
Hamleti– (*Nxjerr shpatën*) Qysh? Një mi? E vrava,
për një dukatë, e vrava.
(Ngul shpatën përmes qilimit)
Polloni– *(Prapa qilimit*) Oh, më vranë! *(Bie i vdekur)*
Gertruda – O bobo, ç'bëre?
Hamleti– Çfarë, mos është mbreti?
Gertruda
– O ç'vepër e rrëmbyer dhe gjakësore është kjo!
Hamleti
-Vepër gjakësore!
Pothuajse aqë e ligë, e mirë nënë, sa të vraç një
mbret dhe të martohesh me të vëllanë.
Gertruda – Sa të vraç një mbret?
Hamleti– Po, zonjë atë thashë.
(Ngre qilimin dhe zbulon Pollonin)
Ti budalla i mjerë, matuf e i bezdisur,
udhën e mbarë!
të pandeva për më të mirin se ty; merr fatin tënd;
ti e kuptove që të jesh i bezdisur është mjaft rrezik.
(Kthehet prapa dhe lëshon qilimin)
Pusho mos i shtrydh duart. Qëtësohu! Rri poshtë,
dhe lermë të të shtrydh zemrën, se ashtu do të bëj,
po të jetë bërë prej lënde të depërtuar;

në se zakon' i mallkuar s'e ka ngurosur atë aqë,
sa të jetë mburojë e papërshkuar kundër ndjenjës.
Gertruda – Ç'kam bërë unë, që t'i guxon të tundsh gjuhën tënde
me zhurmë aqë të vrazhdë kundër meje?
Hamleti– Një vepër të atillë,
që njollos hirin dhe të kuqt e turpit,
e quan virtutin hipokrit, heq trëndafilin
nga balli i bukur prej një dashurie të mitur,
dhe vë atje një flluskë; i bën bet' e martesës
të rrema si bet' e kumarxhive; o, vepër të atillë,
që nduk nga lidhja e ndershme e martesës
shpirtin vetë, dhe fenë e ëmbël e bën
përzjerje të ngatërruar fjalësh;
skuqet fytyra e qiellit;
dhe kjo lëndë e ngurtë prej dheu,
me fytyrë të pikëlluar, sikur është përpara
gjykimit të fundit,
sëmuret së menduari për këtë vepër.
Gertruda – Bobo, un e mjera çfarë vepër është kjo,
që gjëmon me aqë forcë dhe më ndëshkon që me fjalët e para?
Hamleti–
(E shpie t'ëmën përpara pikturave që varen në mur)
Shiko këtë pikturë dhe këtë këtu,
dy paraqitje të përkundërta të të dy vllezërve;
vështro se ç'hir rrinte mbi këtë ballë;
krelat e Hyperionit; fytyra vetë e Jupiterit;
një sy si Marsi, kanoset dhe urdhëron;
qëndrim të hedhur si atë të Merkurit,
kur posa del mbi majën e malit qiell puthur;
një kombinim dhe një pamje me të vërtetë,
mbi të cilën çdo perëndi dukei të vintë vulën e saj
për t'i dhënë botës garanti për një burrë;

ky ishte burri yt; Vështro tani këtë tjetrin.
Ky është burri yt, si një kalli i mykur,
Që moleps të vllanë e tij të shëndoshë. Ke sy?
Si e le kulletën në këtë mal të bukur,
që të majesh në këtë moçal? Hë! Ke sy?
Ti s'mund të quash këtë dashuri; se në moshën
tënde zjarri i gjakut është zbutur, shtruar
dhe shoqëron gjykimin; dhe çfarë gjykim
do të të zbritte nga ky te ky? Ndjenja sigurisht ke,
se përndryshe s'do të kishe lëvizje;
po sigurisht ndjenja të është ndrydhurm,
se marrosja nuk do të gabohei aqë,
as ndjenja nuk do të robërohej kurrë kaqë,
sa të mos i vinte vetes një kufi e të zgjidhte
në një ndryshim të këtillë. Ç'djall ishte ay,
që të mashtroi kështu me mbullasyza?
Sytë pa prekje, prekja pa parë,
veshë pa duar ose sy, nuhatje pa gjë tjetër,
ose edhe një pjesë e sëmurë e një ndjenje të vërtetë
nuk do të kishte shënja të tilla kokëtrashësie.
O turp! Ku është të kuqtë tënd? Ferr kryengritës,
në se ti revoltohesh në kockat e një zonje,
te rinia e flaktë virtuti le të digjet si qiri,
dhe në zjarrin e vetes tij të tretet;
e të mos ndjejë turp
kur pasioni i përdhunuar e urdhëron të sulmoje,
kurse dhe bryma vetë djek po me aqë forcë,
dhe arësua e bën rrufjan vullnetin.
Gertruda – O, Hamlet mos më folë më,
ti më kthen sytë në vetë shpirtin tim,
dhe atje shoh njolla të tilla të zeza,
të cilave nuk u del boja.
Hamleti– Jo, veç të rrosh
në djersën e çelbur të një shtrati të lërosur,

zhytur në puganësi, kënaqesh dhe bën dashuri
në tharkun e ndyrë.
Gertruda – O, mos më folë më;
Këto fjalë si kama më hyjnë në veshët tim.
Jo, mos Hamlet i ëmbël:
Hamleti– Një vrasës dhe një i poshtër;
një rob që s'është një të dhjetën e njëzetës pjesë
e ytzotit tënd të parë; një ves i mbretërve;
një krydhës i fronit dhe i pushtetit,
që nga një raft kurorën e çmuar e vodhi
dhe e futi në xhepin e tij!
Gertruda – Mos më folë më.
Hamleti– Një mbret prej leckash dhe andresh!...
(Hyn Fantazma)
Shpëtomëni dhe mbulomëni me krahët tuaj,
roje qiellore! Ç'do pamja jote e hirshme?
Gertruda – Bobo, është i marrë?
Hamleti– Mos erdhe të qertosh birin tënd të plogët,
që humb më kot kohën dhe zjarrin,
dhe le të kalojë zbatimin e rëndësishëm
të urdhrit tënd të tmerrshëm?
O, thuam!
Fantazma – Mos harro! Kam ardhur,
Vetëm që të mpreh qëllimin tënd mënt topitur.
Po, vështro se ç'tmerr e ka pllakosur tët'ëmë;
o, ndërhynë në mes të saj
dhe shpirtit të saj që lëfton;
se përfytyrimi në njerzit e dobët punon më me forcë;
foli asaj, Hamlet!
Hamleti– Si je, zonjë?
Gertruda – Bobo, si je ti,
që mbërthen sytë në hapësirë,
dhe me erën e palëndëshme fjalosesh?
para syve tënd frzma jote egërsisht fekton;

dhe si ushtarë të fjetur në kushtrim,
flokët e tu të palosur, si krijesa të gjalla,
hidhen përpjetë dhe rrinë më këmbë.
O biri im fisnik,
mbi nxehtësinë dhe flakën e turbullimit tënd
spërkat durim të ftohtë. Por cilin shikon?
Hamleti
– Atë! Atë! Shiko sa e verdhë është pamja e tij!
Çfaqja e tij dhe shkaku, bashkuar,
gurëve po t'u flisnin, do t'i bënin ata të prekeshin.
Mos më vështro,
se mos me këtë pamje për të ardhur keq më ndrron
vendimin tim të rreptë; pastaj ajo që duhet të bëj
ndërron natyrën e qëllimit tim të egër!
Lotë ndofta për gjak.
Gertruda – Kuj ia thua këto?
Hamleti– Nuk sheh asgjë atje?
Gertruda
– Asgjë fare; prapëseprap të gjtha sa janë i shoh.
Hamleti– Dhe s'dëgjove asgjë?
Gertruda – Jo, asgjë, veç fjalëve tona.
Hamleti
– Si, shiko atje! Shiko, ku ay po shkon tutje!
Im atë, me veshjen e tij mbretërore si ahere kur
rronte!
Shiko, ku ay po shkon, posa, tani, jashtë te porta!
(Fantazma del)
Gertruda – Kjo është çpikje e trurit tënd;
Krijesa e patrupshme është vetëm
marrëzia jote dinake.
Hamleti – Marrëzi!
Pulsi im, si yti, më bie në rregull,
me ritmin e një muzike të shëndoshë;
s'janë marrëzi ato që të shqiptova; provomë,

dhe të gjtiha do t'i them fjalë për fjalë; që një i marrë
s'e bën dot këtë. Nëno, për dashurinë e zotit,
mos e lyej shpirtin tënd me atë mirë lajkatare,
që gjoja marrëzia ime flet dhe jo fajësia jote;
ajo vetëm do bëjë cipë mbi vëndin e plagës,
ndërsa puganësia e qelbur,
shkon nëpër të gjitha përbrënda
dhe infekton pa u para. Rrëfeu te perëndia;
pendohu për ç'u bë, shmangu në të ardhmen,
dhe mos e përhap plehun mbi barërat e egra
dhe t'i bësh më të ashpra.
Ndjemë këtë virtutin tim,se në majmësinë e kësaj
kohe sonë që mezi merr frymë,
virtuti vetë prej vesit duhet të lupjë ndjesë,
i përulur dhe me lutje për leje që t'i bëjë mirë.
Gertruda
– O, Hamlet, ma theve ma bëre dy zemrën.
Hamleti– O, hidhe tutje pjesën e saj më të ligë,
dhe rro më e thjeshtë me gjysmën tjetër.
Natën e mirë; po mos shko në shtratin e tim ungji;
Merr një virtutë në mos ke.
Përbindshi, zakoni, i cili ha tërë ndjenjat,
djalli i veseve prapseprap është ëngjëll,
se që të kryen veprat e bukura dhe të mirat,
ay po ashtu u jep rroba ose uniformë
që i veshin dhe u vjen mirë. Mbahen vetëm sonte,
dhe ajo do të të huaj një lloj lehtësie
në përmbajtjen e dytë; tjetra, më e lehtë;
se stërvitja thuajse mund ta ndrrojë vulën e natyrës,
dhe ose frenohet djallin, ose hidhe jashtë
me forcë të jashtëzakonshme.
Dhe një herë natën e mirë;
dhe kur ti të dëshërosh të bekohesh,

unë bekim do lyp prej teje. Sa për këtë imzotin,
(*Tregon Pollonin)*
pendohem; po perëndia e deshi kështu,
të më dënojë mua me këtë, dhe këtë me mua,
që të bëhem kamçiku dhe shërbëtori i tij.
Do ta vendos dhe jam gati t'i përgjigjem
vdekjes që i dhashë. Prap, prapë, natën e mirë.
Unë duhet të bëhem mizor,
vetëm që të shtrëmbrën të ndreq;
kështu ligsh filloi dhe prapa mbetet më keq.
(Niset të shkojë po kthehet)
Dhe një fjalë akoma, zonjë e mirë.
Gertruda – Ç'duhet të bëj unë?
Hamleti
– Jo, në asnjë mënyrë nuk të them të bësh këtë;
lere mbretin pianec të të kandisjë përsëri në shtrat;
të të cimbidhjë faqet me dhelka;
të të quajë miun e tij;[22]
dhe lere atë për një çift puthje të çelbura,
ose të të bjerë me përkëdhelje në qafën tënde,
me gishtrinjtë e tij të mallkuar,
që të të bëjë t'i zbulosh tërë këtë çështje,
që unë nga qënia ime s'jam i marrë,
por kam një marrëzi të mjeshtëruar.
Këtë është mirë t'ia bësh të njohur;
po cila grua dhe mbretëreshë,
e bukur, serioze dhe e urtë,
do të fshehë të tilla gjëra me rëndësi,
nga zhaba e saj,
nga lakuriq i saj, dhe nga maçoku i saj?[23]
Cila do të bënte këtë?
Jo, për inat të arsyes dhe të të fshehtës
Zbyll shportën, mbi kulmin e shtëpisë,
lëshohi zogjtë të fluturojnë

dhe si majmun i famshëm,
që të provosh se çdo të ngjasë, futu në shportë,
rrukullisu përposh dhe thyej zverkun.
Gertruda
– Të siguroj, që në se fjalët bëhen prej fryme,
dhe fryma prej jete, unë s'kam jetë të fryjë
ato që më ke thënë.
Hamleti– Unë duhet të vete në Angli; ti e di këtë?
Gertruda – Bubu, harrova, kështu është vendosur.
Hamleti
– Letrat u vulosën; dhe shokët tim të shkollës,
të cilët i besoj, sa besoj dhëmbët e nepërkës,
mbarin mandatin; ata do të më hapin udhën,
dhe do të më futin në ndonjë grackë. Por, s'ka gjë;
se është kënaqësi ta bësh minatorin
të hidhet në erë me minën e tij; dhe do të jetë zor,
po unë do të mih një pash nën minat e tyre,
dhe do t'i hedh në hënë; O, është shumë ëmbëlsi,
kur në një vijë dy djallëzi drejtpërdrejt takohen.
Këtë njeriun do ta mbështjell për së shpejti;
dhe do t'ia zvarris zorrët të dhoma fqinjë.
Nënë, natën e mirë. Me të vërtetë ky këshilltari
Është tani shumë i heshtur, shumë i fshehtë,
dhe shumë i rënduar,
por sa rronte ishte një budalla llafazan i djallëzuar.
Eja, zotëri, të mbaroj me te.
Natën e mirë, nënë.
(Hamleti del duke hequr zvarrë Pollonin. Gertruda bie mbi minder dhe qan).

AKTI I KATËRT

Skena e parë

Pak më vonë. Hyjnë Klaudi ,
Rosenkranci dhe Guildensterni.

Klaudi – *(Ngre Gertrudën)*
Duhet të kesh shok për këto psherëtima;
këto ngashërime të thella;
duhet të na i shpjegosh;
është mirë që ne t'i dimë.
Ku është yt bir?
Gertruda – Lernani këtu vetëm për pak.
(U thotë Rosenkrancit dhe Guldensternit,
të cilët dalin jashtë menjëherë)
Ah i miri im, imzot, ç'kam parë sonte!
Klaudi– Çfarë, Gertrudë? Ç'bën Hamleti?
Gertruda
– I marrë si deti dhe era kur të dy ndeshen.
Cili është më i fortë; në turbullimin e rrebës së tij,
kur dëgjoi të lozë diçka prapa qilimit,
nxjerr shpatën e ti dhe thërret: "Një mi, një mi!"
Dhe në këtë parandjenjë të trurit të tij,
Vret, të fshehurin, plakun e mirë!
Klaudi– O, vrasje e kobshme!
Ajo do të më ngjiste dhe mua po të isha atje;
liria e tij është plot kërcënime për të gjithë,
për ty, për mua, për cilindo.
Bobo, si do t'i përgjigjemi kësaj vepre gjakatare?
Do të më ngarkojnë mua; duhej ta kisha
parashikuar, ta kisha lidhur dhe ta kisha mbajtur
larg nga bota, këtë të ri të marrë.

Po dashuria jonë qe aq e madhe, sa s'donim ta
kuptonim se ç'ishte m'e përshtatshme;
por, si një që ka një sëmundje të ligë
dhe që të mos e zbulojë, e le atë t'i hajë
dhe vetë palcën e jetës. Ku është?
Gertruda – Të vërë gjëkundi trupin që ka vrarë;
mbi të cilën vetë çmëndja e tij, si një ar,
në një madem prej metali të pavlefshëm,
dëften veten e tij të thjeshtë; qan për atë që u bë.
Klaudi– O, Gertrudë, eja të shkojmë!
Dhe para se të çikjë dielli malet
do ta nisim me anije që këtej;
dhe këtë vepër të kobshme
ne duhet me tërë madhërinë dhe aftësinë tonë,
ta përkrahim dhe çfajësojmë. Ej, Guildenstern!
(Hyjnë përsëri Rosenkranci dhe Guildensterni)
Miq, të dy, shkoni merrni dhe disa të tjerë ndihmë;
Hamleti në marrosje e sipër vrau Pollonin,
dhe nga dhoma e s'ëmës së tij e zvarrisi;
shkoni e gjeni, merreni me të mirë dhe silleni
kufomën në paraklisi; ju lutem, nxitoni!
(Rosenkranci dhe Guildensterni dalin)
Eja, Gertrudë do të thërresim miqtë tanë më të urtë;
dhe t'u njoftojmë se ç'kemi ndërmend të bëjmë,
dhe ç'e keqe ka ngjarë;
prej kësaj, shpifja prej nepërke,
pështpëritja e së cilës, çon shtimen e saj të helmuar,
përmbi diametrin e dheut, sikundër topi në nishan,
mos marrë emërin tonë
dhe godit erën e paprekshme.
O, eja të shkojmë!
Tronditje dhe çqetësim shpirtin më hutojnë!

Skena e dytë

Një tjetër dhomë në kështjellë

Hyn Hamleti

Hamleti– E fsheva mirë.
Rosenkranci dhe Guidelsterni – *(Që nga jashtë)*
Hamlet! Imzot, Hamlet!
Hamleti
– Dale, ç'është kjo zhurmë? Kush thërret Hamlet?
O, ja po vinë.
(Hyjnë Rosenkranci dhe Guildensterni)
Rosenkranci – Ç'e bëre, imzot trupin e vdekur?
Hamleti
– E trazova me pluhur, me të cilin është soj.
Rosenkranci – Thuana ku është, që ta marrim
dhe ta shpiem në paraklis.
Hamleti– Mos e besoni.
Rosenkranci – Çfarë të mos besojmë?
Hamleti– Që unë mund të ruaj të fshehtën tuaj
dhe u timen. Përveç kësaj, kur pyetesh
prej një sfyngjeri, ç'përgjigje duhet
të bëhet prej të birit të një mbreti?
Rosenkranci – Për sfyngjer më merr mua, imzot?
Hamleti– Po, zotëri; që thëthit përkrahjen e mbretit,
shpërblimin dhe autoritetin e tij.
Po të tillë zyrtarë i bëjnë mbretit
më në fund shërbimin më të mirë; ay i mban ata,
si një majmum arrat në bullçirin e tij; sefte
i kllapit dhe pastaj t'i gëlltijë; kur ay
nevojitet, për ato që kini mbledhur.
S'bën tjetër veçse të shtrydh,
dhe, sfungjer, do të thahesh përsëri.

Rosenkranci – Nuk të kuptoj, Imzot.
Hamleti
– Gëzohem; fjala kopilishte fle në veshin e kokëtulit.
Rosenkranci – Imzot, duhet të na thuash ku është trupi, dhe të vish me ne te mbreti.
Hamleti– Trupi është me mbretin, po mbreti s'është me trupin. Mbreti është një gjë.
Guidelsterni – Një gjë, imzot!
Hamleti– E asgjëje; shpjerméni tek ay. Fshehu dhelpër,[24] dhe të gjithë pas. *(Dalin)*

Skena e tretë

Një dhomë tjetër në kështjellë

Hyn Klaudi i shoqëruar nga oborrtarë

Klaudi– Dërgova ta kërkojnë; të gjejnë edhe trupin.
sa rrezik që është që ky njeri ecën i lirë!
Prapseprap nuk mund të zbatojmë ligjin e rreptë,
se atë e duan turmat e ngatërruara,
të cilat pëlqejnë me sy dhe jo me gjykimin e tyre;
Dhe ku është kështu, dënimi i fajtorit peshohet,
po kurrë fajësia. Po që të kryen të gjitha urt e butë,
dërgimi i tij larg dhe i papritur duhet të duket,
se është përfunduar që më parë;
kur gjëndja e sëmundjes
është e dëshpëruar, me ilaç të dëshpëruar shërohet,
ose s'shërohet fare. *(Hyn Rosenkranci)*
Thuaj! E gjete?
Rosenkranci – Se ku e ka fshehur trupin, imzot,
nuk do të na thotë.
Klaudi– Po ay vetë ku është?
Rosenkranci – Përjashta, imzot; e ruajnë dhe presin
urdhrin tuaj.
Klaudi– Silleni këtu.
Rosenkranci
– Ej, Guildenstern! Sille brënda imzotin.
(Hyjnë Hamleti dhe Guildensterni)
Klaudi– Pra, Hamlet, ku është Polloni?
Hamleti– Për darkë.
Klaudi– Për darkë? Ku?
Hamleti– Jo ku ay ha, po ku atë e hanë;
një farë kuvëndi prej krimbash politikanë
posa i janë hedhur përsipër; krimbi është i vetëmi

perandor për të ngrënë; ne ngjallim tërë shtazat,
që të ngjallim veten tonë, dhe ngjallim veten tonë
për krimbat; mbreti i majmë dhe lipësi i thatë
janë vetëm gjellra të ndryshme – dy pjata gjellë
të ndryshme, në të njëjtën tryezë; ku është fundi.
Klaudi– Bobo, bobo!
Hamleti– Një njeri mund të peshkjë me një krimb,
që ka ngrënë prej një mbreti, dhe të hajë
prej peshkut që është ushqyer prej atij krimbi.
Klaudi– Ç'do të thuash me këtë?
Hamleti– Asgjë, vetëm të dëftej se si një mbret
mund të udhëtojë nëpër zorrët e një lipsari.
Klaudi– Ku është Polloni?
Hamleti
– Në qiej; dërgo atje të shikosh; lajmëtari yt,
po të mos e gjejë, kërkohe te vëndi tjetër i vogël
Por me të vërtet,
po të mos e gjesh brënda këtij muaji,
do t'i mirrni erë siç po ngjitni shkallët te salla.
Klaudi– Shkoni e kërkoni atje!
(U thotë disa shoqëronjësve)
Hamleti– Do t'ju presë gjersa të veni.
(Shoqëronjësit dalin)
Klaudi – Hamlet, për këtë vepër,
veçanërisht për sigurimin tënd,
të cilin e dëshërojmë,
ndërsa thellësisht hidhërohemi,
për atë që ke bërë, duhet të ngrejmë që këtej
me shpejtësi të zjarrtë; prandaj pregatitu,
anija është gati, dhe era është pupa,
shokët presin dhe çdo gjë u vendos për në Angli.
Hamleti– Për në Angli?
Klaudi– Po, Hamlet!
Hamleti– Mirë.

Klaudi– Ti flet, sikur e di qëllimet tona.
Hamleti– Shikoj një ëngjëll që i sheh. Po, eja;
për në Angli! Rri me shëndet, e dashur nënë.
Klaudi– Por babanë tënd që të do, Hamlet?
Hamleti
– Nëna ime; at dhe nënë janë burrë dhe grua;
burrë dhe grua janë një trup, prandaj nëna ime.
(I thotë rojes së tij) Eja, për në Angli! *(Shkojnë)*
Klaudi– *(U thotë Rosenkrancit dhe Guildensternit)*
Ndiqeni këmba këmbës; kandiseni
të hyjë menjëherë në anije;
mos u vononi; dua të mos jetë këtu sonte;
shkoni; Të gjitha janë vulosur dhe çdo gjë
që i përket kësaj çështjeje është gati;
ju lutem nxitohuni.
(Dalin të gjithë përveç Klaudit)
Dhe ti Angli, në se s'përfill miqësinë time, -
ahere fuqia ime do të bëjë ty ta ndjesh,
me që plaga jote është edhe e pambyllur dhe e kuqe
nga shpata daneze, dhe frika me vullnet të lirë
na paguan haraç, mos e përçmo
mandatin tonë sovran,
i cili të njofton në mënyrë të prerë,
dhe me letra përkatëse dhe të qarta,
vdekjen e menjëhershme të Hamletit. Bëhe, Angli;
se si ethet ma tërbon gjakun tim,
dhe t'i duhet të mëshërosh;
gjersa të mësoj se u mbarua,
sado që të jenë shpresat e mia,
gëzime s'do të ketë për mua.

Skena e katërt

Një fushë afër Elsinorit

Hyn princi Fortinbras me ushtrinë e tij duke marshuar.

Fortinbrasi– Shko, kapiten, përshëndet nga unë
mbretin danez; thuaji që, me lejen e tij, Fortinbrasi
kërkon prijtarë përmes mbretërisë tij ta drejtojnë,
siç na u premtua. Ti e di takimin.
Në dashtë madhëria e tij gjësendi prej nesh,
do t'i çfaqim nderin tonë përsonalisht,
dhe do të mirremi vesh.
Kapiteni – Po, Imzot. *(Kthehet në një udhë)*
Fortinbrasi– *(I thotë ushtrisë)* Përpara, ngadale.
(Fortinbrasi dhe ushtria shkojnë përpara në një udhë tjetër)
Kapiteni takon Hamletin, Rosenkrancin,
Guildensternin dhe rojet,
të cilët po venë në liman.
Hamleti– I mirë, zot e kujt është kjo ushtri?
Kapiteni – Është e Norvegjisë, zotëri.
Hamleti– Dhe për ku është nisur, të lutem?
Kapiteni – Kundër një pjese të Pollonisë.
Hamleti– Cili është komandanti i tyre, zotëri?
Kapiteni
– I nipi i mbretit plak të Norvegjiesë, Fortinbrasi.
Hamleti– Shkon kundër Pollonisë kryesore, zotëri,
apo ndonjë kufiri të saj?
Kapiteni – Që të them të vërtetën dhe pa e shtuar,
ne vemë të fitojmë një copë të vogël,
që s'ka asnjë fitim përveç se emërit.
Unë nuk jap pesë dukata, pesë ta marr me qera,

as norvegjezi, as pollonezi do të nxjerrë
shumë më të madhe
sikur ta shesin me sundim të përhershëm.
Hamleti
– Po ahere pollonezi nuk do ta mbrojë kurrë.
Kapiteni – Po; ata posa kanë vendosur atje ushtarë.
Hamleti– Dy mijë shpirt dhe njëzet mijë dukata
s'do ta zgjidhin çështjen e grindjes të një fije kashte!
Kjo është lunga e pasurisë së madhe dhe e rehatit,
që pëlcet përbrenda dhe s'deften shkak përjashta
pse njeriu vdes.
– Të falnderoj me përulje, zotëri
Kapiteni – Perëndia le të jetë me ty, zotëri.
(Kapiteni shkon)
Rosenkranci – A dëshëroni të shkojmë, imzot?
Hamleti
– Do t'ju arrij menjëherë. Shkoni pak më parë.
(Rosenkranci, Guildensterni
dhe të tjerët vazhdojnë udhën)
Se si të gjitha rastet flasin kundër meje,
dhe çpojnë hakmarrjen time të msheftë!
Ç'është një njeri,
nëse dëshira e tij kryesore dhe vlugu i jetës së tij
jane veçse të ngrënët dhe gjumi?
Një shtazë, asgjë tjetër.
Sigurisht ay që na bëri
me fuqi të tillë mendore të gjerë,
që të rishikojë të kaluarën
dhe të parashikojë të ardhmen,
nuk e dha këtë aftësi dhe si arsye hyjnore
të myket e papërdorur. Tani në se është kjo
harrim shtazor, ose ndonjë dyshim frikacak
prej të menduarit e shumë përmbi pasojat, -
një mendim, të cilin po ta ndash në katër,

ka vetëm një pjesë urtësi,
dhe tri të tjerat frikacake, - nuk e di
pse edhe vazhdoj të them: “Këtë duhet ta bëj”, -
kur unë kam shkak,
dhe vullnet, dhe fuqi, dhe mjete, që ta bëj.
Shëmblla të mëdha sa dheu vetë më shtyjnë;
shiko këtë ushtri të madhe dhe hijerëndë,
kryesuar prej një princi të dashur dhe të ri;
shpirt’ i të cilit mbushur me ambicje hyjnore,
u shtrëmbëron buzët ngjarjeve të padukshme;
ekspozon ç’është e vdekshme dhe e pasigurtë,
para së gjithash, që fatit, vdekjes dhe rrezikut,
guxojnë t’i bëjnë ballë
edhe për një guaskë veze.
Të jesh i madh me të vërtet,
nuk është kur nxehesh pa patur shkak të madh,
po të ziesh me madhëri edhe për një fije kashte,
kur nderi është në rrezik. Ç’pres unë ahere,
që atin tim ma vranë dhe nënën ma njolluan,
vepra, që të më ndezin arësyen time dhe gjakun,
dhe i le të gjitha të flenë!
Ndërsa për turpin tim shikoj
vdekjen që u kanoset njëzet mijë burrave,
që për një fantazi dhe kotësinë e famës,
venë në varret e tyre si në shtrat; lëftojnë
për një truall,
i cili nuk i nxë të gjithë pjesëmarrësit,
dhe për varr s’është i gjerë mjaft t’i mbulojë
të tërë të vrarët.
O, tani e tutje mendimet e mia
të jenë gjakatare, ose nuk do të jenë të denja fare.
(Shkon pas të tjerëve)
(Kalojnë disa javë)

Skena e pestë

Elsinor. Një dhomë në kështjellë,
Hyjnë Gertruda, Horati dhe një zotëri.

Gertruda – Nuk dua të flas me të.
Zotëria
– Ajo ngul këmbë; në të vërtetë s'është në vete.
Gjëndja e saj meriton mëshirë.
Gertruda – Po çdo ajo?
Zotëria– Flet gjithë për tanë; bota thotë
ka dinakërira; rënkon dhe rreh krahërorin;
u bie me çmirë kashtrave; thotë gjëra të dyshimta,
që kanë vetëm gjysmë kuptimi.
Të thënat e saj s'janë asgjë,
prapëseprap përdorimi i tyre pa rregull i shtyn
dëgjonjësit të mendohen; ata atë synojnë,
dhe i qepin fjalët e ngatërruara
sipas mendimeve të tyre,
si të bërët e saj me sy, me nojma, dhe me shënja,
në të vërtetë mund të bëjë ndonjë të mendohet
se do të kenë kuptim,
ndonëse s'janë të sakta, megjithëkëtë shumë të
dëmshme.
Horati – Do të bëni mirë të flisni me të,
se mund të përhapë dyshim të rrezikshëm
në mëndje që përftojnë të keqe.
Gertruda – Le të vijë brënda. (*Del zotëriu)*
(Mënjanë) Shpirtit tim të sëmurë,
siç është natyra e vërtetë e gjynave,
çdo përfytyrim i duket parathënje
e ndonjë të keqe të madhe.

Fajësai mbushur me dyshim të papërmbajtur
tmerret, derdh veten e saj, nga frika se mos derdhet.
(Hyn përsëri zotëriu me Ofelinë)
Ofelia – Ku është madhëria e bukur e Danimarkës?
Gertruda – Ç'do Ofeli?
Ofelia – *(Këndon)*
Si ta njihja dashurinë tënde të vërtetë,
nga një tjetër dashuri?
Prej takijes si kërmilli dhe stapit,
dhe nga sanadalet e tij.
Gertruda
– Bobo, vajz'e ëmbël! Ç'kuptim ka kjo këngë?
Ofelia – Si the? Jo të lutem, dëgjo! *(Këndon)*
Ay vdiq dhe shkoi, zonjë,
ay vdiq dhe e vunë në qivur,
në kokën e tij një plis të mblerë,
në thëmbrat e tij një gur. O, oh!
Gertruda – Jo, Ofeli, -
Ofelia – Të lutem, dëgjomë. *(Këndon)*
Të bardhë si dëborë kish savanin. *(Hyn Klaudi)*
Gertruda – Bobo, vështroje, imzot!
Ofelia – *(Këndon)*
me lule zbukuruar,
njerzit s'ju ndodhë pranë të qanin,
me mall për ta vajtuar.
Klaudi– Si je zonjushe e bukur?
Ofelia – Mirë, perëndia jua shpërbleftë? Thonë se
kukumjaçka ishte e bija e furxhiut.[25]
O zot, ne dimë se ç'jemi, po nuk dimë se çdo të
bëhemi... Zoti të bekoftë tryezën tënde!
Klaudi– *(Mënjanë)* S'i del nga mëndja i jati.
Ofelia – Ju lutem mos e bëni fjalë këtë; por
kur t'ju pyesin se ç'kuptim ka, ju thoni kështu.
(Këndon)

Nesër është dit'e shën Valentinit,
menatë tërë ngrihen.
Dhe un që të bëhem dashnorja jote,
te dritarja jote gdhihem.[26]

Ahere u ngrit i riu dhe u vesh,
derën e dhomës i çel,
vajza hyn brënda,
dhe jashtë më nuk del.
Klaudi– Ofeli e bukur!
Ofelia – Me të vërtetë, ja, pa u betuar, do t'i jap fund.
(Këndon)
Për zotin Krisht dhe mëshirën e tij,
bubu ata, për turp janë,
do ta bëjnë po ta gjejnë djemt e rij
fajin ata e kanë.
Ajo i thotë: para se të më shtrije,
më premtove martesë.
I përgjigjet ay: ti poshtë po të mos rrije,
do të të kisha marrë për besë.
Klaudi- Sa kohë ka që është kështu?
Ofelia – Shpresoj, të gjitha do ndreqen.
Duhet të bëjmë durim;
po unë s'mund të bëj tjetër, veçse të qaj,
kur mendoj që e shtrinë në dheun e ftohtë.
Im vëlla do ta mësojë, dhe kështu ju falemnderit
për këshillat tuaja të mira. Eja, karrocën time!
Natën e mirë, zonja; natën e mirë, zonja t'ëmbla;
natën e mirë, natën e mirë. *(Del)*
Klaudi– Bjeri pas; dhe të lutem kije kujdes mirë.
(Horati me zotërinë dalin)
Ky është lemi i hidhërimit të thellë; dhe të gjitha
u shkakëtuan nga vdekja e të jatit të saj.
Dhe tani vështro!

O Gertrudë, Gertrudë, -
kur hidhërimet vinë, s'vinë si ushtarë në një radhë,
po në batalione!
Sefte vritet i jati, pastaj ikja e tyt biri;
i cili me ashpërsinë e vet u bë shkaktar
për dëbimin e drejtë të vetvetes së tij; turmat të ngatërruara,
zjejnë dhe pështërisin mendime të këqia
për vdekjen e Pollonit të mirë; dhe ne vepruam
si të papjekur,
që fët dhe fshehurazi e varrosëm; e mjera Ofeli,
u nda nga vetja e saj dhe nga arësyeja e saj e mirë,
pa të cilën ne jemi piktura, ose fare kafshë;
dhe jo më pak për t'u ç'qetësuar është dhe kjo,
i vëllai ka ardhur fshehurazi nga Franca;
ushqehet me dyshimet e tij; është si në mjegull,
dhe s'i mungojnë pështëritjet për t'i infektuar veshët
me fjalë të helmuara për vdekjen e t'et të tij;
dhe meqënë se të gjtha janë t'errta, ato kalojnë
nga vesh më vesh, për të na e hedhur neve fajnë.
O Gertruda ime e shtrënjtë, kjo, si një mortajë
më shkakton vdekjen më tepër se një herë.
(Dëgjohet zhurmë përjashta)
Gertruda – Bobo, ç'është kjo zhurmë?
Klaudi– Ku janë rojet? Le të ruajnë derën. –
(Hyn një zotëri) Ç'është shkaku?
Zotëria – Shpëto veten tënde, imzot;
kur oqeani ngrihet dhe përmbyt kufit' e tij,
s'e rreh fushën me vrull më të rrëmbyer,
se sa Laerti i ri, me turma të armatosura
i shtyp oficerët e tu. Turma e quan mbret;
sikur lashtësia u harrua, dhe traditat nuk njihen,
që janë miratimet dhe shtyllat e mirëqenies
të çdo qeverie,

dhe sikur bota tani posa fillon
thërresin – duam Laertin mbret!
Kësula, duar dhe gjuhë e duartrokitin gjer në ret,
Laerti të bëhet mbret! Rroftë Laerti mbret!
Gertruda – Sa të gëzuar mbi vazhdën e rremë lejnë!
O, e kini gabim, ju qënër të pabesë danezë!
(Zhurmë brënda)
Klaudi– I thyen dyert.
(Hy Laerti i armatosur; danezë e ndjekin pas.)
Laerti
– Ku është ky mbret? – Zotërinj qëndroni përjashta.
Danezët – Jo, lerna të vimë brënda.
Laerti – Ju lutem, me lejen tuaj.
Danezi – Mirë, mirë! *(Dalin përjashta)*
Laerti – Ju falemnderit. – Aty ruani derën. – O mbret i poshtër,
ném tim atë!
Gertruda – Qetësohu, Laert i mirë.
Laerti:
-Ajo pika e gjakut tim që është e çetë, më quan doç;
dhe thërret brinoç tim atë; damkos kurvë
mu këtu, në mes të vetullave të thjeshta
dhe të panjolla të të ndershmes nënës time.
Klaudi– Ç'është shkaku, Laert,
që ke ngritur krye si ndonjë gjigant?
le të vijë Gertrudë; mos ki frikë për veten tonë;
fuqi hyjnore e rrethon si gardh mbretin
dhe tradhtia mund vetëm të shikojë atë,
që do të bëjë,
po s'guxon ta kryejë. – Thuam, Laert,
pse je inatosur kështu? – Lere, Gertrudë. –
Folë, burrë.
Laerti – Ku është im atë?
Klaudi– Vdiq.

Gertruda – Po jo prej këtij!
Klaudi– Lere të pyesjë sa të dojë.
Laerti – Po si vdiq? Dredhi në mua s'shkojnë.
Betë e besës së dhënë te djalli m'i zi të venë.
Dhe ndërgjegjja dhe hiri në ferrin më të thellë!
Guxoj t'i bëj ballë dënimit të përshtatshëm –
gjer atje kam arrirë; që këtë botë
dhe tjetrën s'i përfill fare,
le të ngjasë ç'të dojë; vetëm të marr hakën
gjer në fund për tim atë.
Klaudi– Dhe kush do të të mbajë?
Laerti – Vullneti im dhe asnjë njeri tjetër,
dhe mjetet e mia do t'i drejtoj aq mirë,
që me pak të arrij qëllimin tim.
Klaudi– Laert i mirë,
nëse t'i dëshëron të dish të vërtetën
e vdekjes të babait tënd të shtrënjtë,
- a është kjo shkruar në hakmarrjen tënde,
që të ç'frysh tërmeqen tënde mbi mik dhe armik,
fitimtar dhe të humbur; kështu do t'i marrç
të gjithë zvarrë?
Laerti – Asnjë tjetër, vetëm armiqtë e tij.
Klaudi– A do t'i dish ata ahere?
Laerti
-Miqve të tij të mirë kështu do t'u hap krahët e mi,
dhe si pelikani i dhëmshur jetëdhënës,
do t'i ushqej me gjakun tim.
Klaudi– Po, tani flet.
Si bir i mirë, dhe fisnik i vërtetë.
që unë jam i pafajshëm për vdekjen e tyt' eti,
dhe që jam hidhëruar nga zëmra për të,
ajo do të bëhet e qartë në gjykimin tënd,
ashtu si dita në sytë e tu.
Danezi – *(Që brënda)* Lereni të hyjë brënda.

Laerti – Ç'është kjo! Ç'është kjo zhurmë?
Hyn Ofelia përsëri, veshur me kashtra dhe me lule,
në mënyrë për t'u çuditur.
O nxehtësi, thaje trurin tim!
Lot shtatë herë të kripur,
digjeni ndjenjën dhe fuqinë e syve të mi.
Për perëndi, marrëzia jote do të paguhet me peshë,
gjersa kandari të anojë nga ne. O trëndafil i majit!
E shtrënjtë vajzë, motër e dhëmshur, Ofeli e ëmbël! -
O qiej, a ësht' e mundshme
që mëndja e një çupe të re
të jetë aq e vdekshme as jeta e një plaku?
Natyra njerëzore është bujare në dashuri,
dhe kur ajo shkëlqen,
çon pjesë të çmuara të vetes së saj
pas gjësë që dashuron.
Ofelia – *(Këndon)*
Në tezgere dhe fytyr – zbuluar e shpunë;
o e mjera, unë e mjera!
Dhe mbi varrin e tij lot u derdhën lumë.
Udhën e mbarë pëllumbi im!
Laerti – Po t'i kishe mëndtë dhe të më shtyje për hakmarrje, nuk do të mallëngjeje kaqë.
Ofelia – Ju duhet të këndoni:
Poshtë, poshtë! Vëreni poshtë!
Sa bukur që i vete refreni.
Është sejmeni i pabesë,
që vodhi çupën e të zotit të tij.
Laerti– Kjo asgjë është më tepër se lëndë.
Ofelia – *(I thotë Laertit)*
Ja, këtu është rozmarina, kjo është për kujtim;
të lutem dashuri kujtohu; dhe këtu janë vjollcat,
këto janë për mendim.

Laerti– Një mësim në marrëzi; mendime dhe kujtime
që i përshtaten njëra tjetrës.
Ofelia – *(I thotë Klaudit)*
Këtë maraz për ty dhe lulet e sahatit;
(I thotë Gertrudës)
dhe këto ryza për ty; ja dhe ca për mua,
këtë mund ta quajmë bar të hirit hyjnor! –
O, ti duhet të mbash ryzën ndryshe nga unë.
Ja dhe një luleshqerrre; do të të jepja ca manushaqe,
po u fishkën të tërë kur vdiq im atë;
- thoën se ay pati fund të mirë.
(Këndon) Sepse i dashuri Gushkuqi im i ëmbël,
Është i vetëmi gëzimi im.
Laerti– Melankolinë dhe dhëmbjen, vuajtjen dhe vetë ferrin, ajo i kthen në hir dhe bukuri.
Ofelia – *(Këndon)*

Dhe nuk do të kthehet më?
Dhe nuk do të kthehet më?
Jo, jo ay vdiq tani.
Vajti në shtratin e tij,
kurrë s'do të kthehet më!
Të bardhë si bora kish mjekrën ai,
flokët i kishte si li,
ay shkoi, ay shkoi,
dhe ne po rënkojm,
perëndi ki mëshirë për shpirtin e tij!
Dhe për të gjithë shpirtrat e të krishterëve,
i lutem perëndisë. Perëndia të jetë me ju.

(Del duke lojtur valle e çakërdisur)
Laerti– E shikon këtë, o perëndi?
Klaudi: Laert, unë duhet të bashkohen me hidhërimin tënd, apo më mohon të drejtën. Shko vetëm filli, zgjidh më të urtët e miqve tënd që dëshëron, dhe ata do dëgjojnë dhe do gjykojnë midis

teje dhe mua. Nëse drejt për derjt ose tërthorazi e
gjejmë se jemi përzjerë,
do të japim mbretërinë tonë,
kurorën tonë, jetën tonë dhe të gjitha ç'kemi,
si shpërblim; po në mos qoftë kështu,
ki mirësinë të na huash durimin tënd,
dhe ne do të punojmë sëbashku me shpirtin tënd,
t'i japim hakën që i meriton.
Laerti– Kështu qoftë; po në mënyrën e vdekjes së tij,
varrimin e tij të fshehtë,
pa trofe, shpatë, pa stema mbi kufomën e tij,
pa rit bujar, pa paradë nderi,
bërtasin që nga qielli e gjer mbi;
për këto unë duhet të kërkoj shpagim.
Klaudi – Patjetër ta bësh;
dhe atje ku faji është, lëshohe shpatën e madhe të
bjerë. Të lutem, eja me ne. *(Dalin)*

Skena e gjashtë

Një dhomë tjetër në kështjellë.
Hyn Horati dhe një shërbëtor.

Horati – Cilët janë ata që duan të flasin me mua?
Shërbëtori
– Marinarë, zotëri; thonë se kanë letra për ty.
Horati – Lëri të vinë brënda. *(Shërbëtori del)*
Nuk e di se nga ç'vënd në botë mund të më
përshëndesin, në mos nga imzot Hamleti.
(Hyn shërbëtori me marianrët)
Marceli I – Perëndia të bekoftë, zotëri.
Horati – Të bekoftë dhe ty
Marceli I – Kjo, zotëri varet nga dëshira e tij,
Po këtu kam një letër për ty, zotëri,
të vjen nga ambasadori që udhëtonte
për në Angli, nëse është emri yt Horat,
siç më kanë thënë që është.
Horati – *(Kthehet mënjanë dhe lexon)* "Horat, me të lexuar këë letër, gjej ndonjë mënyrë që këta njerës të paraqiten tek mbreti; ata kanë letra për të…
Para se të kishin kaluar dy ditë në det, një anije piratësh, e armatosur rëndë, na ra pas. Me të parë që velat tona shkonin përpara me shumë mengadalë, ne e detyruam të dëftejmë trimërinë tonë; në përleshjen unë u hodha në anijen e tyre; në atë çast ata u tërhoqën nga anija jonë. Dhe në këtë mënyrë vetëm unë e bëra rob i tyre. Ata më kanë trajtuar si kusarë të mëshirshëm; po dinin se ç'bënin; tani duhet t'u bëj dhe unë një shërbim të mirë atyre. Kujdesu t'i marrë mbreti letrat që i kam dërguar; dhe eja të më takosh me aqë shumë ngutësi, sikur do të të ndiqte vdekja. Kam fjalë për të të thënë vetëm në veshët

tënd, që do të të bëjnë të mbetesh me gojëhapur,
megjithatë ato janë shumë të dobëta për të shprehur
rëndësinë e madhe të çështjes. Këta shokët e mirë do
të të sjellin këtu ku jam unë. Rosenkranci dhe
Guildensterni vazhdojnë lundrimin për në Angli; Për
ata kam shumë për të të thënë. Qofsh me shëndet.
Ay që ti e njeh tëndin,

Hamleti

Ejani t'ju shpie t'i jepni letrat;
dhe bëheni këtë për së shpejti, që të më shpini
tek ay nga i cili i suallt. *(Dalin)*

Skena e shtatë

Një dhomë tjetër në kështjellë.
Hyjnë Klaudi dhe Laerti.

Klaudi
-Tani ndërgjegjja jote duhet të vulosë çfajësinë time.
Dhe duhet të më vësh në zëmrën tënde për mik,
Mbasi dëgjove dhe e more vesh,
që ay, i cili vrau atin tënd bujar,
donte të më merrte edhe mua jetën.
Laerti– Kjo duhet sheshit; po thuam,
Pse s'muarrt ndonjë masë,
kundër asaj vepre të keqe,
aqë gjakatare dhe aqë e madhe nga natyra e saj,
me që të shtynin dhe sigurimi yt,
urtia jote, madhëria jote,
dhe të gjitha. Dhe s'u trondite aspak?
Klaudi – O, për dy arësye të veçanta,
të cilat ty ndofta të duken të parëndësishme,
po megjithkëtë për mua kanë rëndësi të madhe.
Mbretëresha e ema e tij rron pothuajse me syt' e tij;
dhe unë për veten time,
-virtuti im, ose fatkeqësia ime, cilidoqoftë, -
ajo është aqë ngushtë
lidhur me jetën dhe shpirtin tim,
që si yll, i cili s'lëviz veçse në tragën e tij,
dhe unë s'mund veçse të sillem rreth saj.
Shkaku tjetër,
që pse unë s'mund ta gjykoja atë botërisht,
është dashuria e madhe që populli ka për të;
të cilët zhytin tërë fajet e tij në dashurin' e tyre,
dhe si burimi që kthen drurin në gur,
do kthejnë prangat e tij në hire.

Kështu që shigjetat time,
të bëra prej druri shumë të lehtë,
për erë aqë të fortë,
do të ktheheshin në harkun tim përsëri,
dhe jo atje ku unë i kisha drejtuar.
Laerti
-Dhe kështu unë kam humbur një baba bujar;
një motër shtyrë në kushte dëshpërimi,
vlerat e së cilës, në mund ta lëvdoj ç'ka qënë,
po tani s'gjendet më,
nuk kishte shoqe në tërë botën
nga përsosmëria e saj. Por do t'ia marr hakën.
Klaudi – Mos e humb gjumin tënd për të;
ti s'duhet ta pëndehsh,
se ne jemi bërë prej lënde
aqë të pahijshme dhe të mefshtë,
që mund të lemë mjekrën tonë të dridhet në rrezik
dhe ta pandejmë zbavitje.
Ti shpejt do dëgjosh dhe të tjera;
unë e doja tët'atë dhe dua edhe veten time;
dhe kjo, shpresoj, do të të mësojë
ty ta marrç me mënd –
(Hyn një lajmëtar me letra)
Ç'kemi tani! Ç'janë të rejat?
Lajmëtari – Letra, imzot, nga Hamleti:
kjo për madhërinë tuaj; kjo për mbretëreshën.
Klaudi – Nga Hamleti? Kush i solli?
Lajmëtari
– Disa marinarë, imzot, thonë; unë si pashë;
mua m'i dhe Klaudi , - ay i mori nga ay që i solli.
Klaudi – Laert, do t'i lexojmë. – Lerna. *(Lajmëtari del) (Lexon) "Lartmadhëri, mëso se më zbritën nga anija dhe jam pa mbrojtje në mbretërinë tënde. Nesër do të të lyp lejën të të shoh sytë e tu mbretërore; ahere,*

sefte do të të kërkoj ndjesën tënde, pastaj do të të tregoj përipetitë e kthimit tim aqë të çuditur.”

Hamleti

Ç’është kjo? U ktye të gjithë të tjerët?
Apo mos është ndonjë mashtrim,
dhe asgjë s’ka ngjarë?
Laerti– E njeh shkrimin e tij?
Klaudi – Është shkrimi i Hamletit. “Lakuriq”, -
Dhe këtu më poshtë shton: “Vetëm!”
A mund të ma shpjegosh?
Laerti– Dhe unë s’e marr vesh, imzot, po le të vijë;
më ngroh të njëjtën sëmundje në zëmrën time,
që do të rroj dhe do t’i them në turinjt’ e tij:
“Këtë e bërë ti!’
Klaudi – Në qoftë kështu, Laert, -
dhe si mund të jetë kështu? Dhe qysh ndryshe?
Ahere do t’i të udhëhiqesh prej meje?
Laerti– Po, i mirë imzot,
por me kusht që të mos më shtysh të pajtohem.
Klaudi – Për qetësinë tënde. Nëse ay kthehet përsëri
dhe heq dorë nga udhëtimi i tij dhe s’ka ndërmend
ta ndërmarrë më, ahere do ta nxit atë të kryejë diçka
që është arrirë tanimë në mëndjen time,
dhe prej së cilës ay s’ka si të shpëtojë;
dhe për vdekjen e tij as erë akuze nuk do fryjë,
por edhe e ema e tij do ta çfajësojë tradhëtinë
dhe do ta quajë ngjarje të rastit.
Laerti– Imzot, e pranoj të më udhëheqësh;
dhe veçanërisht po të mundsh të veprosh ashtu,
që unë të jem vegla.
Klaudi – Kjo pajtohet me planin tim.
Ndërsa ti ishe në mërgim u bënë shumë fjalë për ty,
dhe Hamleti i dëgjonte vetëm për një aftësi,
kur ata thoshin se ti shkëlqen; shuma

e cilësive tënde të tjera,
të gjitha së bashku s'i shkakëtuan zili t'atillë,
siç bëri ajo vetëm, dhe ajo është mendoj unë
e një shkalle nga më të parëndësishmet.
Laerti– Ç'aftësi është ajo, imzot?
Klaudi – Një shirit i thjeshtë në shapkën e rinisë;
prapseprapë shum'i nevojshëm;
se të riut ato i kanë hie, uniformat e lehta dhe të
çkujdesura që ay vesh, sikundër mosha e shkuar ka
gëzofet dhe rrobat e saj, që u dallojnë shëndetin dhe
rëndësinë; dy muaj më parë,
këtu ish një fisnik nga Normandia, -
të cilin e pashë me syt' e mi, dhe unë kam lëftuar
kundër frëngjve,
ata janë kalorës të zotë, po ky kreshniku
ish magjistar i vërtetë; që rritur përmbi shalën;
dhe gjëra të tilla të çuditshme bëri me kalin e tij,
që sikur ish një trup dhe krijuar bashkë
me kafshën trime. Aqë më tejkaloi përfytyrimin tim,
nga ato që dija për lodrat dhe hiletë,
sa që mbeta me gojëhapur.
Laerti– Normandez ishte?
Klaudi – Normandez.
Laerti– Për jetën time, Lamondi.
Klaudi – Dora vetë.
Laerti– E njoh mirë, ay është me të vërtetë Marceli
dhe xhevairi i tërë kombit.
Klaudi – Ay na foli për ty, -
dhe dha një përshkrim të tillë të përsosur,
për artin dhe ushtrimet e mbrojtjes tënde
dhe theksoi për shpatën veçanërisht,
ay shpalli me bujë, se me të vërtetë do të qe çudi,
në u gjentë ndonjë të ndeshet me ty;
skermësit e kombit të tij, u betua ay,

s'kishin as lëvizjet, as mbrojtjen, as sytë,
po t'i dilje ti përpara.
Zotëri, ky përshkrim i tij
aqë e helmoi dhe i ngjalli omir Hamletit,
saqë s'mund të bënte asgjë,
veç dëshëronte dhe lutej
për ardhjen tënde të menjëhershme,
që të ndeshej me ty.
Tani, përveç kësaj. –
Laerti– Çfarë përveç kësaj, imzot?
Klaudi – Laert, ti e doje tët'atë?
Apo je si piktura e një hidhërimi,
një fytyrë pa zëmër?
Laerti– Pse më bën këtë pyetje?
Klaudi – Jo se unë mendoj se ti s'e doje tët'atë;
po e di që dashuria fillohet prej kohës dhe këtë e
shoh nga përvoja e marrëdhënieve të përditshme,
koha përcakton shkëndijën dhe zjarrin e saj.
Se në vetë flakën e dashurisë rron brënda
një lloj fitili ose shkrumb që do ta topitin;
dhe asgjë s'ka të njëjtën mirësi gjithnjë,
se mirësia kur rritet tepër,
vdes nga të shumët e saj; dhe atë që duam të bëjmë,
duhet ta bëjmë kur duam të bëjmë; se kjo duam
ndrron, dhe ka topitje dhe vonime aqë shumë,
sa janë gjuhë, sa janë duar, sa janë ngjarje, -
dhe ahere kjo duhej është si një psherëtimë
shkapërdare, që dhëmb kur e nxjerrim; po le të
kthehemi në plagën tonë:
Hamleti u kthye prapë; - çfarë do të bësh ti,
që të dëftehesh bir i tyt'eti më tepër në vepra,
se sa në fjalë?
Laerti– T'i pres gabzherrin brënda në kishë.

Klaudi – Asnjë vënd, në të vërtetë, s'duhet të strehojë vrasësin, hakmarrja të mos ketë kufi.
Po, Laert i mirë, ti do të bësh këtë:
rri mbyllur në dhomën tënde,
Hamleti me t'u kthyer do të marrë vesh që ti ke ardhur, ne do të vëmë të tjerë të të lëvdojnë shkëlqesinë tënde,
dhe të të japin një vernik të dyfishtë përmbi famën që të dha francezi; më në fund do t'ju takoj,
dhe do vë bast mbi kokët tuaja; ay, meqë është i shkujdesur, shpirtmadh, dhe i padjallëzuar,
s'do t'i kontrollojë shpatat; ashtu që me kollaj,
ose duke i përzjerë ato një çikë,
ti mund të zgjedhç një shpatë më të mprehtë, dhe me një goditje tradhtare, merr hakën për tët'atë.
Laerti– Do ta bëj; dhe për këtë qëllim do të lyej shpatën time. Kam bler një mehlem nga një sharllatan, aq vdekjeprurës, as vetëm ta zhytç një thikë në të, ku ajo nxjerr gjak s'gjendet kataplazmë aq e rrallë, mbledhur nga të gjitha barërat që kanë fuqi nën hënën, që mund ta shpëtojë aë nga vdekja. Veç të gërvishtet me të.
Do të lyej majën e shpatës me këtë helm, që edhe një çikë po ta çkërfitjë do të vdesë.
Klaudi – Le të mendohemi më gjatë për këtë; duke peshuar volinë e kohës dhe të mjeteve, që mund të pajtohen me planin tonë.
Po të dështojnë kjo, dhe komploti ynë del në shesh nga zbatimi ynë i keq, do të jetë më mirë të mos matemi fare. Prandaj ky plan duhet të ketë prapa tij një të dytë, si përforcim, në dështoftë i pari. Po dale të mendohem pak! –Unë do të vë një bast të madh për aftësitë tuaja, -e gjeta:
Kur ju në sulmet tuaj, të nxehur dhe të etuar, -

siç do të përpiqesh ti me zjarr për këtë qëllim, -
dhe ay do të kërkojë të pijë, - ahere unë do t'i jap
një gotë të përgatitur për këtë rast të veçantë;
prej së cilës veç të gjerbjë dhe në se ay rastësisht
shpëton nga shpimi i helmuar qëllimi ynë do të
realizohet. Po dale, ç'është kjo zhurmë?
(Hyn Gertruda) Ç'është, mbretëresha ime e ëmbël?
Gertruda: Një pikëllim shkel mbi thëmbrat e një
tjetri, aqë me nxitim ata vinë.
Laert, jot motër u mbyt.
Laerti– U mbyt! O, ku?
Gertruda: Atje tej është një shelk i varur në përrua,
që dëften fletët e tij të murrme në rrymën e qelqtë; -
atje vajti me kurorë të çuditshme, me zhabina,
hithra, luleshqerre dhe orkide, që çobanët cipëplasur
u thonë emër më të rëndë, po vajzat tona të ftohta i
quajnë gishtrinjt' e të vdekurit;
atje mbi degët e varura sikundër ngjitej, kurorët e saj
prej bari të varte, një degë ziliqare u thye;
kur kurorët e saj ranë, ra dhe ajo vetë
në përruan qarës. Rrobat e saj u hapnë gjerë,
dhe si nimfë, ndërsa e mbajtnë përmbi ujët,
këndonte copra nga këngë të vjetra,
sikur nuk e ndjente rrezikun e vetes së saj,
ose si një krijesë e lindur dhe e pajisur
me cilësitë e duhura për të jetuar në ujë!
Po gjatë ashtu s'mund të qëndronte,
gjersa rrobat iu rënduan nga ujët që pinë,
dhe e tërhoqnë zonjushen e mjerë nga shtrirja
dhe këngët e saj melodike, në vdekje të baltët.
Laerti– Bobo, ajo ahere u mbyt?
Gertruda – U mbyt, u mbyt!
Laerti– Ke shumë ujë, e mjerë Ofeli, dhe prandaj
nuk do të derdh lot; po prapseprapë kjo është

mënyra jonë; natyra ruan zakonin e saj, lere trupin
të thotë ç'të dojë; kur lotët të kullojnë, dobësia ime
prej gruaje do mbarojë. – Rri me shëndet, imzot!
Kam fjalë të zjarrta që duan të nxjerrin flakë,
mirëpo kjo marrëzia i shuan. *(Del)*
Klaudi – Eja t'i biem pas, Gertrudë;
sa përpjekje që bëra për t'i qetësuar tërbimin!
Po tani kam frikë se nga kjo do të nisjë përsëri;
prandaj eja t'i biem pas. *(Dalin)*

AKTI I PESTË

Skena e parë

Në varret. Hyjnë dy komikë
(një epitrop dhe shoku i tij) me kazma dhe lopata.

Komiku i Parë
– A mund të varroset ajo si e krishtere, kur vetë me këmngulje kërkoi shëlbimin e vetes saj?
Komiku i Dytë – Të them se mund; dhe prandaj bëja varrin menjëherë; përgjegjësi e hetoi çështjen dhe e gjeti, që të varroset si e krishtere.
Komiku i Parë– Si mund të jetë kështu? Veçse në e mbyti veten, në mbrojtje të vetes së saj?
Komiku i Dytë – Po, kështu e gjenë.
Komiku i Parë– Duhet të jetë në mbrojtje të vetes së saj; s'mund të jetë ndryshe.
Se këtu qëndron çështja: po ta mbyt veten time me dije, ky është një veprim; dhe një veprim ka tri degë; të veprosh, ta bësh, dhe ta kryesh; prandaj,
ajo e mbyti veten e saj me dije.
Komiku i Dytë – Jo, po dëgjo, zoti rëmihës.
Komiku i Parë
– Me lejen tënde. Këtu është ujët; mirë;
Këtu rri më këmbë njeriu; mirë; nëse njeriu
vete në këta ujë dhe mbyt veten e tij, kjo është kështu, do s'do ay vete, - vëre re,
po nëse ujët vete tek ay, dhe e mbyt atë, ay s'e mbyt veten e tij; prandaj, ay që s'është fajtor i vdekjes së tij, s'e shkurton jetën e tij.
Komiku i Dytë – Po, a është ky ligji?
Komiku i Parë– Po, për besë, është, ligji i hetimeve.

Komiku i Dytë – Do t'i të dish të vërtetën përmbi këtë? Po të mos ishte kjo grua fisnike, nuk do ta varrosnin si të krishtere.
Komiku i Parë– Po, tani fole me të! Dhe është për të ardhur keq, që njerëzit e mëdhenj të kenë të drejtë në këtë botë të mbyten ose të varen më tepër se të krishterët e tjerë. Eja, lopata ime, se s'ka fisnikë të vjetër përveç kopshtarëve, hendekbërësve dhe varrmihësve; ata vazhdojnë zanatin e Adhamit.
Komiku i Dytë – A ishte ay fisnik?
Komiku i Parë- Ay ishte i pari që përdori veglat…
Komiku i Dytë – Jo, more, se ay s'kishte.
Komiku i Parë– Çfarë pagan je ti? Si e shpjegon ti shkrimet e shënjta? Shkrimet e shënjta thonë, që Adhami rëmihte; a mund të rëmihte ay pa vegla? Do të të bëj dhe një tjetër pyetje; dhe po të mos më përgjigjesh si duhet, rrëfehu!
Komiku i Dytë – Mirë, bëje.
Komiku i Parë– Cili është ay që ndërton më fortë se muratori, anijebërësi, ose tavanxhiu?
Komiku i Dytë – Trekëmbëshbërësi; se ndërtesa e tij rron më gjatë se një mijë qeraxhinj.
Komiku i Parë– Më pelqen shumë zgjuarsia jote, për besë; trekëmbëshi bën mirë; po si bën ay mirë? Ay u bën mirë atyre që bëjnë keq; tani, t'i bën keq të thuash se trekëmbshi është ndërtuar më fortë se kisha; prandaj, trekëmbëshi mund të të bëjë mirë ty. Eja, përgjigju përsëri.
Komiku i Dytë – Cili është ay që ndërton më fortë se muratori, anijebërësi, ose tavanxhiu?
Komiku i Parë– Po, thuama këtë dhe zhbreju.
Komiku i Dytë – Për besë, tani mund të ta them.
Komiku i Parë– Thuaje.
Komiku i Dytë – Besa, s'ta them dot.

(Hyjnë Hamleti dhe Horati
dhe qëndrojnë pak më tutje)

Komiku i Parë– Mos i vrai më trutë tënd për të, se
gomari yt i plogët nuk do ta përmirësojë capin e tij
me të rrahur. Dhe kur të të bëjnë këtë
pyetje tjetër herë, thuaj varrmihësi; se
shtëpitë që bën ay mbajnë gjer në ditën
e gjykimit të fundit. Pra, rend te Jugani
dhe sillmë një bardhak me raki. *(Del Komiku i Parë)*
(Komiku i Parë rëmih dhe këndon)
Në të ri, kur unë dashuroja, dashuroja,
më dukej se shumë e ëmbël ishte,
shkoja, o, kohën me ah, që dëshëroja,
o, pandehja se asgjë ta krahasosh nuk kishte.
Hamleti – Ky miku s'ka ndjenjën e punës së tij, që
këndon duke bërë varr?
Horati – Zakoni ia ka bërë atë atij pasuri lehtësie.
Hamleti – Pikërisht ashtu është; dora që ka punuar
pakë ka ndjenjë më të mprehtë.
Komiku i Parë– *(Këndon)*
Por vjetet me hapat e tyre vjedharake,
Në kthetrat e tyre më kanë shtënë,
dhe më kanë hedhur brënda në dhe
sikur kurrë i tillë s'kam qënë.
(Hedh përjashta një kafkë)
Hamleti – Kjo kafkë kishte gjuhë dhe mund të
këndonte një herë;
qysh e hedh kopili atë përdhe kështu, sikur
është nofulla e Kainit, që bëri vrasjen e parë!
Ajo mund të jetë kafka e ndonjë politikani, të
cilin ky gomari tani e poshtëron; e ndonjëjt që
mund të shtinte në kurth dhe perëndinë. S'mundte?
Horati – Mundte, Imzot.

Hamleti
– Ose e ndonjëj oborrtari, i cili do të thoshte:
"Mirëmëngjes, i ëmbël imzot! Si je, i mirë imzot?"
Ky mund të jetë, imzot filani, që lëvdoi kalin
e imzot filanit, kur kishte ndërmënd t'ia lypte, -
s'mundte?
Horati – Po, Imzot.
Hamleti – Po, kështu është, dhe tani kafka që ishte e
imzot filanit, është zoti krimb pa nofulla dhe po ia
godit rreth rradaken me lopatën e tij një epitrop; kjo
është tamam kryengritje, nëse ne kemi aftësinë të
shohmë. S'vlenin kocka të bëheshin më tepër, veçse
të lozin doçkën me to? Të mijat më dhëmbin
kur mendohem për këtë.
Komiku i Parë– *(Këndon)*
Një kazmë dhe një lopatë, një lopatë,
dhe një savan të mbështillet.
Hapni një gropë për të në baltë
që një mysafiri të tillë t'i përgjigjet.
(Hedh përjashta një kafkë tjetër)
Hamleti
– Ja dhe një tjetër; pse mund të mos jetë kjo
kafka e ndonjë avokati? Ku janë pse-të e tij tani,
stërhollimet e tij, davatë e tij, pronat e tij,
hiletë e tij? Pse ay e duron këtë kopil të vrazhdë
tani ta goditjë rreth rradakes së tij me një
lopatë të ndyrë, dhe s'i thotë që do t'i bëjë padi
për rrahjen? Hm! Ky miku mund të ketë qënë
në kohën e tij, një blerës i madh tokash,
me statutet e tij, pengjet e tij, gjobat e tij,
sigurimet e tij të dyfishta, dhe shlyerjet e tij,
është kjo gjoba e gjobave të tij dhe shlyerja
e shlyerjeve të tij, që ta ketë kafkën e tij më në fund
plot me ndyrësi të fundme të banojë

gjithmonë në të? S'mundnë garancitë
e tij dhe të dyfishtat akoma të blerësve të tij
t'i garantonin më tepër vënd se sa zënë
një palë kontrata të hapura? As vetë
tapitë e mallrave të tij s'i nxë në këtë kuti;[27]
dhe pronari të mos ketë një çikë më tepër, hë?
Horati – Asnjë pikë më tepër, Imzot.
Hamleti Pergamena nuk bëhet nga lëkura e dhënve?
Horati – Po, imzot, edhe nga lëkurët e viçeve.
Hamleti – Janë dhën dhe viçe ata që kërkojnë të sigurohen me to. Do t'i flas këtij mikut. – I kujt është ky varr, zotëri?
Komiku i Parë– Imi, zotëri.
(Këndon) O hapni një gropë për të në baltë,
Që një mysafiri të tillë t'i përgjigjet;
Hamleti
– Prandej se është yti, me të vërtetë, se ti rri në të.
Komiku i Parë – Ti rri përjashta tij, zotëri, dhe prandaj s'është yti; nga ana imë unë s'rri ne ky këtu, dhe megjithkëtë është imi.
Hamleti – Ti rri në të, ne qënë se je në të, dhe thua që është yti; ay është për të vdekur dhe jo për të gjallë; pra, ti më thua gënjeshtra.
Komiku i Parë– Kjo është një gënjeshtër e gjallë, zotëri, shkon nga mua dhe vjen prap tek ti.
Hamleti – Për ç'burrë e bën varrin?
Komiku i Parë– Jo për burrë, zotëri.
Hamleti – Po për ç'grua ahere?
Komiku i Parë– Jo, as për grua.
Hamleti – Kush do të varroset ay brënda?
Komiku– Një që ishte grua, zotëri, po perëndia e ndjeftë, vdiq.
Hamleti – Sa i përpiktë që është qerrataj! Duhet ta llafosç me pergjel, se pëndryshe do të na shuajë me

domethëniet e errëta. Për zotin, Horat, këta
tre vjet e kam vënë re se bota përparon aqë shumë
sa gishti i këmbës katundarit i vjen afër
thëmbrës oborrtarit sa i skërfit morthin.
Sa kohë ke që je varrmihës?
Komiku i Parë– Nga të gjitha ditët e vitit, unë fillova
këtë zanat atë ditë që mbreti ynë i fundit
Hamleti, mundi Fortinbrasin.
Hamleti – Sa kohë ka që ahere?
Komiku i Parë– Nuk e di këtë? Këtë e di çdo budalla;
ishte po ajo ditë që u lind Hamleti i ri;
ay që u marros dhe e dërguan në Angli.
Hamleti – Po, me të vërtetë, pse e dërguan në Angli?
Komiku i Parë– Pse? Sepse ay ishte i marrë; do të
rifitojë mëndtë atje; po dhe në mos i rifitoftë,
s'është e keqe e madhe atje.
Hamleti – Pse?
Komiku i Parë– Se nuk do t'i duket atje; se atje
të gjithë njerzit janë të marrë si ay.
Hamleti – Si ngjau që u marros?
Komiku i Parë– Në mënyrë të çuditshme, thonë.
Hamleti – Si, në mënyrë të çuditshme?
Komiku i Parë– Besa, po nga që humbi mëndtë.
Hamleti – Por nga se?
Komiku i Parë– Po nga këtu, nga Danimarka; unë
jam varrmihës këtu burrë e djalë tirdhjet vjet.
Hamleti – Sa kohë duhet të rijë një njeri në dhe
para se të kalbet?
Komiku i Parë– Për besë, në mos qëntë i kalbur më
parë se të vdesë, - sikundër janë në ditët e sotme
shumë kufoma li-ngrënë që s'mbajnë sa t'i fusin
brënda, - mban tetë ose nëntë vjet. Lëkurtari
mban nëntë vjet.
Hamleti – Po, pse ay më shumë se të tjerët?

Komiku i Parë– Pse zotëri, se lëkura e tij është
regjur me zanatin e tij, dhe s'kllet ujë për shumë
kohë; dhe ujët është kalbëzonjës i tmerrshëm i trupit
kopil të vdekur. Ja këtu është një kafkë tani,
kjo kafkë ka ndënjur në dhe njëzet e tre vjet.
Hamleti – E kujt ishte?
Komiku i Parë– Ishte e një kopili të marrë;
e kujt panden ti se ishte?
Hamleti – Jo, nuk e di.
Komiku i Parë– I mallkuar qoftë kopili i tërbuar!
Ay më derdhi një plloçkë me verë të Rinit
përmbi kokë një herë; po tamam kjo kafkë,
zotëri, ishte, zotëri, kafka e Jrikut,
shakaxhiut të mbretit.
Hamleti – Kjo?
Komiku i Parë– Pikërisht kjjo.
Hamleti – Epma ta shikoj (Herr kafkën) Bobo, i mjeri
Jorik! E njihja; një njeri me shaka
të pafundme, me teka te shkëlqyera; më
kishte marrë në kurriz mijëra herë, dhe
tani sa më ngjeth në përfytyrimin tim!
Më gërdit! Këtu vareshin ato buzët
që i kam puthut kush e di se sa herë.
Ku janë qesënditë tënde tani? Kërcimet tënde?
Këngët tënde? Shkrepëtimet e dëfrimeve tënde, që
ishin bërë zakon të bënin tryezën të vrumbullonte?
As një tani të përqeshç me zgërdhimin tënd?
Krej nofulla rënë? Shko tani te dhoma e zonjës
sime, dhe thuaji, që sikur dhe një gisht
të trashë ta vërë të lyerit e saj, në këtë bukuri
do të kandisjë. Dhe bëje të qeshjë me të.
Të lutem, Horat thuam një gjë.
Horati – Çfarë, imzot?
Hamleti – A mendon ti se Aleksandri i madh

dukej kështu në dhe?
Horati – Pikërisht kështu.
Hamleti – Dhe binte erë kështu? Puh! *(E vë kafkën)*
Horati – Pikërisht kështu, Imzot.
Hamleti – Për ç'qëllime të ulta mund të përdoremi
një ditë ne, Horat! Pse përfytyrimi të mos e gjurmojë
pluhurin bujar të Aleksandrit, derisa ta gjejë atë
të mbylljë vrimën e një vozge?
Horati – Duhet të jesh shumë mëndjemprehtë,
që të ndjekësh këtë arësyetim.
Hamleti – Jo, besa, aspak; po ta ndjekësh atë që
andej me një farë mase, dhe ta shtjellosh çështjen
në këtë mënyrë; Aleksandri vdiq,
Aleksandri u varros, Aleksandri u kthye në pluhur,
pluhuri është dhe, prej dheut bëjmë baltë, -
dhe pse prej saj balte, në të cilën ay është
shndërruar të mos mbyllin një vozgë bire?
Perandori Qesar vdiq dhe u bë baltë,
mund të zërë një vrimë të mbajë të ftohtët jashtë;
O, ay dheu që i kalli botës datën,
të arnojë një mur, të zbojë jasht shtërgatën!
Po, dale! Dale! Të hiqemi mënjanë se po vjen mbreti,
(Hyjnë priftër dhe shoqëronjës të tjerë në proces funeral; kufoma e Ofelisë, Learti dhe vajtonjësit ecin prapa saj. Klaudi, Gertruda, shoqëronjësit e tyre dhe njerës të tjerë vinë prapa) mbretëresha, oborrtarët.
Cili është ay që ndjekin pas?
Dhe me shërbesa të gjymtuara. Kjo është shenjë
se kufoma që përcjellin ka vrarë veten me dorë të
dëshpëruar; do të qe i ndonjë shkalle të lartë.
Tulatem pak këtu dhe i vëzhgojmë. *(Ulen në bërshe)*
Laerti– Ç'shërbim tjetër duhet bërë?
Hamleti - Është Laerti, një i ri shumë bujar; vëre re.
Laerti– Ç'shërbim tjetër duhet bërë?

Prifti i Parë
– Salikimet e saja i kemi zmadhuar më shumë
se sa rregullat na lejojnë; vdekja e saj qe i dyshimtë;
dhe lartmadhëria e tij, po të mos kishte ndikuar
në rendin që rregullat e kishës parashikojnë,
kjo duhej të vendosej në vënd jo të shënjtë
gjer në trumpetën e fundme; dhe në vënd të lutjeve
mëshirore, copra poçe, strala, dhe guraleca,
do të hidhnim përmbi të.
Prapseprap këtu i lejuam kurorët e virgjërisë së saj,
dhe shpërndarjen e luleve të vajzërisë së saj, dhe
të shoqëruar me kambana e suallmë në varr,
në shtëpinë e saj të fundme.
Laerti– S'duhet bërë gjë tjetër?
Prifti i Parë– Asgjë tjetër.
do të profanojmë shërbesat e të vdekurve,
po të këndojmë pështpirtje dhe prehje të atilla asaj,
sikundër bëjmë për shpirtra që ndahen në paqe.
Laerti– Lëshoheni në varr, -
dhe nga turpi i saj i bukur dhe i dlirë –
manushaqe le të mbijnë!
(Qivurin e lëshojnë në varr)
Dhe ja ku të them, ty prift i vrazhdë, imë motër
do të jetë ëngjëll, kur ti shtrirë do ulëriç!
Hamleti – Kush? Ofelia e bukur!
Gertruda – *(Shpërndan lule)*
Për lulen lule; lamtumirë!
Shpresoja të të merrja nusje për Hamletin tim;
mendoja të të stolisja shtratin tënd nusëror,
vajzë e ëmbël,
dhe jo të shpërndaja lule në varrin tënd.
Laerti– O, trifish mjerim,
bjerë dhjetë herë trifish mbi kokën e mallkuar,
vepra e keqe e të cilit të shpronësoi nga mëndja

jote shumë e madhe! Mos hidhni dhe, daleni pak
ta përqafoj edhe një herë! *(Hidhet në varr)*
Tani hidheni dhenë mbi të gjallë e mbi të vdekur,
derisa prej këtij sheshi të ngrini mal,
të kaptojë majën e Pilionit plak, ose kokën
qiellore të Olimpit të kaltërt.
Hamleti – *(Vjen përpara)*
Cili është ky që pikëllimin e tij
po e dëften me aqë emfazë?
Dhe shprehjet e hidhërimit të tij përgjërojnë yjtë
rravgonjës dhe i bëjnë të qëndrojnë
me habitje si të çmerritur dëgjonjës?
Unë jam Hamlet danezi. *(Hidhet në varr)*
Laerti
– Të marrtë djalli shpirtin tënd! *(Përfytet me të)*
Hamleti – Ti s'lutesh mirë.
Të lutem hiqi gishtrinjtë tënd nga gryka ime;
se sido që s'jam gjaknxehtë dhe i rrëmbyer, -
prapseprapë kam brënda meje diçka të rrezikshme,
së cilës urtësia jote do të bëjë mirë t'i trëmbet;
hiqe, të them, dorën!
Klaudi - Ndajini!
Gertruda – Hamlet, Hamlet!
Të gjithë – Bujarë!
Horati – I mirë, imzot qetësohu.
(Shoqëronjësit i ndajnë dhe dalin jashtë nga varri)
Hamleti – Po, do të lëftoj me të për këtë çështje
gjersa të mos më lozin më qepallat.
Gertruda – O biri im, për ç'është?
Hamleti
– Unë e dashuroja Ofelinë; sa dyzetmijë vëllezër
s'mundnin me tërë sasinë e dashurisë së tyre
të krahasonin timen. – Ç'do të bëje ti për të?
Klaudi – O, ay është i marrë, Laert?

Gertruda – Në emër të perëndisë, mos ia vini re.
Hamleti – Për plagët e zotit Krisht, thuaj ç'do të bësh ti? Do të qash? Do të kacafytesh? Po të agjërosh? Do të shqyesh veten tënde?
Do të pish uthull? Hash krokodil?
Unë i bëj, - dhe ti vjen e më curritesh këtu?
E të më mundsh duke u hedhur në varrin e saj?
Të varrosesh me të i gjallë, dhe unë e bëj.
Dhe, në se ti dërdëllis për male, le të hedhin
miliona dynymë përmbi ne, gjersa dheu ynë,
të përzhitjë majën e tij në dielli,
dhe Osa[28] të duket përpara tij si leze!
Dhe mos bërtit madhërisht shprehje retorike,
se si ty çartoj dhe unë.
Gertruda – Kjo është thjeshtë marrëzi;
dhe ndërsa kështu vepron rrebja mbi të,
po menjëherë pastaj i duruar si pëllumbesha,[29]
kur çiftin e saj të artë ka çelur,
rri kokë ulur i heshtur.
Hamleti – Dëgjo, zotëri;
ç'është arësya që më sillesh kështu?
Unë të kam dashur gjithmonë. Po s'ka gjë;
le të bëjë çfarë të dojë Herkuli vetë,
macja do mjaullijë, dhe qëni ditën e tij do ketë.[30] *(Del)*
Klaudi – Të lutem, i mirë Horat, kije kujdes. *(Horati i bie pas) (I thotë mënjanë Laertit)* Forcohe durimin
tënd në fjalët që thamë mbrëmë;
dhe do ta vëmë në veprim menjëherë çështjen...
Gertrudë e mirë, vërë disa të ruajnë tët bir. –
Ky varr do të ketë përmendore të gjallë;[31]
prej saj dhe ne një orë të qetë do shikojmë,
gjer ahere, pra me durim duhet të veprojmë. *(Dalin)*

Skena e dytë

Një sallë në kështjellë.
Hyjnë Hamleti me Horati n duke folur.

Hamleti – Mjaft për këtë, zotëri; tani do të shikosh tjetër; ti, i mban mënd të gjitha rrethanat?
Horati – A i mbaj mënd, imzot!
Hamleti – Zotëri, në mëndjen time bëhej një farë lufte, dhe s'më linte të flije. Më dukej sikur isha shtrirë më keq se robërit në zinxhirë, në hambar të anijes.[32] Me rrëmbim, dhe lavdi pastë rrëmbimi se ay na mëson, që paurtia jonë disa herë na shërben mirë, kur planet tona më të thellë dështojnë;
dhe kjo duhet të na mësojë,
se është hyjni ajo që formon qëllimet tona,
sa do që hë për hë i gdhëndim ashpër ne ato.
Horati – Kjo është shumë e vërtetë.
Hamleti – Brofa dhe dolla nga kabina,
hodha setrën krahëvet dhe në t'errët
kërkoja t'i gjeja; mu plotësua dëshira,
kapa paketën e tyre dhe më në fund u ktheva
në dhomën time përsëri; mora guxim dhe frika ime harroi sjelljen, që të ç'vulosja shkresat e tyre; ku gjeta, Horat, - o, tradhëti mbretërore!
Një urdhër të përpikët, të zbukuruar me shumë arësye të ndryshme, që i përkasin mirëqënies të Danimarkës dhe Anglisë, se, o! Është gogol dhe karkanxholl jeta ime, - dhe që me lëçitjen e saj, pa humbur kohë, jo, jo sa sa të mprihnin sëpatën, të më prisnin kokën.
Horati – Është e mundur?
Hamleti – Ja ku është letra; lexoje kur të jesh me nge. Po do ti të më dëgjosh se si veprova?

Horati – Të lutem.
Hamleti
-Me qënë kështu në rrjetë rrotull me keqbërës,
- Më parë se të bëja një përpjekje në trutë tim,
që të zbrapsja rrezikun, ata kishin filluar lodrën për
zhdukjen time, - ndëja poshtë;
dhe hartova një letër të re; e shkrova bukur;
dikur bëja dhe unë siç bëjnë sekretarët tanë,
poshtërsi të shkruaja bukur,[33] dhe bile u mundova
shumë, që ta harroja atë mësim; po, zotëri,
tani më bëri shërbim të madh.
Di ti të dish, se çfarë shkrova?
Horati – Po, i mirë, Imzot.
Hamleti – Përgjërime të zjarrta prej mbretit, -
ashtu siç është Anglia vasale e tij besnike, -
ashtu dashuria midis tyre si palmë të lulëzojë,
ashtu paqja të veshjë gjithnjë kurorën e saj
prej gruri dhe të qëndrojë
si presje në mes të dy miqësive;
dhe shumë të këtilla si këto "ashtu"
me rëndësi të madhe,
që me të shkuar dhe mësuar këtë përmbajtje,
pa biseduar gjerë e gjatë,
duhet të vrasë prurësit begas,
as për t'u rrëfyer kohë të mos u pranohet.
Horati – Po si e vulose?
Hamleti – Po, edhe kjo ishte një ndihmë qiellore.
Kisha vulën e tim eti në kuletën time,
e cila qe modeli i vulës së Danimarkës;
palosë shkresën në formën e së parës;
e nënshkrova; e vulosa; e vura te tëndi me siguri,
dhe ndrrimi kurrë s'u kuptua; pastaj,
të nesërmen u bë lufta jonë detare;
dhe ç'vazhdoi pas kësaj ti i di të tëra.

Horati – Pra, Guildensterni dhe Rosenkranci po venë drejt vdekjes tyre.

Hamleti

– Po, burrë, ata i bënin dashuri këtij shërbimi;
ata s'janë afër ndërgjegjes sime; humbja e tyre
vjen prej rumuzave të vetes tyre.
Është rrezik për krijesa më të ulëta të futen
midis sulmit dhe të shpatave të ndezura egërsisht
prej du kundërshtarësh të pushtetshëm.

Horati – Po, çfarë mbret është ky!

Hamleti – S'panden ti tani, se është detyra ime, -
atë që vrau mbretin tim, dhe përdhunoi nënë time;
që dolli midis zgjedhjes dhe të shpresave të mia;
hodhi grepin dhe vetë jetën time,
dhe me mashtrim të tillë,
- nuk është e pastër ndërgjegjja ime,
që ta shpaguaj atë me këtë krah?
Dhe nuk do të jem i mallkuar,
po ta le këtë kancer të jetës sonë
të bëjë akoma të këqia?

Horati

– Duhet të vinë për së shpejti lajmet nga Anglia,
se ç'fund do t'i marrë puna e tij atje.

Hamleti

-Po për së shpejti, por gjer ahere koha është imja;
dhe jeta e njeriut s'është
më shumë se sa të thuash nj. –
Po jam shumë i hidhëruar, i mirë Horat,
që u rrëmbeva ndaj Laertit;
se në pikturën e shkakut tim, shikoj
portretin e tij; do t'i kërkoj miqësinë;
po, sigurisht mburrjet e hidhërimit të tij
më ndezë aqë tepër.

Horati – Pusho! Kush po vjen? *(Hyn Orsiku)*

Orsiku– *(Heq kapellën dhe ul kryet)*
Imzoti im, mirseardhe prapë në Danimarkë.
Hamleti – Të falëminderit me përulësi, zotëri. –
(I thotë mënjanë Horatit) E njeh ti këtë mizën e ujit?
Horati *(I thotë mënjanë Hamletit)* Jo, i mirë Imzot.
Hamleti – *(Mënjanë **Horati** t)* Ahere gjëndja jote është më e hirshme; -
se ta njohësh atë është ves.
Ay ka shumë toka, dhe pjellore;
lere një shtazë të bëhet imzot prej shtazash,
dhe grazhdi i tij do të jetë te tryeza e mbretit;
është korb sqepkuq; po siç të thashë,
pronar i madh plehu.
Orsiku– *(Përulet prapë)*
I ëmbël, imzot, në se imzoti im është me nge,
do t'i njoftoj diçka nga madhëria e tij.
Hamleti – Do ta pranoj, zotëri, me tërë vullnetin e frymës sime.
(Orsiku vazhdon të përulet dhe valavit kapellën e tij andej këtej).
Vërë kësulën në përdorimin e saj të përshtatshëm; është për kokën.
Orsiku– Faleminderit, imzot, është shumë nxehtë.
Hamleti
– Jo, besomë, bën shumë ftohtë, fryn veriu.
Orsiku– Bën mjaft ftohtë, imzot, me të vërtetë.
Hamleti – Po prapseprap unë pandej se është shumë zagushi dhe vapë, për temperamentin tim.
Orsiku – Pa masë, imzot; bën zagushi, - sa, dua të them, s'di se si ta përshkruaj. Po, imzot, madhëria e tij më urdhroi t'ju njoftoj se ay ka vënë një
bast të madh për ty. Imzot, kjo është çështja, -
Hamleti – *(E shtyn përsëri të vërë kapellën në kokë)*
Të lutem, kujtohu.

Orsiku– Jo, i mirë imzot, kështu e kam më lehtë, për besë. Imzot, këtu në oborr tani ka ardhur Laerti; besomë, është një fisnik i përsosur, plot me aftësi të shkëlqyer, oborrtar nga sjellja dhe bujar nga pamja; me të vërtetë që të them të drejtën, ay është busola ose kalendari i fisnikërisë, se ti do të gjesh tek ay shumën e çdo cilësie që një fisnik do të dëshëronte të shikonte me vëmendje për ta imituar.
Hamleti – Zotëri, përshkrimi i tij s'pëson asnjë humbje prej gojës tënde, ndonse unë e di që po t'i ndash cilësitë e tij sipas inventarit
do ta bëje aritmetikën e kujtesës t'i mirreshin mëndtë, prapseprapë edhe përshkrimi më i mirë i tij nuk do të jetë i plotë, po të marrim parasysh shpejtësinë e velit[34] të mëndjes së tij.
Po le të kufizohemi në lavdin e tij të vërtetë, unë e çmoj atë si një shpirt me cilësi të shkëlqyera, në karakterin e të cilit ato janë derdhur.
Dhe që të bëjmë një përshkrim të drejtë të tij mund të themi: që ay mund të gjegjë shëmbëlltyrën e tij vetëm në pasqyrë,
dhe cilido tjetër që do ta ndjekë atë do të jetë hija e tij, dhe asgjë tjetër.
Osriku – Imzot, ju flisni pagabuar aspak për të.
Hamleti – Po ç'lidhje kanë këto, zotëri? Pse e mbështjellim fisnikun me frymën e ligë të shprehjeve tona?
Orsiku– Imzot?
Horati
– Nuk është e mundur të kuptoj në gjuhë tjetër? Ti mund ta bësh këtë me të vërtet, zotëri?
Hamleti
– Çdo të thuash, qëpërmënd emrin e këti finiku?
Orsiku– Të Laertit?

Horati – *(I thotë mënjanë Hamletit)*
Iu zbras qesja tanimë;
i harxhoi të gjitha fjalët e tij të arta.
Hamleti – Po, të ati, zotëri.
Orsiku– Është e pamundur të mos e dish…
Hamleti – Mos bëj kaq të paditur. – Por
edhe sikur të mendosh kështu, zotëri,
mendimi yt nuk do të peshojë shumë. – Pra, zotëri.
Orsiku
– Është e pamundur të mos e dini zotësinë e Laertit.
Hamleti – S'guxoj ta pohoj se e njoh atë, nga frika
se mos krahasohem me të në zotësi; se asnjëri
s'mund të njohë tërësisht një tjetër veçse
po të njohë veten e tij, e cila është shtrirja
më ekstreme e urtisë njerëzore.
Orsiku– Dua të them, imzot, për armët e tij;
sipas vlerësimit të përgjithshëm, ay
në këtë drejtim nuk ka shok.
Hamleti – Cilat janë armët e tij?
Orsiku– Shpata dhe kama.
Hamleti – Ato janë dy prej armëve të tij; po, mirë.
Orsiku
– Mbreti, imzot, ka vënë bast me të gjashtë kuaj
barbarezë; kundër të cilëve ay ka vënë peng,
me sa di unë, gjashtë shpata dhe kama franceze,
me takëmet e tyre, si breza, rripa, dhe të tjera;
tre prej takëmeve, për besë janë shumë të vlefshëm,
vizatuar dhe punuar me shijë. Venë me myllet,
takëme shumë delikate dhe me qëndisje shumë të
bukura.
Hamleti – Cilët quan takëme?
Horati – *(I thotë mënjanë Hamletit)*
E dija që do të të duhej
të përdorje fjalorthin para se të mbaronit fjalën.

Orsiku– Takëme, imzot, janë rripat.
Hamleti – Fjala do të ishte më me vënd po të mbanim top pas mesit tonë, - po rripa le të jenë. Por le të vazhdojmë: gjashtë kujat barbarezë, kundër gjashtë shpatave franceze, takëmet e tyre, dhe tre rripat e qëndisur dhe të përpunuar bukur, - ky është basti francez kundër Danimarkës, dhe tërë këto pse janë vënë peng, ashtu si thua ti?
Osriku – Mbreti, imzot, ka vënë bast, imzot, se në dymbëdhjetë goditje midis teje dhe Laertit,
ay nuk do të ta tejkalojë më tepër se tri herë;
ay vë dymbëdhjetë për nëntë;
dhe do të vihet në veprim menjëherë,
nëse imzoti im
do të ketë kenaqësinë të përgjigjet.
Hamleti – Dhe po të përgjigjem jo?
Osriku– Dua të them, imzot, po të kini mirësinë të ndesheni me kundërshtarin.
Hamleti – Zotëri, do të bares këtu në këtë sallë;
nëse kjo e kënaq madhërinë e tij,
kjo është koha e ditës që marr erë;
le të sjellin shpatat; në fisniku do,
dhe mbreti ngul këmbë, do të fitoj për të
po të mund; në mos, nuk do të fitoj asgjë
veçse turpin tim dhe goditjet e tepërta.
Osriku
– T'ua njoftoj përgjigjen tuaj pikërisht kështu?
Hamleti - Pikërisht kështu, pastaj stolise si të të dojë qefi.
Osriku– *(Ul kryet)*
Ju rekomandoj besnikërine time, imzot.
Hamleti – *(Pas një përulje tjetër të thellë Orsiku vë kapellën në kokë dhe del)*
Bën mirë që rekomandon veten; se s'gjenden

gjuhë të tjera t'i bëjnë këtë nder.
Horati – Ky kiciriba po rend tutje me lëvezhgën e vezës mbi kokë.
Hamleti – Ay i bënte lajka, zotëri, sisës së nënës tij më parë se ta thëthite.
Kështu ay, dhe shumë të tjerë, prej të njëjtës turmë që unë i di, për të cilët kohë jonë e padenjë mrroset, ata kanë mësuar përmendsh hipokrizitë e ditës, një gatishmëri të sipërfaqshme
prej fjalësh pa rëndësi dhe pa vëmendje,
një lloj mbledhje prej shkumbe nga kotësirat e modës, të cilat prapseprapë pëlqehen nga gjykimet e më të mëdhenjve dhe aprovohen. Por veç sikur të bësh provë t'u frysh flluskat zhduken.
(Hyn një imzot)
Imzoti – Imzot, madhëria e tij ju dërgoi fjalë
me Orsikun e ri, i cili i pruri përgjigjen se e prisni në sallë; më dërgoi të mësojë nëse kini edhe kënaqësinë të luani me Laertin, apo do ta shtyni për më tutje.
Hamleti
– Unë nuk i ndrroj vendimet e mia; ato ndjekin kënaqësinë e mbretit; nëse aftësia e Laertit flet, imja është gati; tani ose kurdoherë tjetër,
po me kusht që të jem aqë i aftë sa jam tani.
Imzoti
– Mbreti, mbretëresha dhe të gjithë po vinë poshtë.
Hamleti – Rast i lumtur.
Imzoti – Mbretëresha dëshëron, që para se të fillojë loja ta përshëndetni Laertin me oborrsi miqësore.
Hamleti – Mirë më kështillon. *(Imzoti del)*
Horati – Do ta humbsh këtë bast, imzot.
Hamleti – Nuk e besoj; se qëkur ay vajti në Franci kam bërë ushtrime parreshtur; do të fitoj –

me ndryshimin e pikave; po s'mund ta marrç me
mënd se sa i tronditur që jam; po s'prish punë.
Horati – Jo, i mirë imzot. –
Hamleti – Është vetëm budallallëk. Po kam një lloj
ndrojtje të atillë që mund të trubullojë një grua.
Horati – Nëqoftëse ta çqetëson gjëkafsh mëndjen
tënde, bindju.
Vete më parë se të vinë këtu dhe u them që s'ke qef.
Hamleti – Aspak, parandjenjat nuk më trëmbin,
se edhe një harabel kur bie është vullneti i zotit,
nëqoftëse vjen tani, s'është për tjetër herë,
në mos qoftë për tjetër herë, do të vijë tani;
në mos ardhtë tani, prapseprapë do të vijë;
puna është të jesh gati.
Kurse asnjeri s'di asgjë se çfarë kushte të
jetës le prapa, me që ay s'mund të gjykojë
se ç'mund të vinë në vitet e ardhshëm,
ahere pas të tmerrohet prej të lënit e jetës herët? Pse
të tmerrohet ay prej një vdekjeje të lashtë,
prej së cilës ay nuk mund të dijë nëse është një
humbje lumtërie ose ndërprerje fatkeqësie?
I urrej bestytnitë, shënjat dhe profetitë,
të cilat s'kanë bazë në arësye ose në adhurim,
ngushëllimi im është që nuk do të bie,
veçse prej drejtimit të zotit.
Pra le të bëhet.
*(Hyjnë shërbëtorë me tryeza, karrike dhe jastëke.
Pastaj vënë shpatat dhe kamat mbi tryezë. Hyjnë
trumpeta dhe daulle. Ahere vinë Klaudi, Gertruda,
imzotër, Orsiku dhe Laerti).*
Klaudi
– Eja, Halmet, eja dhe prano këtë dorë prej meje.
*(Klaudi vë dorën e Laertit në dorën e Hamletit; dhe
pastaj e shpie Gertrudën në fronet mbretërorë.)*

Hamleti – Ndjemë, zotëri, të kam bërë të padrejtë;
po si fisnik që je, famë.
Të gjithë të pranishmit e dinë
dhe ti duhet të kesh dëgjuar, se sa kam vojtur
nga një tronditje e tmerrshme. Çdo gjë që kam barë,
e cila të ka cënuar nderin, ndjenjat dhe dinjitetin
tënd, unë e shpall këtu se është marrëzi.
S'ishte Hamleti që i bëri të padrejtë Laertit? Kurrë
Hamleti, nëse Hamleti ka lojtur nga vet' e tij.
Dhe kur ays'është në veten e tij, i bën të padrejtë
Laertit, ahere s'e bën Hamleti, Hamleti e mohon këtë.
Cili e bën ahere?
Marrëzia e tij; nëse kjo është kështu,
Hamleti është nga ata që u është bërë padrejtësi;
marrëzia e tij është armiku i Hamletit të mjerë.
Zotërinj, përpara kësaj mbledhjeje
e mohoj se kam patur qëllim të keq karshi teje,
dhe falmë kësisoj në mendimet tënde bujare,
që sikur shtiva shigjetën time
përmbi shtëpi dhe plagosa tim vëlla.
Laerti
– Jam i kënaqur përsa u përket ndjenjave të mia,
sidoqë shtysa e tyre në këtë rast duhej të më
ndezte edhe më shumë
në hakmarrjen time; po në kushtet time të nderit
qëndroj i paepur, dhe nuk do të pajtohem
derisa të kem një mendim dhe procedent pajtimi,
prej disa pleqsh kryetarësh dhe me nder të njohur,
që të ruaj emrin tim të pacënuar. Po deri ahere,
e pranoj çfaqjen e dashurisë tënde si dashuri
dhe nuk do ta dhunoj.
Hamleti – E përqafoj lirisht qëndrimin tënd,
dhe bastin tonë vëllazëror do ta luaj sinqerisht.
Epnani shpatat. – Ejani përpara.

Laerti – Po, edhe një për mua.
Hamleti – Unë do të jem nishani yt, Laert;
në papërvojën time mjeshtëria jote do të qëndrojë si yll në natën më të errët dhe do të spikatjë me shkëlqim edhe më të madh.
Laerti – Ti më tall, imzot.
Hamleti – Jo, betohem për këtë dorë.
Klaudi – Orsik, jepu shpatat. –
(Orsiku shpie katër, pesë shpata)
Kushëri, Halmet, ti e di bastin?
Hamleti – Shumë mirë, imzot; madhëria juaj i ka vënë pikat në favor të të dobëtit.
Klaudi
– Kësaj s'ja kam frikën; ju kam parë që të dyve;
po me që ay është m'i stërvitur, prandaj ne kemi pikat.
Laerti
– Kjo është shumë e rëndë; le të shikoj një tjetër.
(Vete te tryeza dhe merr shpatën
e mprehtë dhe të helmuar)
Hamleti – *(Merr një shpatë prej Orsikut)*
Mua më pëlqen kjo.
Kanë të gjithë shpatat një gjatësi?
Osriku– Po, i mirë imzot.
(Gjykatësit dhe shoqëronjësit pregatitin dyshemenë për skermën; Hamleti bëhet gati, shërbëtorët sjellin bardhakë me verë dhe gota.)
Klaudi – Virini gotat me verë mbi atë tryezë.
Nëse Hamleti jep goditjen e parë ose të dytën,
apo t'ia shpërblejë në përgjigjen e shkëmbimit të tretë, të gjitha bedenat le të zbrazin topat.
Mbreti do të pijë për shëndetin e Hamletit
dhe në gotën e tij një margaritar do të hedhë,
më të pasur se sa katër mbretër me radhë

në kurorën e Danimarkës kanë vënë. Epëmni gotat,
dhe daullja trumpetës le t'i thotë,
dhe trumpeta topave përjashta,
dhe topat qiellit, dhe qielli dheut,
tani mbreti pi për Hamletin. Ejani, filloni;
dhe ju gjykatës, shikoni me kujdes dhe vërejtje.
(Gotat ia vënë përkrah tij; trumpetat bien. Hamleti dhe Laerti zënë vëndet e tyre).
Hamleti – Eja, zotëri.
Laerti – Eja, imzot. *(Lozin)*
Hamleti – Një!
Laerti – Jo.
Hamleti – Gjykoni.
Osriku– Goditje, dhe goditje shumë e dalluar.
Laerti – Mirë; eja përsëri.
Klaudi – Qëndroni, epëmni të pi. – *(Një shërbëtor i mbush një gotë)* Hamlet, *(Mban lart një xhevair)* ky margaritar është yti. Pi për shëndetin tënd. *(Pi dhe ahere duket të hedhë një margaritar brënda në gotë) (Daullja bie, trumpetat buçasin, dhe zbrazje topash dëgjohen përjashta.)* Jepi gotën.
Hamleti – Sefte do të luaj këtë valë; vëre për pak mënjanë. – *(Shërbëtori e vë prapë mbi tryezë përkrah tij)* Eja. *(Lozin përsëri)* Një tjetër goditje! Ç'thua tani?
Laerti – Më preku, më preku, e pranoj.
Klaudi – Djali ynë do të fitojë.
Gertruda – Është i ngjallmë dhe merr frymë me zor, - na, Hamlet, merr shaminë time dhe fshih ballët.
(I jep shaminë dhe shkon të tryeza dhe merr gotën me verë të Hamletit)
Mbretëresha pi për fatin tënd të mirë, Hamlet.
Hamleti – Ju falnderoj shumë, zonjë.
Klaudi – Gertrudë, mos pi!
Gertruda – Do të pi, imzot, ndjemë.

(Ajo pi dhe i zgjat gotën Hamletit)
Klaudi – *(Mënjanë)*
Është gota e helmuar! Është shumë vonë!
Hamleti – S'guxoj të pi edhe, zonjë – pak më vonë.
Gertruda – Eja të të fshih fytyrën.
Laerti – *(I thotë Klaudit)* Imzot, tani do ta godit.
Klaudi – Nuk e besoj.
Laerti – *(Mënjanë)* Dhe megjithkëtë kjo është pothuajse. Kundër ndërgjegjes sime.
Hamleti – Eja, për të tretën herë, Laert;
por ti po tallesh;
të lutem, sulmo me forcën tënde më të rreptë;
dhe mos bëj sikur luan me ndonjë fëmijë.
Laerti – Ashtu thua? Eja, fillo. *(Lozin valën e tretë)*
Osriku– Asgjë, asnjeri. *(Qëndrojnë papritur)*
Laerti – *(Befas)* Na tani!
(I tërheq vëmendjen Hamletit nga ruajtja e tij dhe e plagos një çikë; të ndezur përleshen përsëri. Hamleti me një zbrapsje të fortë dhe të shpejtë ia flak Laertit shpatën nga dora e tij.
Në pajtim me bujarinë e natyrës së tij, Hamleti i jep shpatën e tij Laertit dhe ay vetë ulet dhe merr shpatën e Laertit. Dhe e plagos rëndë Laertin).
Klaudi – Ndajini se u egërsuan.
Hamleti – Jo, eja përsëri. *(Gertruda bie)*
Osriku – Ej, kini kujdes, mbretëresha!
Horati – Të dyve ju pikon gjak. Si je, imzot?
(Laerti bie)
Osr. – *(I bën shërbim)* Si je, Laert?
Laerti – Si një shapkë[35] në grackën time, Osrik; uvrava drejtësisht nga tradhëtia ime.
Hamleti – Ç'ka mbretëresha?
Klaudi – I ra zali që ju pa t'ju rrjedhë gjak.

Gertruda – Jo, jo, pija, pija, o Hamleti im i dashur, -
pija, pija! – Është e helmruar, u helmova! *(Vdes)*
Hamleti – O poshtërsi! Mbyllni dyert!
Tradhëti! Kërkoheni ta gjejmë!
Laerti – Është këtu, Halmet. Hamlet, ti je i vrarë,
dhe s'ka ilaç në botë që të të shërojë,
ti s'ke më tepër se gjysmë ore jetë;
veglën e tradhëtisë e ke në dorën tënde,
të mprehtë dhe të helmuar;
vepra ime e urrejtur u kthye përbri mua;
shiko, këtu jam shtrirë
dhe kurrë s'do të ngrihem përsëri;
jot 'ëmë u helmua;
s'mund më – mbreti, mbreti e ka fajnë.
Hamleti – Dhe maja e helmuar!
Ahere helm bëj punën tënde! *(I bie Klaudit)*
Të gjithë – Tradhëti! Tradhëti!
Klaudi
– O, megjithkëtë mbromëni, miq, vetëm më plagosi.
Hamleti
– Këtu, ti incestar, vrasës, danez i mallkuar,
pi këtë dozë helm! Ishte ky bar margaritari yt,
që ti hodhe brënda?
Ndiq nënën time. *(Klaudi vdes)*
Laerti – E kishte hak;
Ay vetë e përzjeu helmin.
Eja të ndjehemi, bujar Hamlet;
që vdekja ime dhe e tim eti të mos bien mbi ty,
as jotja përmbi mua. *(Vdes)*
Hamleti – Zoti të ndjeftë! Unë vijë pas teje. *(Bie)*
Po vdes, Horat.
– E mjerë mbretëreshë, lamtumirë! –
ju që duki të verdhë dhe dridheni në këtë rast,
që jini veç figurantë, ose të pranishëm në këtë akt,

vetëm të kisha kohë, po ky kapteri i rreptë – vdekja,
është rigoroz në arrestimin e tij.
O, do të mundja t'ju thosha –
po s'ka gjë;
Horat, po vdes;
ti do të rrofsh;
folu për mua dhe për çështjen
atyreve që s'e dinë.
Horati – Kurrë mos e beso këtë;
unë jam më tepër romak i vjetër, se danez;
këtu ka mbetur edhe ca pije. *(Ka kupën)*
Hamleti – *(Hamleti ngrihet)* Si burrë që je,
epma gotën, lëshohe, për zotin e dua, -
(E flak gotën përdhe dhe bie përsëri)
O perëndi! – Horat, ç'emër të njollosur
do të le pas meje, po të mbeten gjërat kështu të
panjohura! Nëse ti më kishe ndonjëherë në zemrën
tënde, largohu nga lumturitë e jetës pak kohë,
dhe në këtë botën e ashpër merr frymë me dhëmbje,
që të thuash historinë time. *(Dëgjohen çapet e një marshimi që vjen nga larg. Pastaj zbrazje topash. Orsiku del përjashta.)* Ç'zhurmë luftarake është kjo?
Osriku– *(Kthehet)* Fortinbrasi i ri, u kthye fitimtar
nga Pollonia, dhe përshëndet ambasadorët e Anglisë
me këto batare luftarake.
Hamleti – O, po vdes, Horat;
helmi i fortë ma mposhti krejt frymën time;
nuk do të rroj të dëgjoj të ratë nga Anglia,
po profetizoj se zgjedhja do të bjerë mbi Fortinbrasin;
dhe unë duke vdekur i jap votën timë;
ashtu i thuaj dhe për të gjitha ngjarjet, të vogla
e të mëdha, shkaqet që i suallën ato.
Të tjerat janë heshtje. *(Vdes)*
Horati – Tani u kthye një zemër bujare.

– Natën e mirë princ i ëmbël,
- dhe kore ëngjëjsh këndofshin për prehjen tënde! –
Po pse vinë daullet këtej? *(Marshimi dëgjohet brënda.Hyjnë Fortinbrasi dhe ambasadorët englezë, daulle, flamuj dhe shoqëronjës)*
Fortinbrasi – Ç'është kjo pamje e tmerrshme?
Horati – Çfarë doni të shikoni?
ndonjë qiamet, ose çudi, ndalini çapet tuaja.
Fortinbrasi
– Kjo stavë prej të vrarësh shpall një kërdi
brutale të padalluar. O vdekje fodulle!
Ç'gosti ke vallë në qelinë tënde prej ferri,
që kaqë shumë princër me një të shtënë
kështu mizorisht i ke vrarë?
Amb.I – Pamja është e tmerrshme ,
dhe dërgata jonë nga Anglia erdhi shumë vonë.
Veshët janë të shurdhër të dëgjojnë,
t'i them atij, që urdhri i tij u plotësua,
që Rosenkranci dhe Guildensterni vdiqnë.
Kush do të na falnderojë neve?
Horati – Jo nga goja e tij, edhe sikur të kishte frymë
t'ju falënderonte; se ay kurrë s'dha urdhër për
vdekjen e tyre. Po me që ju erdhët kaq të përpiktë
mbi këtë gjakësi të dyshimtë, ju nga luftrat e
Pollonisë, dhe ju nga Anglia, jepni urdhër
që këto kufoma t'i vënë lartë mbi tribunë në pamje
publike; dhe lermëni mua t'i them botës që s'dinë
se si këto ngjarje ngjanë; ahere do të dëgjoni
për epshe, vrasje, dhe vepra të panatyrshme,
për shkakë akcidentale, dhe vrasje pa arësye,
për vdekje të bëra me dinakëri, dhe shkak të
përdhunuar, dhe në këtë përfundim
të tragjedisë qëllimet u gabuan
dhe ranë mbi kryet e atyre që i shkaktuan.

Të gjitha këtu unë me të vërtetë mund t'ju tregoj.
Fortinbrasi – Le t'i dëgjojmë menjëherë,
dhe thërritni më bujarët në mbledhje.
Sa për mua e përqafoj me hidhërim fatin tim;
kam ca të drejta që s'harrohen në këtë mbretëri,
të cilat tani rasti më fton t'i kërkoj.
Horati – Edhe për këtë unë kam shkak të flas
dhe prej gojës tij, mendimi i të cilit
do të pëkrahet nga të tjerët;
po të veprojmë menjëherë,
bile ndërsa mëndjet e njerëzve janë egërsuar,
se mos akcidente të tjera fatkeqe,
mbi pasojat e komplloteve dhe gabimeve ngjasin.
Fortinmbrasi – Katër kapitenë
le ta shpien Hamletin si ushtar në tribunë;
se ay, po ti qe dhënë mundësia, do ta provonte,
se do të bëhej mbret i madh; dhe derisa
të kalojë kufoma e tij,
muzika ushtarake dhe nderimet luftarake
le të flasin me zë të fortë për të.
Ngrihini kufomat; një pamje e tillë
i ka hije sheshit të luftës, po këtu s'duket mirë.
Shko, urdhëro ushtarët të shtien.

(Marsh funeral. Dalin duke shpënë të vdekurit. Pastaj dëgjohen Batare topash)

FUND

SHPJEGIME

1. Ahere njerëzia mendonin se një fantazmë s'mund të fliste para se t'i flisnin.
2. Siç duket mbledhja do të jetë bërë në ndonjë vënd ku ka patur akull.
3. Ahere mendonin se mola ishte në gjendje të shkakëtonte fatkeqësi.
4. Ylli i notit është hëna.
5. Kushëri, përveç kuptimi që ka në lidhje me farefisni, në Angli shpesh i thërrisnin edhe nipit dhe mbesës. Por ishte gjithashtu dhe shperhje miqësie dhe familjariteti. Përdorej sidomos prej një sovrani krashi një sovrani tjetër.
6. Me kuptim – shpallin.
7. Në mitologjinë greke Lethi ishte emri i lumit të harresës, ujët e të cilit kishte fuqi t'i bënte ata që pinin të harronin qënien e tyre të mëparshme. Shpirtrat kalonin sefte në fushat e Elisisë dhe pinin ujë që të mos u mbeteshin kujtime nga jeta e hidhur në tokë.
8. Hamleti e fillon fjalën e tij me sinqeritet të zjarrtë, por befas e pret. Ay ndofta o të thoshte: "S'gjendet keqbërës në tërë Danimarkën që mund të krahasohet me im ungj!" Por menjëherë e mbledh veten nga rreziku i një shprehjeje të tillë dhe ahere papritur përfundon: "Po ay është një bagabond kopil".
9. Kjo shprehje ka këtë kuptim: që çiliminjtë tërheqin më shumë spektatorë në teatër se sa aktorët e vjetër të Globit. Teatri quhej Glob.
10. Aluzioni dhe këtu është për teatrin Glob, i cili kishte një skulpturë të Herkulit me globin e botës përmbi supet e tij.
11. Në atë mbi faqen e monedhave kishte një rreth, përbrënda së cilit qe vizatuar koka e mbretit;

kur monedha ishte e plasur jashtë rrethit konsiderohej kallpë dhe nuk shkonte. Ky është i frazës – i plasur përbrënda rrethit.

12. Fermaganti ishte hyjni që të krishterët e mesjetës mendonin se e adhuronin muhamedanët. Në dramat e mistereve e çfaqnin si personalitete të rreptë.
13. Nga fuqia që ka kameleoni të kalojë një kohë të gjatë pa ushqim, njerëzia pandehnin se ay rronte me erë.
14. Në atë kohë në Angli, kur çfaqnin drama njerës privatë nëpër shtëpitë e tyre, ishte oborrsi për një burrë të rrinte në këmbët e zonjës ose të së dashurës së tij. Ne teatrot publike nuk përdorej kyzakon.
15. Në lodrat e vjetra fshatare në Angli kishte dhe një kalë qesharak, që loste një valle të vjetër, e cila ishte dikur popullore. Kalin e bënin prej kartoni ose prej druri dhe e lidhnin rrotull mesit të një njeriu. Këmbët e njeriut kalonin përmes trupit të kalit dhe ecte lirisht. Këmbët i kishte të mbuluara me stofë dhe nuk i dukeshin, kurse përjashta dukeshin këmbët fallso të kalit. Kur humori puritanist i luftoi këto lodra, poetët e përshkruan si një zell qesharak në balladat e tyre. Prej këtyre balladave Hamleti përdor një ose dy radhë.
16. Febi është personifikimi i diellit.
17. Telli është personifikimi i dheut.
18. Duket se aktorët në ditët e Shekspirit duhej të vinin pëndë në skenë.
19. Aktorët në kohën e Shekspirit nuk merrnin rrogë, siç marrin aktorët tani. Ahere të ardhurat e teatrit i ndanin në pjesë, prej të cilave pronarët ose pronari merrnin një ose disa pjesë dhe çdo

aktor një ose më tepër pjesë, ose copën e një pjese, sipas meritës së tij.

20. Damon – mik me besë.
21. Hamletin e quan të ungjin e tij pallua me përbuzje, që do të thotë: "Tundet e shkundet i krekosur me madhështi fallso!"
22. Në Angli kjo shprehje ishte shprehje përkëdhelije.
23. Në atë kohë në Angli pandehnin se bretkoca, lakuriqi i natës dhe maçoku ishin ndihmësit e magjistricave dhe i dinin të fshetat e padroneve të tyre.
24. Në atë kohë në Angli lodrën e fëmijëve kukeçefas e quanin dhelpër. Pra, Hamleti pretendonte që ishte i marrë, mëgjithatë thotë fshehurazi – dhelpër dhe të gjithë pas, po do t'ju gjej s'më shpëtoni. Kuptimi i plotë është ky, po fjalët e fundit "do t'ju gjej, s'më shpëtoni, nuk i thotë, që të mos kuptohet se çdonte të thoshte.
25. Kjo është një histori, e cila ishte shumë e njohur në popull ahere. Tregonin se kur Krishti vajti në dyqanin e një furrxhiu, kur po piqnin bukë dhe u kërkoi ca bukë për të ngrënë, e shoq' e furxhiut vuri menjëherë ca brumë në furrët t'ia piqte, por e qërtoi e bija se i kishte vënë shumë brumë dhe ia hoqi një pjesë. Por megjithëkëtë brumët filloi të zmadhohet dhe buka u bë shumë e madhe. Ahere e bija e furrxhiut e habitur zuri të thërresë: "hiu, hiu, hiu!" si kukumjaçka dhe zoti e ktheu në atë zog. Morali i kësaj historie është, që njeriu të mos jetë dorështrënguar.
26. Ahere mendonin se vajzën e parë që do të shihte djali në mëngjezin e shën Valentinit do të bëhej e dashura e tij.

27. Hamleti e krahason varrin me një kuti, se avokatët i mbanin ahere shkresat, tapitë dhe kontratat në kuti të drunjt ose prej teneqeje.
28. Osa, mal në Greqi, i famshëm në mitologjinë greke.
29. Pëllëmbesha klloqit zakonisht dy vezë dhe gjatë tri ditëve pas si i ka çelur zogjtë e saj nuk largohet nga folea veçse për pak minuta sa për kërkuar gjësendi për të ngrënë. Në këtë kohë të vegjlit duan shumë të ngrohtë, detyrë të cilën ajo kurrë s'ia beson mashkullit të saj, prandaj ndofta e ka përshkruar aq të dhëmshur dhe të bukur portretin e saj Shekspiri.
30. Kjo shprehje shpjegohet kështu: Lere fuqinë herkuliane të Laertit të bëjë ç'të dojë, dhe Klaudi, macja, i cili hiqet zvarrë fshehurazi në errrësirë le të mjaullijë dhe qëni besnik, Hamleti do të lajë hesapin e tij më në fund.
31. Kjo shperhje përdoret ndofta me kuptim të dyfishtë. Në të parin – të përjetshëm, sikundër do ta kuptojë Gertruda. Dhe në të dytin – jeta e Hamletit është në rrezik për vdekje, siç do ta kuptojë Laerti.
32. Në anglisht bilbo – në njëjës dhe bilboes – në shumës, janë prangat e këmbëve.
    Bilbo është një lloz prej hekuri i bërë me hallka, të cilat shtyheshin prapa e përpara në hambarin e anijes. Në kohët e vjetra përkrah këtij hambari lidhnin në hallkat robërit ose marinarët kryengritës. Fjala bilbo e ka origjinën e saj nga Bilbao një qytet i Spanjës, i famshëm në atë kohë për punimet e hekurta. Aluzioni i Shekspirit ka këtë kuptim: Me që këmbët të dënuarve ua lidhnin aqë shtrënguar me këto hallka, përpjekjet e tyre për të fjetur duhej të ishin që të kota, si ato të Hamletit në mëndjen e

tij, në të cilën bëhej një luftë që s'e linte të flinte, se çdo lëvizje e njërës hallkë do të zgjonte shokun që e kishin lidhur bashkë.
Këto hallka edhe sot e kësaj dite gjenden në muzeun e Londrës në mes të plaçkave të tjera të luftës të kapura prej flotës spanjolle.

33. Më të shumtit e njerëzve të mëdhenj në kohën e Shekspirit kishin një shkrim të keq. Por sekretarët e tyre shkruanin pastër dhe bukur. Prandaj një njeri për të qënë sekretar duhej medoemos të shkruante bukur, që shkrimi i tij të lexohej lehtë. Mirëpo shkrimi i bukur, e zbulonte menjëherë njeriun, që ay ishte sekretar dhe konsiderohej si diçka e ulët për një njeri të shkruante bukur, se mendonin që s'ishte i zoti, veçse të shkruajë fjalët e një tjetri.
34. Kjo shprehje duhet të kuptohet – aktiviteti i mëndjes së tij.
35. Ky zog ishte stërvitur që të tërhiqte zogjt' e tjerë në grackë, po ngandonjëherë siç ecte i kapardisur dhe pa frikë binte vetë brënda.